

UDHËZIM

Nr.17 Datë 13.05.2008

PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit Nr.7928, date 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Regjistrimi

1.1 Detyrimi për të kërkuar regjistrimin

a) Çdo person fizik apo juridik që zhvillon veprimtari ekonomike, qarkullimi i të cilit për një vit kalendarik, tejkalon apo parashikohet të tejkalojë kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe çdo person fizik apo juridik importues, është i detyruar të regjistrohet.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7.2011).

Termi "person" përfshin çdo subjekt që kryen një veprimtari ekonomike, pavarësisht nga forma juridike e organizimit të tij. Ai përfshin edhe institucionet, organet e pushtetit qendror e vendor, organizatat shoqërore e politike që kryejnë veprimtari ekonomike të tatueshme.

Janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu edhe çdo subjekt tjetër si individët, organet e pushtetit qendror e lokal, organizatat shoqërore, politike, ndërkombëtare, misionet diplomatike etj. që kryejnë importe, pavarësisht nga qarkullimi.

b) Përfshihen nga ky rregull dhe lejohen të kryejnë veprime në organet doganore:

- Tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike eksportuese. Këta persona, pavarësisht mënyrës së tyre të regjistrimit (tatimpagues të TVSH-së, apo paguese e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël), mund të bëjnë veprime doganore.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 18, datë 18.06.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 104 datë 01.07.2008).

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 datë 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 datë 15.01.2009).

SHFUQIZOHET (Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7. 2011).

Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit "Për taksën vendore të biznesit të vogël", që importojnë mallra në funksion të veprimtarisë ekonomike të personit që i ka importuar. Këto janë mallra të grupit të AQT dhe konkretisht si të tilla përmenden:

- makineri-pajisje pune;
- instalime teknike;
- makineri e pajisje energjetike;
- instrumente e vegla;
- mjete transporti;
- mobilie e orendi zyrash;
- pajisje zyresh e informatike.

Kjo kategori e tatimpaguesve mund të importojë vetëm duke qenë e regjistruar si paguese e taksës vendore të biznesit të vogël.

c) Për çdo subjekt që kryen import-eksporte, veprimet doganore bëhen vetëm pasi ai të ketë paraqitur origjinalin ose kopjen e noterizuar të certifikatës së numrit të identifikimit për personin e tatueshëm (NIPT).

ç) Mund të bëjnë veprime doganore, pa qenë të detyruar të regjistrohen, vetëm individët për mallrat e përdorimit personal. Përcaktimi "mallra të përdorimit personal" bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 199 të Kodit Doganor dhe të pikës 2.12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar. Nuk janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu individët që kryejnë importe të rastësishme, si mjete transporti për përdorim privat, dhe të tjera të kësaj natyre, pavarësisht se për importet e mësipërme ato janë të detyruar të paguajnë tatim mbi vlerën e shtuar në doganë. Në këtë rast, importimi bëhet me një NIPT të përbashkët, i cili akordohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe u bëhet i ditur të gjitha pikave doganore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 datë 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 datë 15.01.2009).

1.1.1. Periudha që merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit.

Periudha bazë që duhet të merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit është viti kalendarik, që do të thotë periudha nga 1 janari deri në 31 dhjetor. Në çdo rast, nëqoftëse gjatë vitit kalendarik, qarkullimi i pritshëm tejkalon ose parashikohet të tejkalojë **kufirin minimal të regjistrimit për TVSH**, personi fizik ose juridik detyrohet të kërkojë të regjistrohet.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7. 2011).

1.1.2 Qarkullimi që merret parasysh

Qarkullimi që duhet të merret parasysh është qarkullimi gjithsej i realizuar nga i njëjti person, pavarësisht nga statusi i tij.

a) Qarkullimi gjithsej

Qarkullimi gjithsej përfshin të gjitha furnizimet e bëra nga një person: furnizimet e tatueshme, furnizimet e përjashtuara, furnizimet për eksport. Ai përfshin gjithashtu edhe furnizimet e tjera që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së personit si ndihmat, subvencionet etj. Qarkullimi llogaritet në baze të çmimit total që paguan blerësi. Çmimi përfshin edhe tatimet dhe çdo detyrim tjetër.

Përjashtim bëjnë vetëm shitjet e aktiveve të qëndrueshme të personit të tatueshëm, si ndërtesat, makinat dhe pajisjet. Këto shitje nuk merren parasysh kur llogaritet qarkullimi gjithsej.

b) I njëjti person

Nëqoftëse një person ka disa veprimtari në të njëjtin vend ose në vende të ndryshme, qarkullimi që merret për bazë për kriterin e kufirit të regjistrimit përfshin qarkullimin e të gjitha veprimtarive, në të gjitha vendet ku zhvillohet ajo, cilido qoftë emri i degëve apo forma e tyre juridike. Është personi dhe jo veprimtaria ekonomike që regjistrohet për TVSH dhe çdo regjistrim mbulon të gjitha veprimtaritë ekonomike të personit të regjistruar.

c) Fillimi ose mbyllja e veprimtarisë ekonomike

Nëqoftëse një person fillon apo mbyll veprimtarinë ekonomike gjatë një viti kalendarik, kufiri i regjistrimit llogaritet në përpjestim me zgjatjen e veprimtarisë. Për shembull, një person e fillon veprimtarinë e tij më 15 tetor. **Qarkullimi i tij nga 15 tetori deri në fund të vitit është 1.100.000 lekë. Kufiri minimal i regjistrimit për një tremujor është $(5.000.000:365) \times 76 = 1.041.096$ lekë. Në këtë rast personi është i tatueshëm dhe duhet të kërkojë të regjistrohet. (Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7.2011).**

d) Rritja e qarkullimi mbi kufirin e regjistrimit

Nëqoftëse qarkullimi gjatë një viti kalendarik rritet mbi kufirin e regjistrimit, personi bëhet person i tatueshëm dhe duhet të kërkojë të regjistrohet që nga 1 janari i vitit kalendarik pasardhës.

1.2 E drejta për të kërkuar regjistrimin

Çdo person, qarkullimi i të cilit është më i ulët se kufiri i regjistrimit, mund të kërkojë të regjistrohet në çdo kohë, nëqoftëse ka nevojë të bëjë kështu për arsye të veprimtarisë së tij ekonomike. Personi i regjistruar, pavarësisht nga niveli i shitjeve të tij, duhet të zbatojë të gjitha kërkesat e ligjit duke përfshirë paraqitjen e deklaratave tatimore, pagimin e tatimit, mbajtjen e regjistrimeve deri sa ai të ç'regjistrohet, etj.

1.3 Mënyra e regjistrimit

1.3.1 Periudha e regjistrimit

a) Fillimi i veprimtarisë ekonomike

Një person i cili fillon veprimtarinë ekonomike, detyrohet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të saj, kur qarkullimi i tij pritët të tejkalojë kufirin e regjistrimit. Në rastin e një personi i cili fillon veprimtarinë ekonomike dhe kjo veprimtari ka të bëjë me import-eksportin është i detyruar të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të veprimtarisë, pavarësisht se qarkullimi i tij mund të mos arrijë kufirin minimal të regjistrimit.

b) Rritja e qarkullimit

Nëqoftëse gjatë një viti kalendarik qarkullimi i realizuar e tejkalon kufirin e regjistrimit, personi detyrohet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga dita e përfundimit të vitit kalendarik në të cilin qarkullimi e tejkalon kufirin e regjistrimit. Për vitin e kaluar kalendarik tatimpaguesi paguan detyrimet tatimore për llojin e tatimit për të cilin ai ka qene i regjistruar.

1.3.2 Vendi i regjistrimit

Vendi ku bëhet regjistrimi i cdo personi të tatueshëm është Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), me përjashtim të Organizatave jo fitimprurëse, të cilat regjistrohen në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku ato kanë vendndodhjen.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

1.4 Certifikata e regjistrimit

Çertifikata përmban emrin e personit të tatueshëm, emrin tregtar (nëse ka), Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) dhe datën kur regjistrimi hyn në fuqi. Numri i Identifikimit përmban 8 numra, që kufizohen nga dy shkronja në ekstremet e tyre.

Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm është unik. Personi i tatueshëm ka një numër të vetëm, sado që të jetë numri i degëve apo i veprimtarive ekonomike të tij. Një numër i njëjtë identifikimi nuk mund të lëshohet disa personave të tatueshëm, edhe nëqoftëse numri i identifikimit tatimor nuk përdoret më nga një person i tatueshëm. Të gjitha deklaratat e bëra për organet tatimore (deklaratat tatimore, deklaratat doganore), të gjitha faturat e lëshuara nga personi i regjistruar dhe të gjitha dokumentat e përdorura prej tij për veprimtarinë e tij ekonomike duhet të përmbajnë numrin e identifikimit tatimor.

Çertifikatat e Regjistrimit të Personit të Tatueshëm, duhet të ekspozohen në të gjitha adresat ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij. Këto çertifikata merren në momentin e fillimit të veprimtarisë dhe janë të vlefshme përgjithmonë.

2. Ç'REGJISTRIMI

2.1 Detyrimi për të njoftuar ndryshimet

Personi i tatueshëm është i detyruar të njoftojë QKR si dhe organet tatimore për ndryshimet e pësuar. Njoftimi i ndryshimeve duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga momenti kur ato ndodhin. Proçedura e njoftimit të ndryshimeve është e njëjtë me proçedurën e regjistrimit. Ka ndryshime që kërkojnë çregjistrim dhe të tjera që kërkojnë modifikim të regjistrimit.

2.1.1 Ndryshime që kërkojnë ç'regjistrim.

Çdonjëri nga ndryshimet e mëposhtme kërkon anulimin e regjistrimit ekzistues:

- a. Mbyllja e veprimtarisë ekonomike.
- b. Shitja e veprimtarisë ekonomike.
- c. Bashkimi ose shkrirja për të kryer një veprimtari ekonomike që më parë kryhej nga një person i tatueshëm.

d) SHFUQIZOHET

e) Organet tatimore çregjistrojnë çdo person që as nuk është i detyruar e as ka të drejtë të regjistrohet, me efekt nga data kur personi është regjistruar. Këto organe refuzojnë të regjistrojnë çdo person që as nuk është i detyruar dhe as ka të drejtë të regjistrohet. (Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

2.1.2 Ndryshime që kërkojnë modifikime në regjistrim

Çdonjëri nga ndryshimet e mëposhtme kërkon modifikimin e regjistrimit ekzistues:

- Ndryshim në emrin ose emrin tregtar të biznesit, ose emrin dhe/ose adresën e njërit prej partnerëve.
- Ndryshim në emrat e pronarëve apo administratorëve.
- Ndryshim i emrit dhe/ose adresës në Shqipëri të përfaqësuesit fiskal për TVSH të emëruar nga një kompani jashtë vendit.
- Ndryshim në adresën e vendit kryesor, apo vendeve në të cilat kryhet biznesi.
- Ndryshim në veprimtarinë ekonomike kryesore.
- Ndryshim në numrin e llogarisë bankare.

NIPT-i ekzistues nuk ndryshon si pasojë e këtyre ndryshimeve, por çertifikata përditësohet me të dhënat e reja.

2.1.3 Kalimi në regjistrin pasiv

Organet tatimore kanë të drejtë të çregjistrojnë nga regjistri aktiv i regjistrimeve duke kaluar në pasiv çdo person të tatueshëm, kur provohet se ai për çfarëdo arsye në vitin e fundit fiskal nuk ka ushtruar veprimtari.

2.2 Mënyrat e çregjistrimit

2.2.1 Periudhat e çregjistrimit dhe data e hyrjes në fuqi të tij.

Kur personi i tatueshëm mbyll veprimtarinë e tij ekonomike, ai duhet të kërkojë të çregjistrohet jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit në të cilën ai ka bërë furnizime të tatueshme. Çregjistrimi hyn në fuqi nga dita e fundit e bërjes të furnizimeve të tatueshme.

SHFUQIZOHET

SHFUQIZOHET

Kur provohet se për çfarëdo arsye në vitin e fundit fiskal personi i tatueshem nuk ka ushtruar veprimtari, organet tatimore, pas kryerjes se procedurave administrative te verifikimit te ketyre personave, kanë të drejtë të çregjistrojnë ato nga regjistri aktiv i regjistrimeve duke kaluar në pasiv sipas nenit 44 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,datë 12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

2.2.2 Dispozita të tjera për çregjistrimin

Procedura e çregjistrimit është e njëjtë me procedurën e regjistrimit. Në çastin e çregjistrimit, personi i tatueshem është i detyruar të paraqesë një deklaratë përfundimtare pagese sipas formularit të përcaktuar në pikën 10.1. Kjo deklaratë do të ketë të llogaritur TVSH mbi gjendjen e mallrave (stoqet) dhe mbi mallrat kapitale (pajisjet) në datën e çregjistrimit.

Personat e tatueshem që çregjistrohen sipas pikës “e” të paragrafit 2.1.1 të këtij udhëzimi, nuk detyrohen të llogarisin TVSH-në mbi gjendjen e mallrave stok.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

Për çdo çregjistrim përfundimtar nga organet tatimore, do të ndiqen procedurat e përcaktuara në ligjin dhe udhëzimin “Për procedurat Tatimore në RSH”. Edhe pas datës së çregjistrimit, personi i tatueshem është përgjegjës për çdo detyrim të TVSH që rezulton për periudhën kur ai ishte i regjistruar, deri në momentin kur këto detyrime parashkruhen sipas nenit 100 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,datë 12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

3. VETËFURNIZIMET

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 10, nëse një person i tatueshem do të përdore për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme mallra të cilat i prodhon vetë, trajtohet sikur i furnizon (shet) këto mallra si pjesë të kësaj veprimtarie të tatueshme dhe sikur furnizohet (blen) me këto mallra për qëllimet e ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme. Kushti i vetëfurnizimit është qe mallrat e prodhuara nga tatimpaguesi të përdoren po nga ai për qëllime të furnizimeve të tatueshme (të ketë të drejtën e kreditimit). Në këtë rast personi i tatueshem lëshon një faturë tatimore shitje për veten, që do të thotë që është dhe shitës dhe blerës.

Shembull: nëse një person i tatueshem prodhues mobiljesh, 10 tavolina dhe 10 karrike nga i gjithë prodhimi i tij i përdor për pajisjen e zyrave ku zhvillon veprimtarinë e tij ekonomike, kemi të bëjmë me një vetëfurnizim.

Vlera e tatueshme e furnizimit për vete është kostoja e prodhimit. Nëse mallrat që prodhohen nga veprimtaria ekonomike që ushtrohet, përdoren nga vetë prodhuesi por në funksion të ushtrimit të një veprimtarie ekonomike të përjashtuar, ose pjesërisht të përjashtuar sipas ligjit për TVSH (neni 33), personi i tatueshem nuk ka të drejtën e kreditimit (ose e ka pjesërisht kur është rasti) të TVSH-se së paguar ne blerjet e bëra.

Pika 5 e nenit 10 nuk zbatohet në rastin e shoqërive të ndërtimit, të cilat ndërtojnë për të shitur ose dhënë me qira, pavarësisht nga fakti se sipërmarrësi i punimeve dhe investitori janë i njëjti person i tatueshëm. Në këtë rast furnizimi i procesit të ndërtimit është i tatueshëm, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 8.1.2, gërma a), më poshtë.

4. TRANSFERIMI I VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Nëse një person i tatueshëm i kalon të gjithë veprimtarinë ose një pjesë të saj një personi tjetër, i cili është ose bëhet i tatueshëm në lidhje me veprimtarinë e kaluar, duke e vazhduar atë dhe ky transaksion plotëson njëkohësisht kushtin ekonomik dhe ligjor, kalimi konsiderohet transferim i veprimtarisë ekonomike dhe nuk është i tatueshëm.

Plotësimi i kushtit ekonomik kërkon që veprimtaria që transferohet të ketë autonomi ekonomike, pra të ketë mundësi të funksionojë si e pavarur tek marrësi. Autonomia ekonomike presupozon ekzistencën e të gjitha kushteve për realizimin e prodhimit, si ambientin, lëndët e para, makineritë, etj. Shitja vetëm e njërës prej tyre (lëndës së parë, makinerive ose ambienteve, etj) nuk konsiderohet transferim i veprimtarisë ekonomike, por vetëm një furnizim i zakonshëm mallrash, për të cilin aplikohet TVSH.

Plotësimi i kushtit ligjor kërkon që të bëhet në të gjitha rastet verifikimi i bilancit të personit që kalon veprimtarinë, të verifikohet sa dhe cilat asete të aktivitetit përdorshin për prodhimin e produktit dhe sa janë transferuar dhe po kështu në pasiv, sa të ardhura janë realizuar për shkak të këtij kalimi. Të njëjtat verifikime do të bëhen në bilancin e personit tek i cili kalon veprimtaria, sa asete kanë hyrë dhe çfarë veprimesh janë bërë në pasiv. Midis dy personave duhet të jetë përpiluar gjithashtu një kontratë transferimi e noterizuar, mbështetur në Kodin Civil.

Nëse personi i tatueshëm jep mallra të cilat janë pjesë e aseteve të veprimtarisë së tij ekonomike, p.sh. i shet, i fal ose i përdor privatisht, ky është një furnizim i tatueshëm dhe mbi vlerën e tatueshme të këtyre furnizimeve llogaritet TVSH.

5. MOMENTI I FURNIZIMIT

Furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura. Personi që kryen një furnizim të tatueshëm, detyrohet të lëshojë faturë për atë furnizim në momentin kur lëvrohen mallrat ose kur ato bëhen të disponueshme, apo kur shërbimet janë kryer prej tij në lidhje me atë furnizim.

Në të gjitha rastet kur personi i tatueshëm, arkëton pagesën përpara se mallrat të lëvrohen apo të bëhen të disponueshme, apo shërbimet të jenë kryer ai është i detyruar të lëshojë një faturë në momentin që pagesa është arkëtuar prej tij. Kjo faturë do të regjistrohet menjëherë në librin e shitjes dhe do të pasqyrohet në FDP-në e po atij muaji në të cilin është bërë marrja e pagesës.

5.1 Transferimi i mallrave për shitje me këste.

Bazuar në nenin 13, pika 7 të ligjit, kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate, e cila parashikon marrjen me qera ose shitjen me këste, pavarësisht nga momenti i kalimit të pronësisë, detyrimi për TVSH-në lind mbi vlerën e plotë të mallit. Ndërsa përsa i takon deklarimit dhe pagesës për çdo periudhë tatimore, TVSH llogaritet mbi pagesat e vlerës së kësteve për mallin e vënë në dispozicion të përdoruesit. Operacione të kësaj natyre janë ato që kanë të bëjnë me

transferimin e mallrave në bazë të një kontrate qeraje financiare (*leasing*). Për çdo rast qeradhënësi përpilon një faturë tatimore me TVSH për çdo kësht të përcaktuar në kontratën përkatëse të *leasing* si më poshtë :

a). Kur qiradhënësi është person i tatueshëm jo bankë ose institucion financiar.

Furnizuesi që i jep mallin qiradhënësit, lëshon për të faturë tatimore me vlerë të tatueshme aq sa është çmimi i plotë, duke zbatuar mbi këtë vlerë TVSH 20%.

Qiradhënësi e regjistron faturën e lëshuar nga furnizuesi në librin e blerjeve dhe krediton TVSH-në e zbatuar në të. Kur qiradhënësi i dorëzon mallin qiramarrësit, për çdo kësht të qerasë financiare (zakonisht muaj), ai do të lëshojë për të faturë tatimore me vlerë të tatueshme aq sa është vlera e plotë e kështit (pa përfshirë interesin) mujor, duke zbatuar mbi të TVSH 20%. Këto fatura regjistrohen nga qiradhënësi në librin e shitjes dhe deklarohen si shitje të tatueshme, sipas periudhave tatimore që i takojnë.

Qiramarrësi, kur është person i tatueshëm (i regjistruar si tatimpagues i TVSH) ka të drejtën e kreditimit të këtyre faturave, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH. Pra lejohet kreditimi për ato lloje mallrash që i shërbejnë veprimtarisë së tij të tatueshme dhe nuk kufizohen nga neni i mësipërm.

Në fund të periudhës së kontratës, nëse qiramarrësi do të ushtrojë mundësinë e blerjes së mallit të përcaktuar në të, qiradhënësi lëshon për të një faturë përfundimtare me vlerë të tatueshme të caktuar në kontratë, regjistrimi i së cilës bëhet njëllë si i faturave pjesore të lëshuara gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës.

E njëjta procedurë si më sipër kryhet në rastin kur qiradhënësi e prodhon vetë mallin, me ndryshimin që përjashtohet nga skema roli i furnizuesit.

b). Kur qiradhënësi është një bankë ose institucion financiar që kryen edhe aktivitetin e qirasë financiare.

Personat që ushtrojnë veprimtari në fushën bankare, që të mund të kryejnë veprimtarinë e qirasë financiare, duhet të kenë përfshirë këtë aktivitet në liçensën ose lejen përkatëse. Sipas nenit 21 të ligjit të TVSH-së, shërbimet financiare të përcaktuara në këtë nen dhe që kryhen nga banka janë të përjashtuara nga TVSH.

Ndërkohë që aktiviteti i qirasë financiare është i tatueshëm. Pra banka kryen njëkohësisht operacione të tatueshme dhe operacione të përjashtuara nga TVSH. Edhe në këtë rast krijohen marrëdhënie midis furnizuesit, bankës në rolin e qiradhënësit, si dhe qiramarrësit.

Furnizuesi që i shet mallin bankës (qiradhënësja), lëshon për të faturë tatimore me vlerë të tatueshme aq sa është çmimi i plotë duke zbatuar mbi këtë vlerë TVSH prej 20%.

Banka e regjistron këtë faturë në librin e blerjeve. Meqënëse aktiviteti i qirasë financiare është i tatueshëm dhe furnizimi i marrë i shërben vetëm këtij aktiviteti, atëherë banka ka të drejtën e kreditimit të TVSH-se zbatuar në këtë furnizim. Në çastin kur banka i dorëzon mallin qiramarrësit, për çdo muaj ajo do të lëshojë për të faturë tatimore me vlerë të tatueshme aq sa është vlera e

plotë e kështit (pa përfshirë interesi) mujor, duke zbatuar 20 % TVSH. Këto fatura regjistrohen nga banka në librin e shitjes dhe deklarohen si shitje të tatueshme, sipas periudhave tatimore që i takojnë.

Në fund të periudhës së kontratës, nëse qiramarrësi do të ushtrojë mundësinë e blerjes së mallit të përcaktuar në të, banka lëshon për të një faturë përfundimtare me vlerë të tatueshme të caktuar në kontratë, regjistrimi i së cilës bëhet njëloj si i faturave pjesore të lëshuara gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës.

Në të njëjtën kohë, banka kryen blerje të tjera, të ngarkuara me TVSH, të cilat i shërbejnë edhe aktivitetit të përjashtuar (shërbime finaciare) edhe aktivitetit të tatueshëm, përfshirë qeranë financiare. Për këtë kategori shpenzimesh, bazuar në nenin 33 të ligjit të TVSH, zbatohet kreditimi i pjesshëm i TVSH. Pra banka krediton TVSH e lidhur me këto shpenzime deri në masën që ato i shërbejnë aktivitetit të saj të tatueshëm.

6.VENDI I FURNIZIMIT TE SHERBIMEVE

Përcaktimi i vendit të furnizimit të shërbimeve, ka rëndësi për faktin që ai ka inpakt në aplikimin e TVSH në raportet tregtare ndërkombëtare.

Për të analizuar vendin e kryerjes së shërbimeve analiza bëhet e vecantë rast pas rasti.

Rregullat mbi përcaktimin e vendit për furnizimin e shërbimeve janë të përcaktuara në nenin 15 të ligjit të TVSH në paragrafët 1-5.

Paragrafi 1 përcakton një vend bazë dhe në parim sipas tij, vendi është atje ku shërbimet jepen, pra ku ndodhin realisht, kryhen nga furnizuesit.

Ky rregull mund të përdoret atëherë kur në paragrafet 2 deri 5 nuk është e rregulluar asgjë e vecante.

Për këto arsye, për përcaktimin e vendit për një furnizim shërbimi duhen kontrolluar fillimisht paragrafet 2 deri 5. Vetëm nëqoftëse këto përcaktime nuk mund të përdoren, atëherë zbatohet përcaktimi i vendit sipas paragrafit 1.

6.1 Shërbime të lidhura me pasurinë e paluajtshme.

Në nenin 15, pika 2 të ligjit, është përcaktuar se furnizimi i shërbimeve në lidhje me pasurinë e paluajtshme, kryhet atje ku gjendet pasuria e paluajtshme.

Shërbime të një natyre të tillë janë p.sh:

- projektimet,
- punimet e ndërtimit, pajisjes, rikonstruksionit e mirëmbajtjes,
- supervizime, ekspertiza të lidhura me pasuritë e paluajtshme,
- dhënie me qira,

- shërbime të agjencive imobiliare,
- etj.

Kryerja e shërbimeve të tilla ndodh në Shqipëri, që është edhe vendi i furnizimit, përderisa pasuria e paluajtshme(ndërtesa) mbi të cilat shërbimi kryhet, ndodhet në Shqipëri.

Personi i tatueshëm jorezident në Shqipëri, i cili kryen shërbime, vend i furnizimit të të cilave është në Shqipëri dhe për rrjedhojë detyrimi për të paguar TVSH-në lind në Shqipëri, në zbatim të nenit 55 të ligjit, i kërkohet të emërojë përfaqësuesin e tij tatimor. Detyrimi i personit të tatueshëm jorezident, për t'u regjistruar me anë të një përfaqësuesi tatimor për të paguar TVSH-në në Shqipëri, zbatohet pavarësisht nëse vlera e furnizimit të shërbimit kalon ose jo kufirin minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 26, dt. 2.12.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 165, datë 23.12.2011).

6.2.Furnizimi i shërbimeve nga jashtë vendit.

Në nenin 15, pika 5, e ligjit të TVSH, jepet përcaktimi lidhur me vendin e kryerjes së shërbimeve të furnizuara nga një person që nuk ka vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri, ose në rastin e individit, vendi i zakonshëm i rezidencës së të cilit është jashtë Shqipërisë, për një person që kryen veprimtari ekonomike(i regjistruar) në Shqipëri. Personi në Shqipëri, të cilit i janë furnizuar shërbimet, konsiderohet sikur ta ketë bërë furnizimin në Shqipëri si pjesë të veprimtarisë së tij ekonomike. Përfituesi shqiptar i shërbimit duhet trajtuar pastaj në mënyrë të tillë sikur të kishte sjellë shërbimin ai:

- në Shqipëri dhe
- në kuadrin e veprimtarisë së tij.

Me anë të këtij përcaktimi bëhet e mundur që të përcaktohet si vend i kryerjes së shërbimit ai i konsumit të tij, duke taksuar përfituesin e tij në Shqipëri.

Për këto raste dokumentimi i furnizimit bëhet me me anë të skemës së autofaturimit (reverse-charge).

Shembull.

X-i, person i regjistruar në Austri konsulton personin e tatueshëm Z, person i tatueshëm në Shqipëri, mbi kushtet e tregut të furnizimit të bimëve mjekësore shqiptare në Austri. X nuk ka vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri. Pagesa e shërbimit të kryer është 100.000 lekë.

Personi X në Austri kryen një furnizim shërbimi nga Austria për përfituesin Z në Shqipëri. Bazuar në pikën 5 të nenit 15, shërbimi tatóhet në vendin e konsumit, pra të përfituesit, në Shqipëri. Personi Z trajtohet në mënyrë të tillë sikur ai ka furnizuar shërbimin e përfitur. Ai lëshon një faturë tatimore për veten e tij me vlerë të tatueshme 100.000 lekë dhe TVSH 20.000 lekë (shkallë tatimore 20%). Kjo faturë regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjes dhe atë të shitjes.

Në rastet kur personi Z (tatimpagues TVSH-je në Shqipëri), krahas shitjeve të tatueshme ka

Adresa: Rruga Gjini Bue Shpata

www.tatime.gov.al

edhe shitje të përjashtuara, ky person duhet të zbatojë kreditimin e pjesshëm të TVSH-së në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

Në rastin kur personi Z, person i tatueshëm në Shqipëri, kryen vetëm furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, ky person nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH-në e autofaturës së lëshuar në zbatim të këtij udhëzimi.

Në rastin kur shërbimi që merr Z, person i tatueshëm në Shqipëri nga X, person i tatueshëm jashtë Shqipërisë, është furnizim shërbimi i përjashtuar në Shqipëri në zbatim të ligjit “Për TVSH-në”, për këtë furnizim shërbimi nuk zbatohen dispozitat e nenit 15 pika 5 të ligjit, pra ky shërbim nuk autofaturohet.
(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

Shembull.

Studio e projektimit “ABC” jorezidente në Shqipëri, është e regjistruar në shtetin X. Ajo realizon projektin e një hoteli që do të ndërtohet në Tiranë, pra në Shqipëri. Projekti realizohet prej saj në shtetin X, ku është edhe vendndodhja e studios.

Vlera e pagesës që do të përfitojë kjo studio për projektin e kryer është 2 milionë lekë, e cila do t’i paguhet nga investitori i këtij hoteli në Shqipëri.

Kryerja e projektit nga studio “ABC” konsiderohet furnizim shërbimi. Ky shërbim është i lidhur me pasurinë e paluajtëshme (hotel në rastin konkret) dhe si i tillë, bazuar në nenin 15, pika 2 të ligjit të TVSH-së, vendi i furnizimit të tij është në Shqipëri.

Studio “ABC” është e detyruar që duke u regjistruar për qëllime të TVSH-së në Shqipëri (me anë të një përfaqësuesi tatimor) të llogarisë TVSH me shkallë tatimore 20% mbi vlerën e pagesës së përfituar. Vlera e tatueshme mbi të cilën bëhet taksimi është 2 milionë lekë dhe TVSH e llogaritur mbi të është 400 mijë lekë

7. FURNIZIMI KUNDREJT PAGESËS

7.1 Përdorimi privat i mallrave

Kur mallrat që i përkasin veprimtarisë ekonomike të një personi të tatueshëm përdoren privatisht jashtë kësaj veprimtarie, furnizimi është i tatueshëm sipas nenit 18.2 të ligjit mbi TVSH-në. Ky furnizim përfshin mallrat të cilat janë prodhuar vetë dhe mallrat nga inventari ose nga aktivet e veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm. Përdorimi privat përfshin përdorimin personal nga personi i tatueshëm të aktiveve të veprimtarisë së tij ekonomike. Ai gjithashtu përfshin edhe përdorimin nga persona të tjerë të tillë si një i punësuar, i afërt, një mik, etj. të personit të tatueshëm.

Vlera e tatueshme në këto raste përcaktohet sipas Nenit 27 të ligjit mbi TVSH-në, paragrafi i dytë. Konsiderohet si përdorim privat në çastin e çregjistrimit, inventari gjendje i aseteve për të cilat është paguar TVSH në blerje. Në këtë çast, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një

Formular Deklarimi dhe Pagesë përfundimtare sipas formularit të përcaktuar në pikën [në pikën 14.1 të këtij udhëzimi](#). Kjo deklaratë do të ketë të llogaritur TVSH mbi gjendjen e mallrave (stoqet) në datën e çregjistrimit të vlerësuar sipas vlerës së tregut dhe mallrat kapitale gjendje të vlerësuar sipas paragrafit [sipas paragrafit 19.2 të këtij udhëzimi](#).
(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

7.2 Furnizimet kundrejt pagesës së reduktuar

Trajtohen si furnizime kundrejt pagesës (të tatueshme), të gjitha rastet kur mallrat që i janë furnizuar një personi të tatueshëm për qëllimet e veprimtarisë së tij ekonomike, furnizohen prej tij ose ju jepen për përdorim personave të tjerë kundrejt pagesës së reduktuar, përveç rasteve kur mallrat janë furnizuar apo përdorur vetëm si mostra, artikuj publicitare (me vlera të vogla për njësi dhe që publikojnë një logo a emër të personit të tatueshëm) apo promocionale furnizuar pa pagesë. Në kuptim të këtij ligji, mostër konsiderohet ai furnizim malli pa pagesë në atë formë që nuk është e përshatshme për rishitje.

Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar quhen rastet kur, furnizuesi nuk arkëton pagesën (dhuratat), ose pagesa është dukshëm më e vogël se ç'duhej të ishte nëse qëllimi i furnizuesit ka qënë fitimi për këtë dhe furnizime të ngjashme. Mallrat dhe shërbimet e furnizuara në rrethanat e mësipërme janë të tatueshme dhe vlera e tatueshme e tyre është pagesa totale që duhet të ishte e pagueshme në bazë të çmimit të shitjes në lidhje me atë furnizim.

Për subjektet që ushtrojnë aktivitetin e tregtisë së energjisë elektrike, në përcaktimin e një furnizimi me pagesë të reduktuar, organi tatimor nuk duhet të ndërhyjë në vlerën e taksueshme të furnizimeve të zakonshme të diktuar nga kushtet dhe çmimet e imponuara të tregut (vlera e tregut për furnizimet e tatueshme) në kohën e kryerjes së tyre (p.sh. në kohën kur lidhen kontratat përkatëse apo kryhen transaksionet), në bazë të kontratave të lidhura më parë (kontrata *forward*), pavarësisht nëse realizohet fitim për tatimpaguesin apo jo. Në këtë rast, organi tatimor duhet të konsiderojë të gjitha rrethanat e transaksionit dhe natyrës së aktivitetit tregtar të taksapaguesit, si për shembull rasti i subjekteve të tregtisë së energjisë elektrike, ku vlera e tatueshme do të jetë e përcaktuar në bazë të vlerës së paguar sipas nenit 27 paragrafi 1 i ligjit “Për TVSH-së” dhe që reflektohet në dokumentacionin përkatës të tatimpaguesit.
(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

7.3 Dhënia në përdorim pa pagesë e aktiveve të veprimtarisë.

Në rastet kur një furnizues mallrash i jep klientit të tij në përdorim, pa pagesë, aktive të qëndrueshme të trupëzuara, pjesë e veprimtarisë së tij, me qëllim shpërndarjen e mallrave që ai furnizon (frigoriferë, banakë frigoriferikë dhe të tjera të kësaj natyre) trajtimi i TVSH-së do të jetë si më poshtë:

- Në rast se klienti, të cilit i është dhënë në përdorim aktivi nga furnizuesi i tij, paguan të njëjtin çmim si edhe një klient i cili thjesht blen mallra pa marrë në përdorim aktive të kësaj natyre, atëherë nuk llogaritet TVSH mbi dhënien në përdorim të aktiveve.

- Në rast se klienti të cilit i është dhënë aktivi nga furnizuesi i tij, paguan një vlerë më të madhe për mallrat e furnizuara nga ky i fundit se një klient i cili thjesht blen mallra, atëhere llogaritet TVSH, me shkallë tatimore 20%, mbi diferencën e cmimit. Kjo diferencë konsiderohet si vlerë e dhënies në përdorim. Ky parim zbatohet vetëm aty ku nuk ka detyrim për blerësin për të bërë një pagesë në para ose në natyrë, për përdorimin e aktivit. Si kusht për kete trajtim nevojitet :

- Midis furnizuesit (pronar i aktivit) dhe klientit, të ekzistojë një kontratë e lidhur sipas së cilës furnizuesi kryen furnizime të vazhdueshme të atij malli, i cili ruhet në këto aktive. Në të njëjtën kontratë sqarohet që dhënia në përdorim e këtyre aktiveve bëhet pa pagesë.

- Zbatimi në praktikë i kësaj kontrate, pra furnizimet e vazhdueshme të furnizuesit (pronar i aktivit) për klientin të jenë konkretizuar me dokumenta justifikuese.

- Furnizuesi i paraqet keto aktive në dokumentat e tij të kontabilitetit kundrejt të gjitha rregullave, si pronë të tij.

Trajtimi i mësipërm është i vlefshëm vetëm në rastet kur nuk ka detyrim për klientin (blerësin) për të bërë një pagesë në vlerë ose natyrë për llogari të furnizuesit, për marrjen në përdorim të aktivit. Nëse dhënia në përdorim e aktiveve bëhet kundrejt pagesës, atëhere kemi të bëjmë me furnizim të tatueshëm dhe mbi transaksionin zbatohet TVSH me shkallë tatimore 20%.

8. FURNIZIMET E TATUESHME DHE ATO TË PËRJASHTUARA

Ligji "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", zbatohet mbi çdo furnizim mallrash e shërbimesh që kryhet nga çdo person i tatueshëm, pavarësisht nga forma juridike e organizimit të tij dhe pavarësisht nga lloji i veprimtarisë ekonomike që ai kryen. Në të njëjtën kohë, nenet 20, 21, 22, 23, 24, 24/1, 25, 25/2, 25/3, 25/5, 25/6, 25/7, 25/8, 25/9, 25/10, 25/11 dhe 26/1 të ligjit, parashikojnë edhe përjashtimet nga ky tatim.

(Ndryshuar me Udhezimin nr.6/1, dt. 17.3.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 32, dt. 17.03.2014).

8.1 Toka dhe ndërtesat

- Furnizimi i tokës dhe truallit dhe dhënia me qera e tyre është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve kur toka përdoret për parkimin e mjeteve të transportit dhe mjeteve të tjera lëvizëse.

- Parkimi i mjeteve të transportit dhe pajisjeve të tjera lëvizëse, është i tatueshëm me TVSH.

- Furnizimi i ndërtesave është një furnizim i përjashtuar.

- Dhënia me qira e ndërtesave është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve:

a) të dhënies me qira për një periudhë jo më shumë se dy muaj;

b) të strehimit në hotele ose vende pushimi.

- Furnizimi i shërbimeve të ndërtimit, pra kryerja e procesit të ndërtimit si dhe të mirëmbajtjes janë furnizime të tatueshme.

Tokë për qëllime të këtij ligji do të thote çdo zonë e papunuar, papërpunuar, pazhvilluar e tokës, që nuk përmban ndonjë ndërtim, përveç mureve të thjeshta ndarëse ose gardhe që përcaktojnë kufijtë ndarës të tokës.

Ndërtesë do të thotë çdo ndërtim i nje ndërtese të fiksuar në tokë, ose pjesë e asaj ndërtesë (e tillë si dhomë ose apartament), dhe që përfshin tokën mbi të cilën ajo qëndron plus tokën rrethuese që bën pjesë në shitje, por nuk përfshin artikuj të tillë si rulotat dhe trajlerat.

Ndërtimi përcaktohet si çdo operacion që ka për rezultat përfundimin tërësor ose pjesor të një ndërtese të re ose substancialisht të ndryshuar, muri, rruga ose themeli. Ndërtime konsiderohen:

a) Punët për konstruksionin e ndërtesave dhe të objekteve të tjera, ku futen :

- punët e ndërtimit (muraturë, armaturë, suvatime, etj.);
- punët publike (ndërtim e mirëmbajtje rrugësh, etj.);
- punët për rregullimin e parqeve që lidhen me operacione të tilla që zgjasin afatin e shfrytëzimit);
- punët për rregullimin e teritoreve që kërkojnë modifikime të relievit;
- punët e rrjetit ngrohës dhe të konstruksioneve metalike;
- punët për shkatërrimin e pasurive të patundshme.

b) Punët për pajisjen e ndërtesave dhe të objekteve të tjera, ku futen:

- Punët për pajisjen e ndërtesave, pajisje të cilat inkorporohen mënyrë definitive në ndërtesë, duke u transformuar kështu për shkak të destinacionit të tyre në pasuri të patundshme (instalimet elektrike, ato sanitare, të ngrohjes, etj.).
- Instalimet e objekteve ose të aparateve të lëvizshme, të cilat me vendosjen e tyre ruajnë karakter të lëvizshëm, nuk konsiderohen punë ndërtimi por shitje materialesh pasojë e kryerjes së një shërbimi.

c) Punët për riparimin e pasurive të patundshme dhe të instalimeve me karakter të patundshëm. Këtu bëhet fjalë për punë që bëhen të nevojshme për shkak të degradimit ose prishjes së ndërtesave (pasuri të patundshme) si lyerja e fasadave, ribërja e një instalimi elektrik apo sanitar, etj.

d)

Mirëmbajtja përcaktohet si çdo operacion i kryer mbi tokë ose ndërtesa për të parandaluar degradimin ose dëmtimin dhe për t'i mbajtur tokën dhe ndërtësat me pamje të mirë dhe rregull funksionimi, duke përfshirë pastrimin.

8.1.1. Vlera minimale e tatueshme e ndërtimit të banesave.

Në bazë të nenit 27/1 të ligjit, vlera minimale e tatueshme në procesin e ndërtimit të banesave, bazohet në çmimin minimal fiskal dhe sipërfaqen e ndërtimit.

Çmimi orientues minimal fiskal, për procesin e ndërtimit të banesave, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.

Përcaktimi i kostos reale për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, do të përcaktohet në bazë të metodologjisë së dhënë në

vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Metodologjitë e llogaritjes së kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, do të shërbejnë si metodologji alternative të vlerësimit të parë.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010)..

8.1.2. Mënyra e zbatimit të TVSH në ndërtim.

TVSH në ndërtim aplikohet:

a) Kur shoqëritë e ndërtimit ndërtojnë për të shitur apo për të dhënë me qera, TVSH llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve. Bashkëngjitur me çdo situacion mujor do të jetë detyrimit fatura tatimore me numër serial. Vlera e situacionit mujor do të jetë vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë TVSH-ne çdo muaj. Vlera totale e këtij situacioni mujor regjistrohet në librin e shitjeve.

b) Kur shoqëritë e ndërtimit të licencuara profesionalisht, do të ndërtojnë objekte për qëllim përdorimi në funksion të aktivitetit të tyre të tatueshëm (jo për furnizime të përjashtuara) kemi të bëjmë me vetëfurnizim të ndërtesave. Për çdo muaj, shoqëria ndërtuese përpilon situacionin e punimeve të kryera. Bashkëngjitur çdo situacioni mujor, do të jetë detyrimit edhe fatura tatimore. Personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë TVSH-në çdo muaj kalendarik. Fatura tatimore e përpiluar si më sipër, regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjeve dhe të shitjeve të shoqërisë.

Lejohet kreditimi i TVSH-së së paguar në blerjet e bëra për këtë qëllim. Kreditimi lejohet i plotë për rastet kur personi i tatueshëm kryen aktivitet ekonomik plotësisht të tatueshëm, si dhe i pjesshëm kur kryhen aktivitet pjesërisht të tatueshëm. Është kusht që ndërtesat e kësaj natyre duhet të jenë të destinuara për kryerjen e aktiviteteve të tatueshme nga vetë shoqëria. Gjithashtu ndërtesat duhet të jenë të një tipi të tillë, që natyra dhe qëllimi i përdorimit të tyre të shpallen dhe aprovohen në lejen e ndërtimit të dhënë nga organet e qeverisjes vendore.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010)..

c) Kur një shoqëri ndërtimi e licencuar si e tillë ndërton shtëpi banimi për vete, llogarit dhe paguan TVSH-ne, sipas nenit 18.2 të ligjit mbi TVSH-ne.

Nëse merret paradhënie për punimet që do të kryhen, atëherë personi i tatueshëm që merr paradhënien detyrohet të lëshojë faturë në momentin e marrjes së saj dhe këtë faturë ta regjistrojë në librin e shitjes së periudhës tatimore në të cilën është marrë paradhënia.

8.1.3 “Furnizimi i dhënies me qira të ndërtesave”.

Pavarësisht nga përjashtimet e parashikuara në nenin 20 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, personi i tatueshëm gëzon të drejtën që në bazë të kërkesës së tij pranë organit tatimor, dhënia me qira e ndërtesave që ai furnizon, sipas pikës 3 të këtij neni, të mos e trajtojë si furnizim i përjashtuar, por ta konsiderojë furnizim i tatueshëm, sipas

nenit 16 të ligjit "Për TVSH-në". Në këto raste, subjekti furnizues depoziton një kërkesë me shkrim pranë drejtorisë trajonale tatimore ku deklarohet se qiradhënia do të trajtohet si furnizim i tatueshëm, duke deklaruar edhe të dhënat e subjektit qiramarrës (emri, NIPT, adresa etj).

Në rast se qiradhënësi kryen furnizim qiradhënie për subjekte të cilat ushtrojnë aktivitet të përjashtuar me ligj nga TVSH-ja (të tilla, si aktivitete lojëra fati, shërbim financiar etj.) qiradhënia trajtohet si furnizim i tatueshëm, vetëm në rast se në kontratën e qiradhënies, palët kanë rënë dakord se qiradhënien do ta trajtojnë si furnizim të tatueshëm me TVSH. Në këto raste, tatimpaguesi qiradhënës duhet të depozitojë, përveç kërkesës me shkrim pranë organit tatimor edhe kontratën e qirasë. Mungesa e kontratës, nuk i jep të drejtën e trajtimit të qiradhënies si furnizim i tatueshëm.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010).

8.2 Shërbimet financiare

Shërbimet financiare të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", janë furnizime të përjashtuara nga TVSH. Por nëqoftëse personi i tatueshëm kryen shërbime për mbikqyrje, transaksione që lidhen me artikujt e përdorur për koleksione apo veprime që lidhen me mbledhjen e borxhit, ai kryen furnizime të tatueshme.

Furnizime të tatueshme janë gjithashtu edhe sigurimi i jojetës, me përjashtim të sigurimit të jetës. Furnizime të jojetës janë të gjitha llojet e sigurimit të pasurisë, sigurimi i përgjegjësisë civile, të gjitha llojet e sigurimit të mjeteve motorike si dhe të gjitha llojet e tjera të sigurimeve të jojetës. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për të gjitha rastet e mësipërme do të llogaritet në masën 20 përqind të primit të sigurimit dhe së bashku me primin do të jetë i pagueshëm nga blerësi.

Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta për mjetet motorike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (kartoni jeshil) si dhe sigurimi i shëndetit për shtetasit në udhëtim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të trajtohen me TVSH në masën 0 %. Furnizime të tatueshme janë gjithashtu edhe sigurimet e pronës. Në këtë rast, në vlerën totale të primit të sigurimit do të përfshihet edhe TVSH.

*8.3 Banka e Shqipërisë

Në bazë të nenit 22 të Ligjit, furnizimi i arit, nga Banka e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë, si dhe i bankënotave dhe i monedhave nga Banka e Shqipërisë është furnizim i përjashtuar.

Por, në rastet kur Banka e Shqipërisë kryen veprimtari të tjera ekonomike të tilla si bërja e shtypshkrimeve të ndryshme, furnizimi i monedhave për qëllime numizmatike, etj, ajo bën furnizime të tatueshme dhe duhet të regjistrohet e të paguajë TVSH.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 datë 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 datë 15.01.2009).

8.4 Shërbimet postare

Shërbimi i furnizimit të pullave të postës për përdorim për shërbime postare dhe pullave të tjera të ngjashme, përjashtohen nga TVSH-ja. Por, në qoftë se posta bën importe apo kryen edhe

shërbime të tjera postare, dhe qarkullimi vjetor kalendarik i saj është më i madh se 5 milionë lekë, ajo duhet të regjistrohet dhe të paguajë TVSH-në.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010)..

8.5 Organizatat jofitimprurëse

Për qëllimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, organizatë jofitimprurëse është çdo shoqëri, institucion, shoqate apo organizate, që themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse" dhe që nuk është krijuar për përfitime ose të ardhura të antarëve të saj dhe rregullat e së cilës nuk lejojnë shpërndarje fitimesh apo pronash për antarët e saj.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit, furnizimet e bëra nga organizatat jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar, që do të thotë se këto organizata duhet t'i kryejnë vetë këto furnizime dhe këto furnizime të jenë bërë kundrejt pagesës së reduktuar sipas kushteve që përcakton neni 18 i ligjit, janë furnizime të përjashtuara nëse janë furnizim shërbimesh nga organizata fetare a filozofike me qëllim mirëqënien shpirtërore.

Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar kemi ne ato raste kur këto organizata nuk arketojnë pagesë ose, pagesa që ato arketojnë është dukshëm më e vogël se ç'duhet të ishte nëse qëllimi i tyre do të ishte fitimi, sipas Nenit 18, paragrafi 4 te ligjit mbi TVSH-ne.

Përkundrazi, kur këto organizata i bëjnë furnizimet e mësipërme kundrejt pagesës së plotë, ato bëjnë furnizime të tatueshme. Nëse një organizatë jofitimprurëse kryen veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër, ajo kryen veprimtari të tatueshme, pavarësisht nëse pagesa është e reduktuar apo e plotë. Në këtë rast, nëqoftëse volumi i qarkullimit është më i madh se **kufiri minimal i regjistrimit**, ajo është e detyruar të regjistrohet dhe të paguajë TVSH.

Mallrat e importuara kundrejt pagesës së reduktuar si ndihmë humanitare nga organizatat bamirëse humanitare, institucionet e kultit, organizatat fetare apo filozofike, organizatat jofitimprurëse që gëzojnë statusin e organizatave për përfitim publik me qëllim kryerjen e furnizimeve siç përcaktohet në nenin 24 të ligjit, nuk ngarkohen me TVSH.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7.2011).

Në bazë të nenit 1, paragrafi (b) i ligjit nr.10 003, datë 6.10.2008 "Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar", furnizimi i mallrave e shërbimeve nga organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik dhe që çmimet e mallrave dhe shërbimeve që ato furnizojnë janë dukshëm më të ulëta se çmimet e tregut do të jenë furnizime të përjashtuara, nëse këto OFJ përfitojnë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik.

Statusi i organizatave jofitimprurëse për përfitim publik jepet me autorizim nga Ministri i Financave, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Në bazë të pikës 6 të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, Ministri i Financave revokon ose pezullon autorizimin në rastet kur:

- a) Kur organizata jofitimprurëse kryen furnizime mallrash apo shërbimesh, jo kundrejt pagesës së reduktuar.
- b) Kur organizata jofitimprurëse kryen furnizim mallrash apo shërbimesh jo në përputhje me qëllimin për të cilin është krijuar.
- c) Kur organizata jofitimprurëse pengon, ose nuk bashkëpunon me organet tatimore dhe doganore gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre për kontroll, brenda kufirit të së drejtës që u jep legjislacioni në fuqi.
- ç) Nuk respekton dispozitat e kuadrit ligjor fiskal.
- d) Në rastet kur një organizatë jofitimprurëse nuk e ka statusin e përfitimit publik,
- i) në rastin e përfitimit të shumave të dhuruara, kur donatorët kanë kryer një dhurim që nuk kushtëzon që të përfitojë (furnizohet) në këmbim me asnjë shërbim apo mall nga OFJ-ja, atëherë ky dhurim parash, malli ose shërbimi nuk konsiderohet si një furnizim i tatueshëm dhe nuk aplikohet asnjëra nga shkallët tatimore.

Dhurime të tilla konsiderohen ato që:

- a) bazohen në programe apo fonde të dedikuara të donatorit për mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile, qoftë si mbështetje për fuqizim institucional të një organizate jofitimprurëse, qoftë për kryerjen nga ana e kësaj organizate e aktiviteteve në shërbim të interesave publike në përgjithësi apo grupeve të veçanta shoqërore; dhe
- b) dedikimi i fondeve të tilla nga donatorët bazohet në rregullat e brendshme të atij donatori dhe/ose bëhet publik nga vetë donatori paraprakisht dhurimit apo njëkohësisht me të;
- c) përfitues të mundshëm të këtyre fondeve janë vetëm organizatat jofitimprurëse.
- ii) Nëse, dhurimi kushtëzohet që të furnizohet në këmbim me para, mall ose shërbim të furnizuar nga OJF-ja dhe atëherë ky furnizim i bërë nga donatori është si çdo furnizim tjetër i tatueshëm dhe po ashtu furnizimi i bërë nga OJF-ja në këmbim të vlerës së dhurimit. Dhurime do të konsiderohen të tilla kur nuk plotësojnë kriteret e germës "i" më sipër.
(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 datë 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 datë 15.01.2009).

8.6 Diplomatët dhe organizatat ndërkombëtare

Në bazë të nenit 25, përjashtohen nga TVSH furnizimet që bëhen për misionet diplomatike e personelin e tyre, mbi bazën e reciprocitetit dhe për organizatat ndërkombëtare e personelin e tyre mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe NATO-n.

Në mbështetje të këtij neni, importimi i mallrave për misionet diplomatike dhe personelin e tyre është i përjashtuar nga TVSH. I përjashtuar nga TVSH është gjithashtu edhe importimi i mallrave për organizatat ndërkombëtare të njohura si të tilla nga shteti shqiptar dhe NATO. Përjashtimi për organizatat ndërkombëtare jepet sipas kushteve të vendosura prej konventave ndërkombëtare që themelojnë këto organizata.

Megjithatë, edhe pse janë të përjashtuara, si misionet diplomatike ashtu dhe organizatat ndërkombëtare dhe NATO, meqënëse bëjnë importe janë të detyruara të regjistrohen për TVSH dhe të pajisen me Çertifikatën e Numurit të Identifikimit.

Për blerjet brenda vendit, misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre, do të paguajnë TVSH në momentin e blerjes. Por, për TVSH e paguar në blerje ato do të rimbursohen me kusht që, çdo faturë blerjeje të jetë me e madhe se 10.000 lekë. E drejta e rimbursimit për ambasadat do të jepet në bazë të parimit të reciprocitetit. Kjo do të thotë që, do t'u rimbursohet TVSH e paguar në blerje vetëm misioneve diplomatike dhe personelit të tyre, shtetet e të cilave rimbursojnë TVSH për Ambasadën Shqiptare dhe personelin e saj. Me procedurat e rimbursimit të TVSH së paguar, do të merret Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila është përgjegjëse edhe për zbatimin e parimit të reciprocitetit. Kjo drejtori do ti pajisë misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, e personelin e tyre me formularin "Kërkesë për Rimbursim" e cila është ne formularin bashkëngjitur ketij udhezimi. Çdo mision diplomatik, organizatë ndërkombëtare për blerjet e bëra nga vetë ato ose nga personeli i tyre do të dërgojë në drejtorinë e mësipërme dy kopje të formularit "kërkesë për rimbursim" (të firmosur e të vulosur nga titullari i ambasadës apo i organizatës ndërkombëtare) të cilave u bashkëngjisin edhe faturat origjinale të blerjes. Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Jashtme, kopjen origjinale të formularit "kërkesë për rimbursim" dhe faturat origjinale të blerjes e dërgon në degen e tatimeve. Dega e tatimeve është e detyruar që brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të mësipërm nga ana e Drejtorisë së Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të bëjë rimbursimin e TVSH së paguar në faturat përkatëse. Brenda këtij afati, dega e tatimeve verifikon direkt në vend tek shitësi, faturën e lëshuar nga ai për misionin diplomatic apo organizatën ndërkombëtare, regjistrimin e saj në librin e shitjeve, pasqyrimin e të dhënave në deklaratën e pagesës së TVSH për muajin përkatës dhe derdhjen në fakt të TVSH së mbledhur nga subjektet e mësipërme.

Pas verifikimit dhe miratimit të kërkesave për rimbursim, Drejtoria Rajonale Tatimore i dërgon zyrtarisht Ministrisë së Punëve të Jashtme formularin nr. 3
“Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së një kopje e të cilit dërgohet zyrtarisht dhe në Thesar. Ministria e Punëve të Jashtme përpilon urdhërpagesën për rimbursim (në katër kopje), për çdo trup diplomatik, në bazë të formularit nr. 3 dhe e dërgon pranë Degës së Thesarit, ku kjo e fundit bën pagesat sipas legjislacionit në fuqi. Dega e Thesarit, pasi kontrollon përputhshmërinë e listës përmbledhëse, bashkëlidhur urdhërpagesave me atë të formularit nr. 3, kryen pagesat me sistemin informatik financiar të qeverisë. Në fund të çdo muaji, Drejtoria

**Rajonale Tatimore, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Dega e Thesarit bëjnë rakordimet për pagesat e kryera gjatë periudhës mujore.
(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/4, dt. 16.5.2014, botuar ne FI.Z. nr. 70, dt. 20.5.2014).**

Përsa i përket blerjeve që personeli i NATO dhe bazat e saj brenda territorit të Shqipërisë, bëjnë brenda vendit, ato nuk do të paguajnë TVSH në pikën e blerjes. Për këtë në pikën e blerjes përfaqesuesi i NATO-s, është i detyruar t'i dorëzojë shitësit një Çertifikatë Lëvrimit, sipas modelit bashkangjitur, mbi bazën e të cilës shitësi harton faturën tatimore me TVSH 0%. Në fund të faturës, shitësi bën shënimin “ky përjashtim nga TVSH bazohet në Çertifikatën e Lëvrimit Nr.....datë.....” Zyra e autorizuar për lëshimin e Çertifikatës së Lëvrimit, pranë Komandës së NATO-s në Shqipëri, çdo muaj, brenda datës 10 dërgon në degët e tatimeve ku janë bërë blerjet pa TVSH, një listë përmbledhëse së bashku me kopjet e Çertifikatave të Lëvrimit të lëshuara për blerjet e realizuara në muajin paraardhës, që do të shërbejë për kryqëzimin dhe verifikimin e faturave tatimore të lëshuara me TVSH 0%.

8.7 Operacionet hidrokarbure. (SHFUQIZOHET me Udhëzim nr. 6/1, date 17.03.2014. Botuar ne FI.Z. nr. 32, date 17.3.2014.)

8.8 Ambalazhet, materialet e barnave dhe furnizimi i barnave

8.8.1 Furnizimi i ambalazheve e materialeve të barnave

Furnizimi i ambalazheve e materialeve që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, janë furnizime të përjashtuara.

8.8.2 Furnizimi i barnave dhe shërbimeve shëndetësore

Që prej datës 1 prill 2014, furnizimi i barnave, shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Në kuptim të kësaj pike, me barna kuptohen barnat për konsum njerëzor dhe barnat që përdoren për kafshët.

8.8.2.1, Për barnat e importuara dhe të prodhuara në vend, të pajisura me pullën e kontrollit me çmimin me TVSH 10%, me qëllim për t'u tregtuar (shitur) që rezultojnë gjendje në subjektet farmaceutike deri në datën 31 mars 2014, do të aplikohet TVSH-ja në masën zero për qind, në shitje, pavarësisht nga masa e TVSH-së që është e shënuar në pullë.
(Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/2, datë 3.4.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 44, datë 7 prill 2014).

Të gjitha pullat e kontrollit të barnave që shiten nga data 1 prill 2014, nuk do të kenë të përfshirë TVSH-në në çmimin përfundimtar të shitjes.

Qendra e Kontrollit të Barnave merr masa që në pullën e kontrollit të barnave të evidentohet çmimi përfundimtar pa TVSH.

Gjatë muajit prill 2014, çdo person juridik apo fizik, importues, prodhues apo tregtar i barnave, do të deklarojë stokun e barnave deri në datën 31.3.2014 në organin tatimor ku është i regjistruar.

Që prej datës 1 prill 2014, furnizimi i shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore, publike dhe private, që kanë karakter terapeutik, si dhe të domosdoshëm për arritjen e qëllimeve terapeutike të synuara nga hospitalizimi dhe kujdesi mjekësor ndaj shtetasve, janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja.

(Ndryshuar me Udhezimin nr. 6/1, date 17.3.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 32, date 17.03.2014).

Në këto shërbime përfshihen:

a) Furnizimi i shërbimeve të kujdesit spitalor, të kujdesit shëndetësor parësor, shërbimi i urgjencës mjekësore, ekzaminimet mjekësore terapeutike të siguruara nga ana e institucioneve spitalore, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe të diagnostikimit (klinika dhe qendra shëndetësore), publike dhe private.

b) Furnizimet e shërbimeve shëndetësore të kryera në kuadrin e profesionit të tyre nga stomatologët, përfshirë dhe furnizimet me proteza, si pjesë e furnizimit të shërbimit stomatologjik ndaj personit, vetëm për qëllime të kujdesit shëndetësor.

c) Shërbimet e analizave mjekësore, kimike për diagnostikim, analizat mjekësore parandaluese në kuadër të kujdesit mjekësor të ofruar nga një institucion shëndetësor i njohur si i tillë.

ç) Shërbimet e ofruara në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë profesionale si mjek ose profesione të tjera mjekësore të licencuara si të tilla, të cilat bëhen për qëllime të kujdesit për shëndetin.

d) Ekzaminimet mjekësore për lëshimin e certifikatave mjekësore të aftësisë për personat, kur këto shërbime synojnë të mbrojnë shëndetin.

Trajtohen me shkallë tatimore prej 20%:

a) Analizat biologjike të kryera në kuadrin e kërkimit të atësisë;

b) Lëshimi i certifikatave mjekësore për vlerësimin e dëmeve trupore të pësura (veprim gjyqësor) etj.;

c) Shërbimet e ofruara nga veterinerët në ushtrimin e profesionit të tyre;

ç) Shërbimet e kryera nga qendrat e trajtimit të bukurisë, masazheve, shërbime e trajtime estetike, kozmetike, rekonstruktive, nga institucione shëndetësore, publike apo private, apo institucione të tjera të licencuara për këtë qëllim;

d) Shërbimet e ofruara nga individë, të cilët aplikojnë metoda jotradicionale trajtimi mjekësor.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

8.9 Furnizimi i arit të përpunuar

Në vlerën e tatueshme të arit të përpunuar, të importuar dhe, arin e përpunuar, të furnizuar brenda vendit, nuk përfshihet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

Njëkohësisht, në vlerën e tatueshme të një importi apo furnizimit brenda vendit, përfshihen përbërës materialë të tillë si, argjend, gurë të çmuar, lëndë plastike, vlera e punës së gjallë, firo të përpunimit, etj.

Lënda e parë ar e përdorur për prodhimin e bizhuterive, matet dhe konvertohet në ar me përmbajtjen më të lartë të arit të pastër në të 999,9%, ose ar 24 karat. Një lëndë e tillë me përmbajtje të arit kimikisht të pastër është e kuotuar në bursë, ku edhe përcaktohet çmimi i saj.

Në kushtet e përpunimit, lidhja ar i përdorur si lëndë e parë me metale të tjera krijon kategori të ndryshme ari që dallojnë nga njera-tjetra nga përqindja e arit të pastër. Cilësitë standarte më të përdorshme të arit janë:

8 karat	-	333/000
9 karat	-	375/000
14 karat	-	585/000
18 karat	-	750/000
21 karat	-	875/000
24 karat	-	999,9/000.

Në cdo bizhuteri është e stampuar edhe shifra “për mijë” e arit të pastër në të. Kjo shifër detyrimisht paraqitet në faturën e importit dhe faturën tatimore për furnizimet brenda vendit.

Nëse numri i stampuar është 750, atëherë lidhja është klasifikuar 18 karat dhe përmban 7,50 gram ar të pastër në 10 gram të lidhjes gjithsej.

a) Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të importuar.

Vlera e tatueshme për arin e përpunuar, të importuar, përcaktohet në përputhje me legjislacionin doganor e atë tatimor.

Vlerës së tatueshme të llogaritur sipas pikave 3 e 4 të nenit 26 të ligjit nr.7928 datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën shtuar”, i ndryshuar, i zbritet vetëm vlera e arit të përdorur si lëndë e parë, mbështetur në pikën 5 të këtij neni.

Dokument bazë justifikues është fatura e shitësit të huaj lëshuar në adresë të blerësit vendas.

Nga vlera gjithsej mallit të importuar, në faturë detyrimisht duhet të paraqitet veçmas vlera e arit të konvertuar në ar të pastër, si dhe në valutë.

Mungesa e një ndarje të tillë të vlerës së një furnizimi, nuk i jep të drejtën importuesit për të mospërfshirë në vlerën e tatueshme të importit vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Nga vlera gjithsejt që paraqitet në faturë zbritet vlera e arit të përdorur si lëndë e parë dhe shuma që del, është e barabartë me vlerën e tatueshme që merret për bazë edhe për llogaritjen e TVSH-së.

Organet doganore për llogaritjen e bazës së tatueshme për arin e përpunuar të importuar do të përdorin kursin e këmbimit të arit të publikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e cila i referohet Agjensisë REUTERS.

Shembull :

Në doganën shqiptare paraqitet importuesi A për të deklaruar e zhdoganuar bizhuteri me bazë ari.

Në faturën që ai disponon që ja ka lëshuar shitësi i huaj, shënohet:

Sasia - 3 000 gr. bizhuteri, - nr. stampuar - 585 (14 karat).

Llogaritja e vlerës së tatueshme bëhet si më poshtë:

- Konvertimi i sasisë së bizhuterive të importuara në ar të pastër:

$3\,000 \times 0,585 = 1\,755$ gr. ar i pastër, sasi e cila në faturë paraqitet veçmas edhe e shprehur në valutë.

Kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të importit dhe zbritet nga vlera gjithsejt e arit të importuar. Mbi vlerën e mbetur, bëhet taksimi në doganë për efekt të TVSH-së, sipas procedurave të zakonshme të zhdoganimit.

TVSH e zbatuar mbi vlerën e mbetur deklarohet si e zbritshme nga A.

b) Vlera e tatueshme e arit të përpunuar të furnizuar brenda vendit.

Vlera e furnizimit brenda vendit është sa pagesa e plotë e atij furnizimi.

Vlera e tatueshme e arit të përpunuar, të furnizuar brenda vendit, llogaritet, duke zbritur nga pagesa e plotë e furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Dokument bazë justifikues është fatura e furnizuesit, person i tatueshëm, e lëshuar në adresë të blerësit, e cila paraqet të ndarë veçmas vlerës totale të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Mungesa e një ndarje të tillë të vlerës së një furnizimi brenda vendit, nuk i jep të drejtë furnizuesit që të mospërfshijë në vlerën e tatueshme të furnizimit, vlerën e arit të përdorur si lëndë e parë.

Pavarësisht natyrës së furnizimit, me shumicë apo me pakicë dhe pavarësisht vlerës së furnizimit, nga furnizuesi person i tatueshëm, lëshohet faturë tatimore sipas modelit të përcaktuar në nenin 36 të ligjit të TVSH-së.

Shembull :

Personi i tatueshëm A ushtron veprimtarinë ekonomike në fushën e përpunimit dhe tregtimit me shumicë të bizhuterive.

Klienti i tij B është njëkohësisht person i tatueshëm që ushtron veprimtarinë në fushën e shitjes me pakicë të bizhuterive e artikujve të tjerë të luksit.

B porositi dhe blen tek A, disa artikuj bizhuterie me bazë ari, me sasi - 700 gr. dhe nr. stampuar - 750 (18 karat).

- Konvertimi i sasisë së bizhuterive të furnizuara në ar të pastër:
 $700 \times 0,750 = 525$ gr. ar i pastër.

- Kursi i publikuar nga Banka e Shqipërisë është:
 $1 \text{ gr. ar i pastër} = 1850$ lekë

- Vlera e arit të përdorur si lëndë e parë.

- $525 \times 1850 = 971\,250$ lekë

Kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën e tatueshme të furnizimit. Në faturën tatimore që A lëshon për B, paraqet veçmas këtë vlerë dhe sasinë respektive, të cilat, korespondojnë me të dhënat e arit të furnizuar si lëndë e parë.

TVSH zbatohet mbi vlerën e mbetur të përpunimit dhe deklarohet si e mbledhëshme nga furnizuesi dhe e zbritshme nga blerësi.

8.10 Shitja e librave, e gazetave, e revistave dhe shërbimet e reklamave në to.

Përfshihen nga tatimi mbi vlerën e shtuar furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetatat. Në këtë rast vlera e tatueshme në faturat tatimore që shtypshkronjat lëshojnë për gazetatat, nuk ngarkohet me TVSH.

Shitja e gazetave, e revistave dhe e librave të çdo lloji, është furnizim i përjashtuar.

Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe nga media elektronike është furnizim i përjashtuar.

Vlera e tatueshme në faturat tatimore që mediat e shkruara dhe elektronike lëshojnë për porositarin e reklamave, nuk ngarkohet me TVSH.

Furnizimi i përjashtuar është edhe shitja e Fletoreve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, botuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare.

8.11 Lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet

Furnizimet e shërbimeve të lojërave të fatit, të kazinove dhe të hipodromeve, janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

8.12 Furnizimet e përjashtuara në import

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH, mbështetur në nenin 26/1 të ligjit :

- Importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat brenda vendit është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kjo pike nuk zbatohet për furnizimin në import të periodikeve, revistave, shtypshkrimeve dhe librave të cdo lloji.

- Importimi i mallrave të vendosura në regjimin tranzit.

- Importimi i mallrave të deklaruar për të qënë nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv.

- Importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm.

- Importimi i mallrave nga NATO dhe organizmat e saj në kuadër të operacioneve në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

- Importimi i materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura të dhuruara nga vendet e Aleancës së Nato-s dhe ato partnere.

- importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu edhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

- importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

8.13 Operacione nën regjimin e përpunimit aktiv

Nënkontraktorët të cilët bëjnë furnizime shërbimesh për shoqëritë e përpunimit aktiv, janë të përjashtuar nga TVSH, vetëm për furnizimin e shërbimit të kryer prej tyre për llogari të shoqërive të përpunimit aktiv. Pra, vetëm për përpunimin e mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u rieksporuar.

Aktivitetet e klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv, konsiderohen teresisht të destinuara për eksport. Kushtet e ekzistencës së kësaj natyre operacionesh janë :

a) Përpunuesi (nënkontraktori) asnjëherë nuk duhet të behet pronar i materialeve të sjella nga porositesi.

b) Materialet e sjella nga porositesi tek përpunuesi, duhet të trupëzohen tërësisht në produktin e fabrikuar.

Materialet e sjella nga porositesi ne formen e lëndës së parë duhet t'i kthehen atij fizikisht nga përpunuesi në formën e gjysëmproduktit ose produktit të gatshëm, me perjashtim te mbetjeve teknologjike gjate procesit te prodhimit dhe në përputhje me kartat teknologjike të prodhimit. Kjo kerkon si domosdoshmeri, qe keto materiale te jene te identifikuara me dokumentacion, tek perpunuesi per gjate gjithë kohes se perpunimit. Nëse rezulton që sasia e gjysëmproduktit ose produktit të gatshëm është më e vogël nga sa duhej të ishte kundrejt materialeve të përdorura në përpunim, diferenca konsiderohet si shitje e kryer nga përpunuesi.

c) Detyrime te vecanta.

Midis porositësit (kontraktori kryesor i vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv) dhe përpunuesit (nënkontraktori) të jetë lidhur një kontratë në përputhje me Kodin Civil.

Përpunuesit duhet te mbajnë një regjistër te vecantë, ku përshkruhet realizimi i punimeve për llogari të porositësit. Në këtë regjistër duhet të shënohet identiteti i porositësit, pra emri tregtar, NIPT, emri mbiemri i administratorit, statusi juridik i tij, adresa e selise dhe dega e tatimeve në të cilën është regjistruar.

Per cdo porosites dhe per cdo operation hyrje dhe dalje, shënohet :

- Lloji dhe sasia e materialeve objekt i perpunimit dhe data e hyrjes.

- Lloji dhe sasia e gjysëm produktit ose produktit te fabrikuar si dhe data e daljes.

- Ne regjister duhet te evidentohet edhe malli gjendje tek perpunuesi. Për këtë hartohet inventari mujor.

- Lëvizja e cdo sasie gjysëmprodukti ose produkti të gatshëm nga perpunuesi (nenkontraktori) tek porositesi (kontraktori), shoqerohet me fature tatimore pa TVSH, per vleren e shërbimit te kryer. Per te perfituar nga skema e mesiperme cdo tatimpagues nenkontraktor duhet te paraqese nje kerkese ne degen perkatese te tatimeve e cila pasi ben verifikimet e duhura leshon autorizimin e perfshirjes ne kete skeme. Te gjitha autorizimet e leshuara evidentohen nga dega e tatimeve ne nje regjister te vecante ku shenohet emri i tatimpaguesit (nenkontraktorit), NIPT, adresa, lloji i veprimtarise, kontraktori per te cilin punon, data e leshimit te autorizimit dhe afati i vlefshmerise.

8. Pas pikës 8.13 të udhëzimit shtohet pika 8.14 me përmbajtjen si më poshtë:

8.14. Furnizimi i shërbimeve arsimore

Furnizimi i shërbimeve arsimore nga institucionet arsimore, publike dhe private, në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), ligjin nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), duke filluar nga data 1 tetor 2010, është furnizim i përjashtuar.

Në kuptim të ligjeve të sipërcituar konsiderohen furnizim i shërbimeve arsimore, furnizimet e mëposhtme:

3. Furnizimi i shërbimit të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore, nga institucione të arsimit të lartë, si: universitetet, akademitë, kolegjet profesionale, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare, përveç furnizimeve të tjera që

kryejnë këto institucione në kuadër të veprimtarisë së tyre studimore, shkencore të cilat janë furnizime të tatueshme me TVSH.

4. Furnizimi i shërbimeve arsimore të mësimdhënies për realizimin e planeve dhe programeve mësimore në nivele të ndryshme shkollore e parashkollore (arsimi bazë; arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional, arsimi special, kopshtet).

5. Furnizimi i shërbimeve arsimore që kryhen nga institucionet arsimore plotësuese jopublike, që funksionojnë jashtë strukturave të institucioneve arsimore, publike e private dhe ku punohet në drejtim të arsimimit e të edukimit në lëndë e specialitete të veçanta (p.sh. kurse kualifikimi specifike), brenda ose jashtë planeve mësimore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

9.SKEMA TË VEÇANTA

9.1 Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së.

Bazuar në pikën 2.1 të nenit 26 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për një periudhë deri në dymbëdhjetë muaj, sipas së cilës TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit.

I. Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për importimin e makinerive e të pajisjeve. Kjo skemë zbatohet për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi vlerën e Shtuar. Kusht është që importi i kryer të jetë në funksion të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm dhe kushtëzohet nga lloji i saj.

Përsa i përket kuptimit të termave, jepen përcaktimet e mëposhtme:

- “Makinë”, çdo konstruksion, i krijuar prej njeriut, që, duke marrë energji në një formë të përshtatshme dhe udhëzimet e duhura, është në gjendje të kryejë punë.

- “Linjë teknologjike”, tërësia e makinerive, pajisjeve dhe instalimeve të ndryshme, të lidhura ndërmjet tyre, që bëjnë të mundur realizimin e një procesi teknologjik.

- “Proces teknologjik”, tërësia e metodave, që duhen të ndiqen, hap pas hapi, për të bërë të mundur të arritjen e qëllimit, për të cilin bëhet investimi përkatës.

- “Pajisje”, pajisjet dhe aparaturat, që shërbejnë si plotësues të makinerive dhe që ndihmojnë për funksionimin e rregullt të tyre, si dhe për matjen dhe kontrollin e parametrave të punës.

1.1 Kushte të përgjithshme

Pagesa e TVSH-së shtyhet deri në dymbëdhjetë muaj nga çasti i kryerjes së importit. Ky afat mund të jetë më i shkurtër, kur:

- nga vetë personi i tatueshëm, kërkohet të bëhet pagesa në një çast më të hershëm se mbarimi i periudhës dymbëdhjetë mujore;

- personat e tatueshëm importojnë makineri me qëllim shitjen e tyre te persona të tretë. Pagesa e TVSH-së nga këta persona shtyhet deri në periudhën tatimore (muajin) në të cilën bëhet edhe shitja e makinerive.

Personi i tatueshëm, përfitues i kësaj skeme, paraqet në organin doganor dokumentacionin e nevojshëm justifikues, shoqëruar të makinerive e pajisjeve të importuara, bazuar në kërkesat e legjislacionit tatimor.

Vlera e tatueshme e makinerive dhe e pajisjeve të importuara përcaktohet në përputhje me dispozitat e legjislacionit, doganor dhe tatimor, pavarësisht nëse makineritë e pajisjet e importuara janë apo jo të taksueshme me taksa doganore. Kjo vlerë përfshin, gjithashtu:

a) shpenzimet e transportit e të sigurimit dhe shpenzimet e tjera, të përfshira në importimin e makinerive e të pajisjeve, deri në çastin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.;

b) tarifat, taksat dhe detyrimet e pagueshme, si pasojë e eksportimit të këtyre makinerive e pajisjeve nga shtete, prej të cilëve ato eksportohen, apo të pagueshme si rezultat i importimit të tyre, përveç TVSH-së së pagueshme.

Organi doganor, pasi përcakton vlerën e tatueshme të makinerive dhe të pajisjeve, me të gjitha elementet përbërëse të saj, zbaton mbi këtë vlerë shkallën tatimore të TVSH-së, e cila është në fuqi në çastin e importimit të makinerive e pajisjeve.

TVSH-ja e llogaritur nga organi doganor nuk paguhet nga personi i tatueshëm në çastin e zhdoganimit të makinerive e pajisjeve të importuara; ajo paguhet nga personi i tatueshëm importues, brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe pajisjeve. Pagesa e saj bëhet për llogari të degës doganore, ku janë kryer procedurat e importit.

1.2 Personat e tatueshëm importues

a) persona që importojnë makineri e pajisje, për investim për veprimtarinë e tyre.

Në çastin e importit të makinerive e pajisje për t'u investuar, personit të tatueshëm që importon për të investuar, i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4) me një numër regjistrimi R. Në kutinë nr. 37 të DAV-it, është vendosur kodi shtesë 991 për (shtyrjen e pagesës së TVSH-së për makineri e pajisje).

Në kutinë nr. 47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet 2, që nënkupton mospagimin e TVSH-së në çastin e importimit. Kështu në totalin e detyrimeve që duhen paguar paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Në momentin e pagesës së TVSH-së printohet DAV-i, versioni i fundit i deklaratës, e cila ka të njëjtin numër regjistrimi R dhe në kutinë 37 do të jetë kodi shtesë 003 për (pagesën e TVSH-së për makineri e pajisje për investime).

Në kutinë nr.47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet 2, që nënkupton mospagimin e TVSH-së.

Data e pagesës së TVSH-së në doganë, e paraqitur në dokumentin justifikues që përmendëm, përcakton edhe periudhën tatimore (muajin), në të cilën personi i tatueshëm e regjistron (vetëm për qëllim të mbajtjes së dokumentacionit për TVSH) dhe deklaron TVSH-në si të zbritshme pranë organeve tatimore.

Regjistrimi në librin e blerjeve të TVSH-së, i vlerës së makinerive e pajisjeve, si dhe TVSH-së së zbatuar në import, bëhet në periudhën tatimore (muajin) që është paguar TVSH-ja në import.

Për çdo regjistrim vendoset dukshëm, në çastin e kryerjes së importit shënimi “Import me shtyrje pagese të TVSH-së, referuar deklaratës doganore nr. ____ / datë ____”.

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së, të kësaj periudhe tatimore, vlera e tatueshme e makinerive dhe e pajisjeve dhe TVSH-ja, e llogaritur dhe e paguar për importin e tyre, raportohen përkatësisht në rubrikat e importit (14) dhe (15).

b) Personat e tatueshëm, që imporojnë makineri për t'i shitur.
Këta persona nuk paguajnë TVSH në doganë për makineritë e përcaktuara në aneksin, që i bashkëlidhet vendimit të Këshillit të Ministrave nr.559, datë 16.08.2006.

Personat e tatueshëm, që importojnë makineri për furnizimin e personave të tretë, kanë të drejtë të përfitojnë nga skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së deri në periudhën tatimore (muajin), në të cilin bëjnë shitjen e tyre, por jo më vonë se dymbëdhjetë muaj nga çasti i importimit.

Në çastin e importit të makinerive, personit të tatueshëm i lëshohet deklarata doganore (DAV) e importit (IM4) me një numër regjistrimi R. Në kutinë nr.37 të DAV-it është vendosur kodi shtesë 992 për (shtyrjen e pagesës së TVSH-së së makinerive për shitje).

Në kutinë nr. 47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-it, kolona MP, në zërin TVSH shënohet 2, që nënkupton mospagimin e TVSH-së në çastin e importimit. Kështu në totalin e detyrimeve që duhen paguar paraqitet vetëm shuma e detyrimeve doganore.

Në të njëjtën periudhë tatimore (muaj) kur personi i tatueshëm shet makineritë e importuara, detyrohet të paguajë TVSH-në, për importin e tyre, në degën e doganës ku është bërë importi.

Në momentin e pagesës së TVSH-së printohet DAV-i, versioni i fundit i deklaratës e cila ka të njëjtin numër regjistrimi R dhe në kutinë 37 do të jetë kodi shtesë 004 për (pagesën e TVSH-së për makineri për t'u shitur).

Në kutinë nr.47 (llogaritja e detyrimeve) të DAV-i, kolona Mp, në zërin TVSH shënohet 1, që nënkupton pagimin e TVSH-së.

Ky dokument, versioni i fundit, është edhe dokumenti justifikues i importit i vlefshëm për regjistrimet e mëtejshme për efekt të TVSH-së.

Data e pagesës së TVSH-së në doganë, e paraqitur në dokumentin justifikues që përmendëm, përcakton edhe periudhën tatimore (muaji), në të cilën personi i tatueshëm e regjistron (vetëm për qëllim të mbajtjes së dokumentacionit për TVSH) dhe deklaron TVSH-në si të zbritshme pranë organeve tatimore.

Regjistrimi në librin e blerjeve të TVSH-së, i vlerës së makinerive e pajisjeve si dhe TVSH-së së zbatuar në import, bëhet në periudhën tatimore (muajin), që është paguar TVSH-ja në import.

Për çdo regjistrim vendoset dukshëm, në çastin e kryerjes së importit, shënimi "import me shtyrje pagese të TVSH-së, referuar deklaratës doganore nr. ____ / datë ____".

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së, të kësaj periudhe tatimore, vlera e tatueshme e makinerive dhe TVSH-ja, e llogaritur dhe e paguar për importin e tyre, raportohen përkatësisht në rubrikat e importit (14) dhe (15).

c) Personat që importojnë pajisje me qëllim për t'i shitur.

Për importin e pajisjeve me qëllim shitjeje nuk zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së.

Në çastin e importit të pajisjeve, bëhet edhe pagesa e TVSH-së në doganë lidhur me këtë import.

Regjistrimet e mëtejshme bëhen njëloj si ato të importeve të zakonshme të mallrave.

I/I Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për importimin e makinerive e të pajisjeve, kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimi i ofrimit të prodhimit apo shërbimit është mbi 12 muaj. Bazuar në pikën 2.1 të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, për rastet kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më i gjatë se 12 muaj, Ministri i Financave ka autoritetin ta zgjasë afatin e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, në varësi të ciklit të zhvillimit të investimit të parashikuar në marrëveshje apo kontratë. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë, në çastin e importit. Skema e re e shtyrjes së pagesës së TVSH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. (Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 datë 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 datë 15.01.2009).

II. Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për importimin e energjisë elektrike nga KESH.

Për importimin e energjisë elektrike nga KESH-i, zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së mbi importin e energjisë elektrike deri në çastin e dorëzimit të deklaratës së TVSH-së, duke mos paguar TVSH-në në doganë në çastin e importit.

Në periudhën tatimore, që i bashkëlidhet kryerjes së importit të energjisë elektrike nga KESH, lëshohet menjëherë një faturë tatimore shitjeje me TVSH (brenda vendit), për të njëjtën vlerë me atë të energjisë elektrike të importuar, ku shitësi dhe blerësi janë i njëjti person.

Kjo faturë regjistrohet nga KESH edhe në librin e shitjeve dhe në atë të blerjeve.

Në formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së të së njëjtës periudhë tatimore, vlera e tatueshme e energjisë elektrike të importuar, si dhe e TVSH-së së llogaritur për të,

raportohen në kutitë përkatëse të importit; në të njëjtën deklaratë të njëjtat vlera raportohen si shitje brenda vendit dhe TVSH e llogaritur për këto shitje.

KESH-i detyrohet të dorëzojë në degën e Tatimeve, ku është regjistruar, brenda datës 14 të muajit pasardhës, së bashku me formularin e deklarimit dhe të pagesës së TVSH-së, edhe dokumentet e mëposhtme, në dy kopje:

- kopje të faturës së shitjes së hartuar, si më lart shpjeguar;
 - kopje e librit të shitjes dhe të blerjes të periudhës përkatëse tatimore;
- kopje të deklaratës doganore të importit.

KESH-i detyrohet të dorëzojë në degën e doganës përkatëse, brenda datës 25 të muajit pasardhës, për mbylljen e llogarive kontabël të importit, një kopje të çdo dokumenti të mëposhtëm:

- kopje të faturës së shitjes së hartuar;
- kopje të librit të shitje dhe të blerjes së periudhës përkatëse tatimore;
- kopje të FDP-së, të gjitha këto të vulosura nga zyra e TVSH-së.

Mosdërgimi i të gjithë dokumentacionit në degën e doganës u jep të drejtë organeve doganore të pezullojnë aplikimin e kësaj skeme.

9.2. Kartat me parapagim

Operatorët kryesorë të telekomunikacioneve dhe operatorët kryesorë të transmetimeve televizive tokësore dhe satelitore, llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave të parapaguara që ata u furnizojnë distributorëve të tyre.

Furnizimi i këtyre kartave në vazhdim nga distributorët do të konsiderohet jashtë objektit të TVSH-së dhe distributorët nuk kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e faturuar nga operatorët kryesorë në lidhje me këto karta. Ndërkohë, **distributorët e kartave të parapaguara** i faturojnë operatorit kryesor vlerën e komisionit që ato përfitojnë për shërbimin që kryejnë. TVSH e llogaritur në këtë rast, është e kreditueshme për operatorin kryesor.

Shembull:

Supozojmë që operatori kryesor i telekomunikacionit X hedh në treg karta telefonike me çmim të shpallur 1.000 lekë (përfshirë TVSH).

Kjo shoqëri do të lëshojë një faturë ku TVSH e llogaritur do të jetë:

$$833.4 + 166.6(\text{TVSH}) = 1.000 \text{ lekë.}$$

Shoqëria distributore Y që blen kartën me faturën e mësipërme, nuk llogarit më TVSH në rishitjen e kësaj karte dhe nuk ka të drejtë të kreditojë 166.6 lekë TVSH të faturës së lëshuar nga operatori kryesor.

Në rast se për shërbimin që i kryen operatorit X, distributori Y përfiton një komision në masën 15 % të çmimit të shpallur të kartës = 150 lekë, atëherë ai i lëshon një faturë tatimore me TVSH, ku TVSH e llogaritur do të jetë: $150:6=25$ lekë pra, $125+25(\text{TVSH}) = 150$ lekë. Operatori kryesor X ka të drejtë të kreditojë TVSH në blerje për shumën 25 lekë.

9.3 Skema e kompensimit të fermerëve dhe lista e produkteve të përfshira në skemë .

Fermerët, të cilët në kuadër të veprimtarisë së kryer prej tyre, në një nga fushat e prodhimit të produkteve bujqësore e blegtorale, furnizojnë një person të tatueshëm sipas kuptimit të ligjit Nr.7928 datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar, përfitojnë një kompensim kundrejt furnizimeve të kryera, sipas skemës së kompensimit të akorduar.

Lista e produkteve për të cilat zbatohet skema e kompensimit është si më poshtë :

A. Produktet bujqësore

- produkte bujqësore të përgjithshme;
- bimët zbukuruese dhe lulet, të natyrës dhe të serave;
- prodhime i kërpudhave;
- prodhime i fidanishteve (kultivimin e pemëve të reja për shitje), farave;
- produkte medicinale.

B. Produktet blegtorale

- qumësht dhe nënprodukte të qumështit;

C. Të tjera.

- mbarshtrim i bagëtime;
- mbarshtrim i shpendëve;
- mbarshtrimi i lepujve;
- mbarshtrim i bletëve;
- mbarshtrim i krimbit të mëndafshit;
- mbarshtrim i kërmillit;

Fermerët, përfitues të skemës së kompensimit, dhe që janë të pajisur me një kod personal lëshuar nga Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të kenë Kartën e Fermerit bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

9.4. Furnizimi i karburanteve

a) Regjimi fiskal

Importuesit e prodhuesit vendas të karburanteve (shoqëri anonime) janë furnizues të nivelit të parë dhe furnizojnë me shumicë klientët e tyre (shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar), të cilët më pas, furnizojnë me të njëjtin mall klientët, që normalisht janë konsumatorë finalë.

Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata

www.tatime.gov.al

Regjimi fiskal në këtë rast përcaktohet në mbështetje të nenit 11 të ligjit të TVSH-së. Importuesit dhe prodhuesit që janë furnizuesit primarë konsiderohen si kryesorë, ndërkohë që operatorët (sh.p.k.), të cilët furnizohen prej tyre, konsiderohen si agjentë.

Sipas pikës 1 të këtij neni, furnizimi i karburantit, i kryer nëpërmjet një agjenti (sh.p.k.), i cili vepron në cilësinë e agjentit për një person tjetër, është një furnizim prej kryesorit (sh.a.).

Në këtë rast agjenti luan rolin e ndërmjetësit në tregun e karburanteve midis personit kryesor dhe personave të tretë, klientë të tij.

Agjenti paraqitet si përfaqësues i kryesorit duke kryer një ndërmjetësim, të konsideruar si furnizim shërbimi dhe që është i tatueshëm si i tillë

Mbi vlerën e tatueshme të llogaritur në doganë për karburantin e importuar nga kryesori, aplikohet TVSH në shkallën tatimore 20%.

Kjo shumë është TVSH e zbritshme për kryesorin dhe është e kreditueshme prej tij brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

Përsa i përket furnizimit të mëpasshëm, personi që është në rolin e agjentit, paraqitet si furnizues i të tretëve, por duke vepruar për llogari të personit kryesor.

Fatura e lëshuar nga kryesori për llogari të agjentit të tij përmban të gjitha të dhënat që duhet të përmbajë një faturë tatimore sipas nenit 36 të ligjit. Çmimi i vendosur në të, është ai i shitjes me pakicë dhe mbi vlerën e tatueshme të çdo furnizimi, aplikohet TVSH në shkallën tatimore 20%. Ajo deklarohet si TVSH e mbledhshme nga personi që luan rolin e kryesorit dhe konsiderohet si TVSH e zbritshme për blerësin brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

Nga ana tjetër për këtë ndërmjetësim që kryhet për llogari të kryesorit, agjenti i faturon atij një shumë që konsiderohet si vlerë e tatueshme e këtij shërbimi (ndryshe komision), e barabartë me vlerën e ndërhyrjes së tij në treg. Mbi të zbatohet shkalla tatimore e TVSH-së prej 20%, e cila deklarohet si TVSH e mbledhshme nga agjenti. Njëkohësisht kjo shumë konsiderohet si TVSH e zbritshme për personin kryesor, si dhe është e kreditueshme prej tij brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

Shembull:

a) Supozojmë që furnizuesi kryesor e karburantit A është importues dhe në muajin maj importon 100 000 litra karburant.

Është llogaritur në doganë që vlera e tatueshme e karburantit të importuar është 8 000 000 lekë. Mbi këtë vlerë importi, aplikohet TVSH me shkallë tatimore 20% dhe konkretisht, vlera e saj është 1 600 000 lekë, e cila është e zbritshme nga kryesori A, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

b) Po në këtë muaj bëhet furnizimi i kësaj sasive e karburantit prej 100 000 litra nga kryesori A, me anë të agjentit B, person i tatueshëm ndërmjetës, për llogari të personave të tretë, konsumatorë finalë C.

Është llogaritur që vlera e tatueshme e këtij furnizimi është 12 000 000 lekë (100 000 litra x 120 lekë/litri çmimi i shitjes me pakicë pa TVSH). Mbi këtë vlerë aplikohet TVSH me shkallë tatimore 20% dhe konkretisht vlera e tatimit është 2 400 000 lekë.

Ky furnizim pasqyrohet nga furnizuesi A duke lëshuar faturë tatimore në adresë të blerësit B, agent i tij. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve të kryesorit A, së bashku me TVSH e paraqitur në të, si dhe në librin e blerjeve të B-së, nëse ky është person i tatueshëm dhe është e zbritshme për të brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

c) Ndërmjetësimi i kryer nga agjenti B konsiderohet si furnizim shërbimi prej tij, për llogari të kryesorit A. Për rastin konkret, vlera e shërbimit është 1 200 000 lekë (100 000 litra x 12 lekë/litri pa TVSH). Mbi këtë vlerë aplikohet TVSH me shkallë tatimore 20% dhe konkretisht vlera e tatimit është 240 000 lekë. Këto të dhëna pasqyrohen nga agjenti B, i cili lëshon një faturë tatimore në adresë të kryesorit A.

Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjes së agjentit B dhe librin e blerjeve të kryesorit A duke qenë e zbritshme për të brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit.

b) Detyrime të palëve.

Midis agjentit dhe kryesorit duhet të ekzistojë një marrëveshje lidhur me faktin e realizimit të furnizimit.

Konkretisht kërkohet që:

- të jetë e përcaktuar qartë roli i agjentit, në mënyrë që të kuptohet që agjenti po kryen një furnizim të shërbimit për llogari të kryesorit dhe jo për llogari të veprimtarisë së tij ekonomike;
- të jetë përcaktuar qartë që agjenti nuk është ekonomikisht zotëruesi i mallit, për rastin konkret karburantit, të cilin e ka furnizuar për llogari të kryesorit;
- agjenti nuk mund të furnizojë në një vendndodhje biznesi, mallra të së njëjtës natyrë (p.sh. karburant të llojit D1) të furnizuar nga kryesore të ndryshëm;
- të jetë përcaktuar qartë që agjenti nuk mund të ndryshojë çmimin e furnizimit të mallit që i është faturuar prej kryesorit;
- konsiderohet shkelje çdo ndryshim nga agjenti i çmimit fillestar me pakicë të faturuar nga kryesori. Përveç vlerësimit të detyrimit tatimor, zbatohet edhe gjobë sipas nenit 116 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

e) Furnizimi i karburantit ndërmjet shoqërive të tregtimit me shumicë (shoqërive anonime), kryhet vetëm në rastin kur janë importuese dhe kanë magazine doganore, shesin me njëra tjetrën karburant vetëm me regjim tranzit, konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës dhe vlera e tatueshme e tij, përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese. Ky rast aplikohet edhe në rastin kur një prodhues vendas furnizon një shoqëri të tregtimit me shumicë.

(Ndryshuar me Udhëzim, Nr.17/1, datë 5.8.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 130 datë 08.08.2008).

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/3 datë 13.11.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.176 datë 26.11.2008).

ç) Kur karburanti i furnizuar nga shoqëritë e tregtimit me shumicë është i destinuar të konsumohet për veprimtarinë ekonomike të konsumatorëve të mëdhenj, për nevoja të institucioneve apo enteve publike, si dhe për eksport, vlera e tatueshme e furnizimit, përcaktohet nga çmimi i paraqitur në faturën e lëshuar nga shoqëria furnizuese.

d) Kur karburanti furnizohet me tollona, në momentin e dorëzimit të tollonave, apo nëse më parë është bërë ndonjë pagesë, shoqëria furnizuese lëshon faturë tatimore për përfituesin e tollonave dhe lëshimi i faturës, përbën momentin e furnizimit.

Vlera e tatueshme e furnizimit përcaktohet nga çmimi i paraqitur i faturës së lëshuar nga shoqëria furnizuese.

Stacionet e shitjes me pakicë, në fund të muajit regjistrojnë shitjet me tollona në mënyrë që të evidentohen qartë sasi të shitura për llogari të secilës shoqërie lëshuese të tollonave. Shumat e tollonave hidhen në fund të muajit në një faturë tatimore përmbledhëse, e cila paraqitet në librin e shitjes, por pa efekte (pasi deklarimi është bërë më parë në momentin e dorëzimit të tollonave), pra ato deklarohen me storno.

Si provë e këtij furnizimi shërben kontrata e lidhur midis shoqërisë furnizuese me tollona dhe klientit në të cilën përveç të tjerash, paraqitet edhe sasia dhe çmimi i karburantit të furnizuar.

Dh) Klientëve, persona të tatueshëm, të furnizuar nga shoqëritë e shitjes me pakicë, apo ato të shitjes me shumicë të karburanteve, u lind e drejta e kreditimit të TVSH-së të paraqitur në faturat tatimore të lëshuara prej këtyre furnizuesve, Brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

e) Në të njëjtën zonë, kryesori nuk mund të faturojë tek pikat e treta çmime më të ulëta se çmimi i akorduar pikave të shijes nën pronësinë e tij.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/3 datë 13.11.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.176 datë 26.11.2008).

9.5 Furnizimi i cigareve

Në këtë paragraf, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- "Furnizues kryesorë" konsiderohen importuesit dhe prodhuesit vendas të cigareve.

- "Furnizues të ndërmjetëm" konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen me qëllim për të rishitur te furnizues të tjerë të ndërmjetëm dhe/ose te njësitë e shitjes me pakicë.

- "Njësi të shitjes me pakicë" konsiderohen tatimpaguesit që furnizohen për të shitur te blerësit, konsumatorë finalë.
- "Furnizim i parë" është furnizimi që furnizuesi kryesor bën për furnizuesit e ndërmjetëm apo për njësitë e shitjes me pakicë.
- "Çmim i shitjes me pakicë" është çmimi i paguar nga blerësi, konsumator final.

Furnizuesit kryesorë llogarisin TVSH-në mbi vlerën e tatueshme të çdo furnizimi që ato kryejnë.

Vlera e tatueshme e çdo furnizimi, të kryer nga furnizuesi kryesor për të tretët, përcaktohet nga shumëzimi i sasisë së cigareve të shitura, me çmimin e shitjes me pakicë, pa përfshirë TVSH-në.

Furnizimi i cigareve në vazhdim nga furnizuesit e ndërmjetëm, do të konsiderohet jashtë objektit të TVSH-së dhe këta persona blerës nuk kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e faturuar nga furnizuesit kryesorë në lidhje me atë furnizim.

Ndërkohë komisioni i përfituar nga furnizuesit e ndërmjetëm është i tatueshëm si furnizimi i një shërbimi kryer prej tyre. Mbi vlerën e tij zbatohet TVSH në shkallën tatimore 20% e cila është e kreditueshme për përfituesin e shërbimit brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

Nëse tatimpaguesi që merr furnizimin e parë, është tatimpagues i taksës vendore mbi biznesin e vogël (jo tatimpagues i TVSH-së), ai do t'i faturojë furnizuesit kryesor vlerën e ndërhyrjes në treg, pa llogaritur TVSH-në.

Sipas natyrës së transaksioneve e marrëdhënieve tregtare midis furnizuesit kryesor dhe furnizuesve të ndërmjetëm, faturimi bëhet sipas mënyrës së faturimit total të komisionit ose faturimit të fraksionuar të tij.

9.5.1. Faturimi e pagimi total i komisionit.

Sipas kësaj mënyre, furnizuesit të parë i faturohet totali i vlerës së shërbimit të të gjitha hallkave që ndërhyjnë në tregun e cigareve.

Furnizuesi i ndërmjetëm i faturon furnizuesit kryesor vlerën totale që do t'i shtohet produktit, nga ndërhyrja e tij dhe e të gjitha hallkave të tjera të mëpasshme në treg.

Furnizimet e tjera që furnizuesit e ndërmjetëm bëjnë për hallkat e mëpasshme deri te konsumatori final, janë furnizime për të cilat nuk llogaritet TVSH. Furnizimi i cigareve në vazhdim nga furnizuesit e ndërmjetëm, për furnizues të tjerë të ndërmjetëm apo për njësitë e shitjes me pakicë, do të konsiderohet jashtë objektit të TVSH-së. Ky furnizim do të faturohet me çmimin e shitjes me pakicë të cigareve minus vlerën e ndërhyrjes në treg që përfiton furnizuesi tjetër i ndërmjetëm apo njësia e shitjes me pakicë.

Fatura e lëshuar nga furnizuesit e ndërmjetëm do të jetë faturë tatimore, por në kolonën e TVSH-së së saj nuk paraqitet TVSH.

Shembull:

Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata

www.tatime.gov.al

Çmimi i shitjes me pakicë për një paketë cigare të markës Z është 200 lekë.

Rasti i I : Furnizuesi kryesor (X) furnizon personin e tatueshëm D, njësi shitjeje me pakicë.

X do të faturojë për D si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

D nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

D do të faturojë për X, vlerën e ndërhyrjes së tij në treg $30 + 6 \text{ (TVSH)} = 36 \text{ lekë.}$

X ka të drejtë të kreditojë TVSH (6 lekë) të faturës së lëshuar nga D për vlerën e ndërhyrjes së tij në treg.

Njësia e shitjes me pakicë e shet një paketë cigare te konsumatori final pa llogaritur TVSH në vlerën 200 lekë.

Rasti II: Furnizuesi kryesor (X) furnizon një njësi shitje me pakicë (D), tatimpagues i taksës vendore mbi biznesin e vogël (jo subjekt i TVSH).

X do të faturojë për D si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

D, si tatimpagues i taksës vendore mbi biznesin e vogël, nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

D do të faturojë për X vlerën e ndërhyrjes së tij në treg vlerën 30 lekë, me faturë të thjeshtë tatimore.

Njësia e shitjes me pakicë e shet një paketë cigare te konsumatori final me vlerë 200 lekë.

Rasti III: Furnizuesi kryesor (X) furnizon një furnizues të ndërmjetëm (Y), person i tatueshëm.

X do të faturojë për Y si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

Y nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

Y i faturon X të gjithë vlerën e ndërhyrjes së tij në treg dhe të hallkave të mëpasshme dhe mbi këtë vlerë llogarit edhe TVSH : $34 + 6.8 \text{ (TVSH)} = 40.8 \text{ lekë.}$

Y lëshon një faturë tatimore të TVSH për njësinë e shitjes me pakicë (D), në kolonën TVSH të cilës nuk do të ketë TVSH. Fatura tatimore e lëshuar nga Y do të ketë çmimin e shitjes me pakicë të cigareve minus vlerën e ndërhyrjes në treg që do të përfitojë njësia e shitjes me pakicë D ($200 - 30 = 170 \text{ lekë.}$)

Njësia e shitjes me pakicë D e shet një paketë cigare te konsumatori final, pa llogaritur TVSH në vlerën 200 lekë.

Rasti i IV: Furnizuesi kryesor (X) furnizon një furnizues të ndërmjetëm (Y1), i cili furnizon një furnizues tjetër të ndërmjetëm (Y2).

X do të faturojë për Y1 si më poshtë:

$$166.67 + 33.33 \text{ (TVSH)} = 200 \text{ lekë.}$$

Y1 nuk ka të drejtë të kreditojë TVSH (33.33 lekë).

Y1 i faturon X : $36 + 7.2 \text{ (TVSH)} = 43.2 \text{ lekë.}$

Y1 i faturon Y2, vlerën 166 lekë (pa llogaritur TVSH).

Y2 lëshon një faturë tatimore të TVSH për njësinë e shitjes me pakicë (D), në kolonën TVSH të cilës nuk do të ketë TVSH. Fatura tatimore e lëshuar nga Y2 do të ketë çmimin e shitjes me pakicë të cigareve minus vlerën e ndërhyrjes në treg që do të përfitojë njësia e shitjes me pakicë D ($200 - 30 = 170 \text{ lekë}$).

Njësia e shitjes me pakicë shet një paketë cigare te konsumatori final, pa llogaritur TVSH me vlerë 200 lekë.

(Ndryshuar me Udhezim, Nr.17/1, datë 5.8.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 130 datë 08.08.2008).

9.5.2 Faturimi e pagimi i fraksionuar i komisionit.

Sipas kësaj mënyre secila hallkë e tregut të cigareve, i faturon asaj paraardhëse një vlerë të barabartë me shërbimin e kryer nga ndërhyrja në treg.

Shembull:

Furnizuesi kryesor i cigareve "personi i tatueshëm X" është importues dhe, në muajin korrik 2008, importon një sasi prej 3 tonë cigare të markës "Z".

Mbi vlerën e tatueshme të krejt sasisë së cigareve të importuara, llogaritet dhe paguhet TVSH në doganë, e cila është e zbritshme nga X, brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së.

Rasti I: Importuesi X furnizon distributorin Y, ndërmjetës, i cili më pas furnizon shitësin e pakicës P, regjistruar si tatimpagues i taksës vendore për biznesin e vogël.

Veprimi i parë

Importuesi X, furnizon distributorin Y person i tatueshëm, në sasinë prej 20 000 paketa të markës "Z".

Çmimi i shitjes me pakicë i paketave të markës "Z" është 200 lekë (përfshirë TVSH). Sqarojmë se ky çmim do të zbatohet në të gjitha hallkat e furnizimit.

Furnizimi i cigareve dokumentohet nga importuesi X, me lëshimin prej tij në adresë të distributorit Y, faturë tatimore me TVSH dhe me të dhënat:

Nr. Emërtimi Njësia Sasia Çmimi/njësi pa TVSH Vlera e tatueshme TVSH Vlera me TVSH

1 Paketa "Z" copë 20 000 166,7 3 334 000 666 000 4 000 000

Distributori Y nuk ka të drejtë të kreditojë shumën e TVSH-së prej 666 000 lekë, të paraqitur në faturën e lëshuar nga furnizuesi kryesor X.

Të dhënat e kësaj fature, hidhen nga X në librin e shitjeve dhe Y në librin e blerjeve, në kolonën e blerjeve me TVSH jo të zbritshme.

Veprimi i dytë

Distributori Y furnizon tatimpaguesin P, shitës me pakicë, i regjistruar si tatimpagues i taksës vendore për biznesin e vogël.

Ai përpilon për këtë të fundit një faturë tatimore, ku çmimi i shitjes është ai i shitjes me pakicë (200 lekë), por pa zbatuar TVSH në të.

Shitja e cigareve nga distributori Y konsiderohet si shërbim i kryer për llogari të furnizuesit kryesor X dhe ai përfiton nga ky një komision në masën 17 %, i barabartë me vlerën e shërbimit nga Y deri te konsumatorët finalë.

Në vlerën e komisionit, përfshihet TVSH me shkallë tatimore 20%, e cila faturohet nga Y për llogari të furnizuesit kryesor X.

Në rast se gjatë një muaji distributori Y ka shitur 10 000 paketa të markës "Z", atëherë komisioni për shërbimin e kryer faturohet sipas tabelës më poshtë:

Nr. Emërtimi Vlera e furnizuar % komisionit Vlera e komisionit pa TVSH TVSH mbi komisionin 20% Vlera me TVSH

1. Shërbim komision 2 000 000 17 283 333 56 667 340 000

Shuma e TVSH-së prej 56 667 lekë, hidhet në kolonën e TVSH-së në shitje të librit të shitjeve nga Y dhe ndërkohë, është e zbritshme brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së, për furnizuesin X.

Veprimi i tretë

Shitësi me pakicë P ka shitur të gjithë sasinë mujore prej 10 000 paketa, që i ishin furnizuar nga distributorit Y. Ai përfiton nga Y, një vlerë të caktuar, pra një komision prej 10 % mbi çmimin e shitjes me pakicë, për furnizimet e kryera te konsumatorët finalë.

Për komisionin e përfituar, P do të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore, të cilën ia adreson

distributorit Y. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve të tij(e konsideruar si e ardhur për të) dhe në atë të blerjeve të distri butorit Y (e konsideruar si shpenzim për të).

Nr. Emërtimi Vlera e furnizuar % komisionit Vlera e komisionit

1. Shërbim komision 2 000 000 10 200 000

Rasti II: Importuesi X furnizon personin e tatueshëm Y, shitës me pakicë, i cili furnizon vetëm konsumatorët finalë.

Veprimi i parë

Importuesi X, po në këtë muaj, furnizon personin e tatueshëm Y, shitës me pakicë, në sasinë prej 20 000 paketa të markës "Z".

Furnizimi i cigareve dokumentohet nga importuesi X me lëshimin prej tij, në drejtim të personit të tatueshëm Y, faturë tatimore me të dhënat:

Nr. Emërtimi Njësia Sasia Çmimi/njësi pa TVSH Vlera e tatueshme TVSH Vlera me TVSH
1 Paketa "Z" copë 20 000 166,7 3 334 000 666 000 4 000 000

Shitësi me pakicë Y nuk ka të drejtë të kreditojë shumën e TVSH-së prej 666 000 lekë, të paraqitur në faturën e lëshuar nga furnizuesi kryesor, X.

Të dhënat e kësaj fature hidhen nga X në librin e shitjeve dhe Y në librin e blerjeve, në kolonën e blerjeve me TVSH jo të zbritshme.

Veprimi i dytë

Shitësi me pakicë Y furnizon klientët e tij, konsumatorë finalë, ku çmimi për paketë është 200 lekë.

Shitja e cigareve nga shitësi me pakicë Y konsiderohet si shërbim i kryer për llogari të furnizuesit kryesor X dhe ai përfiton nga ky një komision, në masën 17 % të totalit të ardhurave përfituar deri te konsumatorët finalë.

Në vlerën e komisionit, përfshihet TVSH me shkallë tatimore 20%, e cila faturohet nga shitësi me pakicë Y, për llogari të furnizuesit kryesor X.

Në rast se gjatë muajit shitësi me pakicë Y, ka shitur një sasi prej 10 000 paketa të markës "Z", atëherë komisioni për shërbimin e kryer është sipas tabelës më poshtë:

Nr. Emërtimi Vlera e furnizuar % komisionit Vlera e komisionit pa TVSH TVSH mbi komisionin

1. 20% Vlera me TVSH

Shërbim komision 2 000 000 17 283 333 56 667 340 000

Shuma e TVSH-së prej 56 667 lekë, hidhet në kolonën e TVSH-së në shitje në librin e shitjeve nga Y dhe ndërkohë, është e zbritshme brenda përcaktimeve të nenit 33 të ligjit të TVSH-së, për furnizuesin X.

Rasti III: Importuesi X furnizon shitësin e pakicës P, i regjistruar si tatimpagues i taksës

vendore për biznesin e vogël.

Veprimi i parë

Importuesi X furnizon shitësin me pakicë P, tatimpagues i taksës vendore, në sasinë prej 20 000 paketa të markës "Z".

Çmimi i shitjes me pakicë i paketave të markës "Z" është 200 lekë (përfshirë TVSH).

Furnizimi i cigareve dokumentohet nga importuesi X, me lëshimin prej tij në drejtim të shitësit me pakicë P, faturë tatimore me të dhënat :

Nr. Emërtimi Njësia Sasia Çmimi/njësi pa TVSH Vlera e tatueshme TVSH Vlera me TVSH
1 Paketa "Z" copë 20 000 166,7 3 334 000 666 000 4 000 000

Të dhënat e kësaj fature hidhen në librin e shitjeve të X dhe, në librin e blerjeve të shitësit me pakicë P.

Veprimi i dytë

Shitësi me pakicë P ka shitur gjatë muajit sasinë prej 10 000 paketa, që i ishin furnizuar nga importuesi X. Ai përfiton nga X, një vlerë të caktuar (komision) prej 17 % mbi çmimin e shitjes me pakicë, për furnizimet e kryera te konsumatorët finalë.

Për komisionin e përfituar, P do të lëshojë faturë të thjeshtë tatimore të cilën ia adreson importuesit X. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve të tij (e konsideruar si e ardhur për të) dhe në atë të blerjeve të importuesit X (e konsideruar si shpenzim për të).

Nr. Emërtimi Vlera e furnizuar % komisionit Vlera e komisionit

1. Shërbim komision 2 000 000 17 340 000

(Ndryshuar me Udhezim, Nr.17/1, datë 5.8.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 130 datë 08.08.2008).

9.5.3. Rregulla të përgjithshme

a) Furnizuesit kryesorë, në varësi të marrëdhënieve që vendosin me furnizuesit e ndërmjetëm të tyre, zgjedhin njërën nga dy mënyrat e mësipërme të faturimit, të përcaktuara në pikat 9.5.1 ose 9.5.2 më lart, por jo të dy mënyrat njëkohësisht.

b) Çmimi maksimal i shitjes me pakicë të cigareve, për çdo lloj cigareje dhe çdo lloj pakete, përcaktohet nga furnizuesit kryesorë.

c) Furnizuesit kryesorë janë të detyruar të deklarojnë çmimin maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj pakete dhe çdo lloj cigareje. Deklarata e ndryshimit të çmimit të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete, duhet të dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore ku është i regjistruar furnizuesi kryesor, jo më vonë se 10 ditë para datës së aplikimit të çmimit të ri maksimal të shitjes me pakicë.

ç) Furnizuesit kryesorë janë të detyruar të publikojnë deklaratën e ndryshimit të çmimit maksimal të shitjes me pakicë për çdo lloj cigareje dhe pakete në jo më pak se dy gazeta ditore nacionale dhe jo më vonë se 5 ditë nga data e aplikimit të çmimit të ri. Për efekte marketingu çmimet maksimale mund të vazhdojnë të publikohen në çdo media të shkruar apo elektronike për

aq kohë sa ato çmime janë në fuqi.

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit çmimet e reja maksimale të shitjes me pakicë të cigareve jo më vonë se dy ditë para datës së zbatimit të çmimeve të reja. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të publikojë çmimet maksimale të shitjes me pakicë të cigareve në çdo formë tjetër publikimi.

dh) Ndalohet shitja e cigareve me çmim më të lartë se çmimi maksimal i shitjes me pakicë, i deklaruar sipas pikave a-d më lart. Drejtoritë Rajonale Tatimore kontrollojnë zbatimin e çmimeve maksimale të shitjes me pakicë të cigareve. Shitja e një pakete cigare me çmim më të lartë se çmimi i deklaruar, konsiderohet shkelje.

e) Tatimpaguesit që kanë gjendje malli në magazinë deri në hyrjen në fuqi të skemës, e faturojnë atë për furnizuesin e tyre, me çmimin e blerjes. Furnizuesi kryesor e rifaturon këtë sasi ndaj furnizuesve të tjerë, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë udhëzim. Njësitë e shitjes me pakicë, jo subjekte të TVSH-së, nuk kanë detyrim të faturojnë për furnizuesit e tyre. Gjithë ky proces vazhdon deri sa faturimi përfundon tek furnizuesi kryesor. (Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010)..

f). Furnizuesit e ndërmjetëm dhe të gjithë furnizuesit e mëpasshëm të cigareve, përfshirë njësitë e shitjes me pakicë, janë të detyruar të dokumentojnë të gjitha shitjet e cigareve të kryera me fatura tatimore apo kupon tatimor fiskal në varësi të skemës së aplikuar. Këta furnizues janë të detyruar t'i regjistrojnë, evidentojnë në librin e shitjes dhe në librin e blerjes transaksionet e shitblerjes së cigareve, në përputhje me kërkesat ligjore të këtij udhëzimi dhe procedurat tatimore në fuqi.

Si furnizime jashtë objektit të TVSH-së, evidentimi dhe regjistrimi i këtyre faturave në librin e blerjeve dhe të shitjeve do të bëhet në rubrikat “Shitje e përjashtuar” dhe “Blerje pa TVSH” dhe do të deklarohet në rubrikat respektive të formularit të deklarimit dhe pagesës së TVSH-së, pa ndikuar në TVSH-në e pagueshme dhe në kreditimin e tatimit.

9.6 Trajtimi i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike

Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike, “humbje gjatë transportit të energjisë elektrike” do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje, që miraton Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Për efekte fiskale, niveli i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike është vjetor dhe nivelivmaksimal i humbjeve është përqindja e miratuar çdo vit nga ERE.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve tejkalon përqindjen e miratuar nga ERE, për efekte fiskale konsiderohet përqindja e miratuar nga ERE.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve është më e ulët se përqindja e miratuar nga ERE, për efekte fiskale konsiderohet përqindja faktike e humbjeve.

Brenda tre muajve të vitit pasardhës, tatimpaguesi që operon në sektorin e shpërndarjes së energjisë në bashkëpunim me administratën tatimore kryejnë rakordimet përkatëse.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

10.EKSPORTET

Në bazë të pikës "a" të nenit 31 të Ligjit, mallrat që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të tatueshme. Shkalla tatimore e aplikueshme është zero përqind. Si provë për të vërtetuar eksportet, do të shërbejë fatura dhe DAV (Dokumenti i Vetëm Administrativ) dhe deklarata doganore e eksportit. Forma dhe përmbajtja e deklarates doganore të eksportit është sipas formatit tip të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Vlera e eksportit është e barabartë me vlerën e paraqitur në faturën tatimore të lëshuar nga personi i tatueshëm.

Moment i furnizimit, pra i regjistrimit të eksportit në librin e shitjeve të personit të tatueshëm eksportues (kur eksporti quhet i kryer) është "Data e Çlirimit", datë kur mallrat çlirohen nga dogana. Ajo paraqitet në "Urdhërin e Lëshimit", dokument i lëshuar nga organi doganor dhe i bashkëngjitet si provë deklarates doganore të eksportit.

10.1 Trajtimi i rasteve kur produktet e eksportuara nga eksportues shqiptar, refuzohen dhe kthehen nga blerësi i huaj, përveç rasteve që i nënshtrohen regjimit të përpunimit aktiv.

10.1.1. Mallra që i kthehen subjekteve shqiptare shitëse (eksportuese) nga blerës të huaj
Në këtë rast, për vlerën që i korrespondon sasisë së mallit të kthyer, shitësi (eksportuesi) përpilon një notë krediti me vlerën përkatëse të mallit që kthehet, që i drejtohet blerësit të huaj dhe ku referohet saktësisht fatura me të cilën është bërë shitja e mallit që kthehet dhe deklarata doganore përkatëse e importit. Shitësi (eksportuesi shqiptar) është i detyruar t'i kthejë blerësit pagesën, në përputhje me dispozitat kontraktuale, kundrejt vlerës së përcaktuar në notën e kreditit, transaksion i cili duhet të kryhet nëpërmjet bankës. Malli i refuzuar nga blerësi kthehet në Shqipëri, sipas procedurave të parashikuara në Kodin Doganor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, i shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës të lëshuar nga blerësi që refuzon dhe kthen mallin. Në këtë rast shitësi (eksportuesi) përgatit një faturë tatimore saktësuese ose anuluese (me minus) të cilën e regjistron në librin e shitjeve të TVSH-së për periudhën tatimore (muajin) në të cilin është lëshuar kjo faturë saktësimi, duke reduktuar shitjet dhe TVSH-në e atij muaji. Faturës saktësuese ose anuluese i bashkëngjitet nota e kreditit.

Shitësi (eksportuesi shqiptar), mund të gjejë një blerës tjetër, po jashtë vendit, duke mundur që malli të shkojë direkt nga blerësi i parë tek i dyti, pa qenë i nevojshëm kthimi i mallit në vendin e origjinës (Shqipëri). Procedura e notës së kreditit e lëshuar nga shitësi për blerësin e parë dhe e faturës tatimore të saktësimit (me minus) e lëshuar nga shitësi për blerësin e parë dhe regjistrimi në librin e shitjeve të TVSH-së të shitësit (eksportuesit) është e njëjtë si në paragrafin paraardhës. Në të njëjtën kohë, shitësi (eksportuesi shqiptar) përpilon një faturë tatimore shitje për blerësin e dytë (me TVSH 0%), pa e shoqëruar me deklaratën e eksportit (sepse malli tashmë nuk eksportohet nga Shqipëria). Kjo faturë

regjistrohet normalisht në librin e shitjeve të TVSH-së si eksport me vlerën që malli i shitet blerësit të dytë. Transfertat përkatëse monetare, pra kthimi i shumës përkatëse ndaj blerësit të parë që refuzoi mallin dhe arkëtimi i parave nga blerësi i dytë kryhen nëpërmjet bankës.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011).

11. FATURAT

11.1 Të dhënat që duhet të përmbajë një faturë tatimore.

Faturat janë dokumenti bazë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ato përcaktojnë detyrimin tatimor të furnizuesit dhe shumën e tatimit të zbritshëm që do ti lejohet të kërkojë blerësi i regjistruar për TVSH.

Një person i tatueshëm i cili bën një furnizim (edhe nëqoftëse furnizimi është i përjashtuar apo me 0 përqind) detyrohet t'i lëshojë personit që merr furnizimin (edhe nëqoftëse ai, pra blerësi, nuk është person i tatueshëm) një faturë tatimore (neni 36 paragrafi 1).

Në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave me Radiotelevizionin Shqiptar në faturat tatimore të energjisë elektrike, duhet të regjistrohet nën një zë më vete, tarifa mujore e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive, vjelja e së cilës bëhet sipas udhëzimit të përbashkët.

(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7.2011).

Fatura, e cila prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sipas formularit tip bashkengjitur ketij udhëzimi, duhet të përmbajë :

- numrin rendor;
- numrin serial të parashtypur;
- datën e lëshimit;
- emrin, adresën, numrin e identifikimit të shitësit;
- emrin, adresën, numrin e identifikimit të blerësit;
- emrin dhe adresën e blerësit, në rastin e individëve (për shitje me pakice me vlerë mbi 10 mijë leke);
- emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit;
- përshkrimin e hollësishëm të mallrave të shitura ose të shërbimeve të kryera;
- sasinë e mallrave të shitura ose vëllimin e shërbimeve të kryera;
- çmimin për njësi pa TVSH;
- vlerën totale të transaksionit pa TVSH;
- shumën e TVSH-se (nëqoftëse zbatohet TVSH);
- vlerën totale me TVSH;
- cilësimin furnizim i përjashtuar apo me 0 përqind (nëqoftëse ai është përkatësisht i përjashtuar apo i tatueshëm me 0 përqind).

Fatura lëshohet në jo më pak se tre kopje dhe shpërndahet si më poshtë:

- faqja 1 për blerësin;
- faqja 2, 3, etj. për shitësin dhe transportuesin.

Në fund të faturës shënohet shitesi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe vulë, blerësi me emër, mbiemër, nënshkrim transportuesi me emër, mbiemër, nënshkrim (kur është dhe transportuesi).

Për shitje të bëra tek një individ konsumator jotregtar, në faturën e lëshuar nga shitësi paraqitet emri, mbiemri e adresa e blerësit.

Shitjet e një natyre të tillë i takojnë mallrave të konsumit përfundimtar dhe sasia e tyre është brenda kufijve normalë të konsumit individual ose familjar (jo për t'u rishitur ose për t'u përpunuar).

Vetëm origjinali i faturës i jep të drejtë blerësit për të kredituar (zbritur) TVSH-ne e paguar në blerje. Për qëllime të kreditimit tatimor, në rastet kur kopja e pare origjinale humbet, do të konsiderohet e vlefshme për blerësin kopja e noterizuar e faturës së blerjes, me kusht që shitësi të zotërojë origjinalin dhe ta ketë deklaruar atë. Nëqoftëse fatura nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara më lart, blerësi nuk ka të drejtë të kreditojë (zbresë) TVSH-ne e paguar në blerje, kurse shitësi nga ana e tij do të paguajë TVSH-ne e detyrueshme për t'u paguar.

Në rastet kur një tatimpagues shet një sasi të konsiderueshme artikujsh në të njëjtën kohë e për të njëjtin klient, ai mund të lëshojë faturë kompjuterike. Por në këtë rast, faturën kompjuterike me të njëjtin numër duhet t'ia bashkëngjisë faturës tatimore të shpërndare nga organet tatimore. Në këtë mënyrë, për çdo klient lëshohet detyrimisht fatura tatimore e emetuar nga organet tatimore, e cila do të plotësohet normalisht me të dhënat e shitësit dhe blerësit, ndërsa vlera e transaksionit të kryer me klientin do të paraqitet në total. Menyra e shpërndarjes dhe administrimit të faturave tatimore të TVSH-se përcaktohet në një rregullore të vecante të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ka të drejtë të lejojë mospërdorimin e faturave me numër serial të parashtypur. Për këtë, personat e tatueshëm duhet të paraqesin një kerkese tek Dega e Tatimeve ku është regjistruar, duke treguar se sistemi i tyre i regjistrimeve është i kompjuterizuar, i aftë të prodhojë besueshmërisht fatura tatimore me nr. serial për çdo transaksion të tatueshëm dhe që kanë një numër të konsiderueshëm klientësh konsumatorë final. Në këtë rast tatimpaguesi paraqet edhe modelin e fatures që do të perdore. Dega e tatimeve, pas verifikimit nëse fatura kompjuterike që tatimpaguesi do të lëshojë përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për çdo artikull, këtë kerkese se bashku me një opinion të shkurtër të saj, e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo e fundit brenda 30 ditësh nga data e mbërritjes së kerkeses jep ose jo miratimin për përdorimin e kësaj fature duke njoftuar me shkrim personin e tatueshëm dhe degën e tatimeve.

Në rastin e miratimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degës së Tatimeve në të cilën personi është regjistruar, i dorëzon atij zyrtarisht diapazonin e numrave seriale për faturat tatimore që do të lëshojë ky person.

Në bazë të pikës 2 të nenit 28 të Ligjit, personi që kryen furnizime të tatueshme, detyrohet të njoftojë në mënyrë të dukshme nëpërmjet shpalljes, kontratës apo reklamës nëse çmimi i mallrave apo i shërbimeve të furnizuara ose çmimi që duhet të paguhet për furnizimin përfshin ose jo TVSH. Në rast se furnizimi i tatueshëm kryhet pa një shumë të ndarë e të identifikuar si pagesë e

TVSH, vlera e tatueshme e tij është shuma që së bashku me TVSH e pagueshme mbi këtë vlerë është e barabartë me pagesën totale që bëhet për furnizimin.

11.2 Saktësimet

Nëqoftëse bëhet saktësim për një pagesë të bërë për një furnizim pasi është lëshuar fatura, shitësi duhet të lëshojë një faturë shtesë.

Një saktësim kryhet kur:

- furnizimi nuk është i njëjtë me atë që ka kërkuar blerësi;
- mallrat janë dëmtuar apo shërbimi nuk është kryer mirë;
- çmimet ndryshojnë për çfarëdo arsye (zbritje për pagesë të menjëhershme etj.);
- rezulton një diferencë nga konvertimi i monedhës së huaj me monedhën kombëtare (lekë).
(Ndryshuar me Udhëzim, Nr.17/1, dt. 5.8.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 130 dt. 08.08.2008).

Nëqoftëse çmimi rritet apo ulet shitësi duhet të lëshojë një faturë shtesë. Fatura shtesë lëshohet në të njëjtën formë si fatura dhe duhet të tregojë:

- shumë qartë, në një vend të dukshëm fjalët "faturë shtesë";
- numrin rendor dhe numrin serial të faturës së parë të cilën saktëson;
- shumën në para të rritjes apo uljes të çmimit;
- arsyen e saktësimit sipas rasteve të përcaktuara më sipër.

12. BORXHI I KEQ

Kur furnizuesi nuk ka marrë një pagesë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të kryer, kemi të bëjmë me një borxh të keq. Në këto raste e drejta për të lëshuar një faturë të borxhit të keq, lind :

- Pasi borxhi bëhet një borxh i keq. Kjo fillon 6 muaj pas periudhës tatimore në të cilën TVSH është zbatuar.

- Pasi shitësi të ketë paraqitur të gjitha provat që kërkon organi tatimor për të vërtetuar se ai ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të arkëtuar borxhin e keq.

Prova kryesore që detyrohet të paraqesë shitësi, është Vendimi i Gjykatës në të cilin vërtetohet se blerësi i tij është debitor dhe ka falimentuar, prandaj për këto arsye nuk mund t'i paguajë shitësit vlerën e furnizimit të marrë. Pa këtë vendim, organet tatimore nuk mundën në asnjë rast të pranojnë borxhin e keq si të tillë.

Në rastin e një borxhi të keq, shitësi duhet të lëshojë një faturë të borxhit të keq. Kjo faturë lëshohet në të njëjtën formë si një faturë normale. Ajo duhet të tregojë fjalët "borxh i keq", numrin rendor të faturës të parë me të cilën lidhet ky borxh dhe të tregojë që kreditimi i tatimit të

blerësit duhet të zvogëlohet. Kjo faturë përdoret nga shitësi për të zvogëluar detyrimin për TVSH, ndërsa nga blerësi për të zvogëluar kreditimin e TVSH.

Kur vetëm një pjesë e vlerës së transaksionit nuk është arkëtuar, atëherë fatura duhet të tregojë shumën e pa arkëtuar të transaksionit dhe TVSH që i përket kësaj shume.

Për shembull:

Në faturën e parë:

Shuma për t'u arkëtuar, përfshirë TVSH është	90 lek:
- TVSH për t'u arkëtuar	10 lek
- Shuma e arkëtuar	54 lek
- TVSH e arkëtuar	6 lek

Në faturën e borxhit të keq:

Shuma e paarkëtuar	36 lek
- TVSH për t'u kredituar (saktësuar) 10-6	4 lek

Saktësimet mbi bazën e faturës të borxhit të keq regjistrohen nga shitësi në librin e shitjeve si pakësim detyrimi për TVSH ndërsa nga blerësi në librin e blerjeve si pakësim kreditimi për TVSH. Kur kreditimi për një borxh të keq lejohet dhe i gjithë ose një pjesë e këtij borxhi paguhet më vonë, shitësi duhet të lëshojë një faturë të re. Për lëshimin e kësaj fature zbatohen të njejtat rregulla dhe fatura e re duhet të tregojë fjalët "borxh i keq i paguar" dhe numrin e "faturës të borxhit të keq" me të cilën ka lidhje.

13. MBAJTJA E REGJISTRIMEVE

13.1 Libri i blerjeve

Libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij Udhëzimi. Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë. Në të regjistrohen për çdo transaksion furnizuesi dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin.

Në këtë libër regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial i shtypur nga shtypshkronja ose nga tatimpaguesi kur i lejohet, të dhënat e deklarates së importit, emri i shitësit dhe numri i identifikimit tatimor të tij.

Blerjet regjistrohen në vlerë totale e cila përfshin edhe TVSH (nëqoftëse ka) si dhe të ndara në blerje me TVSH dhe në blerje pa TVSH. Blerjet me TVSH regjistrohen të ndara në importe dhe blerje brenda vendit.

Për çdo blerje me TVSH personi regjistron vlerën e tatueshme dhe TVSH që i korespondon kësaj blerje.

Për çdo blerje nga fermeret sipas skemes së paraqitur në nenet 58.1, 58.2, 58.3, 58.4 të Ligjit, personi regjistron vlerën e mallit të blerë tek fermerët. Në një kolonë të vecantë, regjistrohet kompensimi i paguar fermerit, si produkt i vlerës së mallit të blerë me përqindjen e kompensimit. Në fund të librit të blerjeve janë fletët e inventarit të cilat përdoren për të pasqyruar inventarin e mallrave në fund të vitit.

13.2 Libri i shitjeve

Libri i shitjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhezimi. Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit të tatueshëm. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë. Në të regjistrohen për çdo transaksion klienti dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin. Në librin e shitjeve regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial i shtypur nga shtypshkronja ose nga tatimpaguesi kur i lejohet dhe data e numri i deklarates doganore kur mallrat eksportohen, emri i klientit dhe numri i identifikimit të tij (nëqoftëse ka). Në të regjistrohet vlera totale e transaksionit përfshirë TVSH (nëqoftëse ka). Shitjet regjistrohen të ndara në të përjashtuara, me zero përqind dhe të tatueshme. Për çdo shitje të tatueshme regjistrohen vlera e tatueshme dhe TVSH.

13.3 Libri i çmimeve të shitjes

Libri i çmimeve të shitjes është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe përmbajtja e tij është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhezimi. Të gjitha faqet e librit duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo muaj. Në këtë libër regjistrohen çmimet e shitjes me shumicë dhe me pakicë, përfshirë TVSH-në, të aplikuara nga personi i tatueshëm për periudhën e muajit raportues.

Çmimet e deklaruara të shumicës, janë ato që janë të aplikuara nga personi për furnizime të realizuara në drejtim të personave të tjerë të regjistruar në TVSH ose në biznesin e vogël. Çmimet e deklaruara me pakicë, janë ato që janë aplikuar për konsumatorë finalë, në shitjet e kryera në vendet e veçanta të deklaruara nga personi i tatueshëm për shitjet me pakicë. Personat e tatueshëm të cilët kanë në nomenklaturën e mallrave të furnizuara deri në 20 artikuj, janë të detyruar të deklarojnë çmimet me shumicë dhe pakicë për të gjithë artikujt e nomenklaturës.

Personat e tatueshëm, të cilët kanë më tepër se 20 artikuj të destinuara për shitje janë të detyruar të deklarojnë në librin e çmimeve të shitjes, 20 artikujt të cilët përbëjnë volumn më të madh të shitjeve të tyre.

Personat e tatueshëm të cilët furnizojnë shërbime, gjithashtu janë të detyruar të deklarojnë në këtë libër çmimet e aplikuara për shërbimet e furnizuara gjatë muajit.

Shembull:

personi i tatueshëm x, furnizon shërbime të suvatimit në procesin e ndërtimit. Ky person detyrohet të deklarojë çmimin për njësi (m²) të këtij shërbimi.

13.4 Regjistrimet elektronike

Regjistrimet (librat e shitjes dhe të blerjes) mund të mbahen edhe në kompjuter. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të lejojë hyrjen e organeve tatimore në çdo kompjuter ku janë mbajtur regjistrimet, për të kryer inspektime të ndryshme mbi regjistrimet e mbajtura.

13.5 Subjektet e regjistruara pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj duhet të dorëzojnë elektronikisht një kopje të regjistrimeve mujore në librin e blerjeve dhe të shitjeve të
Adresa: Rruga Gjën Bue Shpata www.tatime.gov.al

muajit janar 2010 brenda datës 14 shkurt 2010. Për periudhat e tjera, dorëzimi në mënyrë elektronike i librit të blerjes dhe shitjes do të bëhet brenda datës 5 të çdo muaji. Këto dokumente tatimore do të ngarkohen dhe dërgohen elektronikisht në adresë të organeve tatimore.

Për subjektet e regjistruara për TVSH-në, si dhe subjektet e regjistruara pranë Drejtorisë Rajonale të Rretheve, një kopje e regjistrimeve mujore të tatimpaguesit në librin e blerjeve dhe të shitjeve, do të ngarkohen dhe dërgohen elektronikisht brenda datës 5 të çdo muaji në adresë të organeve tatimore, duke filluar nga afatet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave.

Formati elektronik i librave të blerjes dhe shitjes, dhe formulari i deklarimit dhe pagesës së TVSH-së është sipas tabelave bashkëlidhur këtij udhëzimi.
(Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010)..

14. DEKLARIMI

14.1 Deklarata dhe pagesa e TVSH-se.

Formulari i deklarimit dhe pageses se TVSH plotësohet në dy kopje dhe paraqitet nga personi i tatueshëm në degën përkatëse të bankes, me të cilat DPT ka lidhur marrëveshje për pranimin e pagesave të TVSH, brenda 14 ditëve pas përfundimit të periudhes tatimore.

Punonjësi i bankës bën shënime në pjesën e tretë të dokumentit "pagesa" pastaj i kthen personit të tatueshëm kopjen e dytë. Në fund të cdo dite origjinalët e deklaratës dhe pagesës të TVSH mbledhen nga banka dhe ju dorëzohen organeve tatimore perkatese për përpunim sic parashikohet ne marrëveshjet e lidhura midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe bankave përkatëse.

Personi i tatueshëm paraqet deklaratën e TVSH në bankë edhe nëqoftëse ai nuk ka për të paguar detyrim tatimor. Plotësimi i saktë i deklaratës, paraqitja dhe pagesa brenda afateve kohore të përcaktuara është detyrim ligjor për të gjithë personat e tatueshëm. Moszbatimi i këtij detyrimi ngarkon me përgjegjësi ligjore personin e tatueshëm dhe dënohet në bazë të ligjit për TVSH dhe të udhëzimit në zbatim të tij.

Deklarata përbëhet nga tre pjesë.

- a) Pjesa e parë kërkon të dhëna për identifikimin e personit të tatueshëm.
- b) Pjesa e dytë kërkon të dhëna për llogaritjen e detyrimit tatimor.
- c) Pjesa e tretë është pagesa e TVSH e cila plotësohet nga banka.
Formulari i deklarimit dhe pageses eshte sipas modelit bashkengjitur ketij udhezimi.

14.2. Deklarimi dhe pagesa në menyrë elektronike e TVSH-së.

Një person i tatueshëm mund të marrë nëpërmjet teknologjisë elektronike në faqen zyrtare të internetit (aktualisht www.tatime.gov.al) , formularin e deklarimit dhe pagesës (FDP). Për ta marrë deklaratën nga website, prej personit te tatueshem bëhet me parë regjistrimi elektronik që i jep atij

mundësi hyrje në këtë shërbim të faqes së internetit. Pasi bëhet i mundur ky shërbim, nëse personi i tatueshëm zotëron një program informatik që mundeson hyrjen në bazën e të dhënave të bankës, ku do të deklarohet dhe paguhet në mënyrë elektronike, përveç deklarimit ai mund të bëjë edhe pagesën në mënyrë elektronike.

15. SHITJA ME PAKICË

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 dt. 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 dt. 15.01.2009).

Konsiderohen shitje me pakicë të gjitha ato furnizime që bëhen:

- (i) për konsum përfundimtar;
- (ii) në ato sasi që nuk tejkalojnë nevojat private normale të konsumatorit; dhe
- (iii) që nuk rishiten.

Te gjithë tatimpaguesit, të cilët në aktivitetin e tyre kryejnë njëkohësisht tregti me shumicë për tatimpagues të tjerë dhe tregti me pakicë për publikun e gjere, janë të detyruar të bëjnë një gjë të tillë në vende të vecanta, të ndara nga njeri tjetri. Në një mjedis të deklaruar si vend për shitje me shumicë për tatimpagues të tjerë nuk mund të bëhen shitje me pakicë për publikun dhe e kundërta, në një mjedis të deklaruar si vend për shitje me pakicë për publikun nuk mund të bëhen shitje me shumicë për tatimpagues të tjerë. Kur pretendohet se në ambientet e shitjes me pakicë janë kryer edhe shitje me shumicë, këto të fundit vlerësohen sikur të jenë shitur me cmimet e shitjes me pakicë. Çdo vend veprimtarie të shitjes me shumicë dhe të shitjes me pakicë duhet të pajiset me Çertifikatë Regjistrimi me numra të ndryshëm seriale.

Shitësit me pakicë detyrohen të lëshojnë fatura tatimore në rastet kur shitja, përfshirë TVSH, është më e madhe se **20.000 lekë** apo kur blerësi është person i regjistruar si tatimpagues. Faturat regjistrohen kronologjikisht një për një në librin e shitjeve.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 dt. 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 dt. 15.01.2009).

Hipermarketet detyrohen të lëshojnë fatura tatimore në rastet kur vlera e tatueshme në shitje, përfshirë TVSH, është më e madhe se 40.000 lekë.

Në çdo rast tjetër shitësit me pakicë lëshojnë kupona tatimore të arkave regjistruese ose dëftesa tatimore, kur nuk kanë arka regjistruese, siç përcaktohet në Ligjin Nr.7758 datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet". Kuponi tatimor dhe dëftesa tatimore nuk është e detyrueshme të përmbajë përveç shumës totale të tij edhe TVSH-në e llogaritur. Për të gjetur shumën e TVSH-së të përfshirë në vlerën totale të kuponit apo dëftesës tatimore, kjo vlerë shumëzohet me 16,666 përqind ose pjestohet me 6. Në këto raste, regjistrimi në librin e shitjeve nga shitësit me pakicë do të bëhet në mënyrën e mëposhtme:

Totali i të ardhurave ditore duhet të regjistrohet çdo ditë. Në kollonën TVSH të librit të shitjeve do të shënohet shuma e TVSH së mbledhur e cila është rezultat i produktit të totalit të shitjeve me TVSH shumëzuar me 16.666 përqind ose i pjestimit të totalit të shitjeve me TVSH me 6. Të ardhurat ditore duhet të mbështeten nga dokumenta justifikuese që dëshmojnë për saktësinë e tyre, të tilla si kuponat e arkave regjistruese dhe dokumenta të tjera në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

16. LIDHJET MIDIS ADMINISTRATËS TATIMORE DHE ASAJ DOGANORE

Organet tatimore dhe ato doganore janë të detyruara të shkëmbejnë informacion për transaksionet që lidhen me importin apo eksportin e mallrave të kryer nga personat e tatueshëm mbi bazën e specifikimeve të përcaktuara në Akt-Marrveshjet e nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave për zbatimin e këtij ligji. DPD i dergon DPT periodikisht, sipas afateve të përcaktuara në Akt-Marrëveshje, të dhënat për importet dhe eksportet. DPT i dergon DPD, brenda dates 10 te muajit pasardhes, listen e NIPT-ve te azhurnuar.

17. AMBALAZHET

Ambalazhet mund te jene qarkulluese dhe te pakthyeshme. Ne funksion te ketij dallimi ndryshon edhe menyra e aplikimit te TVSH.

17.1 Ambalazhet qarkulluese

Ambalazhet qarkulluese jane ambalazhe te tipit konteniere, qelqe, arka, bombola apo depozita gazi te lengshem dhe te tjera te kesaj natyre. Ambalazhet qarkulluese si rregull furnizohen se bashku dhe ne te njejten kohe me mallrat qe ato permbajne. Keto lloj ambalazhesh jepen nga shitesi (furnitori), se bashku me mallin ne to ne drejtim te bleresit (klientit); ato ruhen provizorisht nga bleresi dhe me pas kthehen nga ky i fundit perseri ne drejtim te shitesit. Blerja e ambalazheve nga shitesi i jep atij te drejten e kreditimit te TVSH-se sipas rregullave te parashikuara ne nenin 33 te ligjit per TVSH. Vlera e ambalazheve qe i jepen bleresit nga shitesi nuk perfshihen ne vleren e tatueshme te mallrave qe ato shoqerojne gjate furnizimit. Ambalazhet qe i jane dhene bleresit, duhet te kthehen tek shitesi brenda nje afati normal sipas fushes se aktivitetit te cilit ato i takojne. Ky afat varion edhe sipas natyres se produktit qe ambalazhet permbajne dhe duhet te paraqitet ne kontraten e lidhur mes paleve.

Per mosllogaritjen e TVSH mbi vleren e ambalazheve qarkulluese duhen plotesuar dy kushtet e meposhteme:

- Vlera e tyre te mos jete perfshire ne vleren e fatures nga shitesi.
- Te ekzistoje nje kontrate e lidhur midis paleve per dhenien dhe kthimin e ambalazheve. Ne kontrate paraqitet edhe afati i kthimit te ambalazheve nga bleresi tek shitesi. Ambalazhet qe bleresi nuk i kthen tek shitesi konsiderohen sikur te ishin shitur dhe i nenshtrohen TVSH-se mbi vleren e tyre.

17.2 Ambalazhet e pakthyeshme

Jane ambalazhe te natyres si kartona, shishe plastike, qese plastike, etj. Vlera e ketyre ambalazheve eshte element i vleres se tatueshme te mallrave qe ato permbajne. Blerja e ambalazheve nga shitesi, i jep atij te drejten e kreditimit te TVSH-se sipas rregullave te parashikuara ne nenin 33 te ligjit per TVSH. Mbi vleren e tatueshme te mallrave qe perfshin edhe vleren e ambalazheve, zbatohet TVSH ne shitje.

18. KREDITIMI I TATIMIT

18.1 Permbajtja

TVSH e kreditueshme (i zbritshëm) është shuma e TVSH-se që personi i tatueshëm paguan në momentin që ai blen mallra apo shërbime brenda vendit, si dhe shuma e TVSH-se që ai ka paguar për importet e bëra, me kushtin që, këto furnizime t'i shërbejnë vetëm furnizimeve të tatueshme që do të bëjë ky person i tatueshëm.

Nëse furnizimet e marra ose importet e bëra i shërbejnë furnizimeve të përjashtuara që mund të bëjë personi i tatueshëm, nuk lejohet kreditimi i TVSH së paguar në lidhje me furnizimet e marra për këto qëllime. Kur furnizimet që merr një person i tatueshëm, qoftë duke blerë brenda vendit qoftë duke importuar, nuk janë të destinuara për ushtrimin e një veprimtarie ekonomike, sipas nenit 17 "Veprimtaria ekonomike", ai nuk ka të drejtë të kreditojë (zbresë) TVSH e paguar për këto blerje ose importe.

Nëse personi i tatueshëm i përdor furnizimet e marra ose importet e bëra edhe për qëllime të furnizimeve të tatueshme edhe për qëllime të furnizimeve të përjashtuara njëkohësisht, kreditimi i tatimit të paguar bëhet përpjestimisht sipas pikës 19 të këtij udhëzimi.

18.2 Forma

Kreditimi i TVSH-së paguar në blerje do të kërkohet mbi bazën e faturës tatimore origjinale të lëshuar sipas nenit 36 të ligjit mbi TVSH-ne. Për qëllime të kreditimit tatimor, konsiderohet e vlefshme edhe kopja e noterizuar e faturës së blerjes (në rast se fatura origjinale humbet), me kusht që shitësi të zotërojë origjinalin dhe ta ketë deklaruar atë. Pa këtë faturë nuk mund të zbritet TVSH e paguar në blerje.

Për të kredituar TVSH e paguar në import tatimpaguesit duhet të zotërojnë deklaratën doganore origjinale të importit.

18.3 Momenti i kreditimit

Kreditimi i tatimit për një periudhë tatimore është totali i TVSH i zbatuar në lidhje me:

- Të gjitha furnizimet e tatueshme të bëra për personin e tatueshëm gjatë kësaj periudhë tatimore nga persona të tjerë të tatueshëm.

- Të gjitha importet e mallrave të bëra nga personi i tatueshëm gjatë kësaj periudhe tatimore.

Periudha tatimore, sipas nenit 38 të ligjit, është muaji kalendarik. TVSH e hyrjeve nuk mund të zbritet përpara periudhës të cilës i përket. TVSH e hyrjeve mund të paraqitet si e kreditueshme vetëm brenda 12 periudhave tatimore. Pas kësaj periudhe tatimpaguesi nuk ka të drejtë të kreditojë më TVSH e faturuar (fatura regjistrohet si blerje me TVSH jo të zbritëshme). TVSH e hyrjeve regjistrohet në periudhën tatimore në të cilën po kërkohet kreditimi.

18.4 Kreditimi në rastet e eksporteve

Në rastet kur eksportuesit zotërojnë Deklaratën Doganore të Eksportit (DAV- Dokumenti Administrativ i Vetëm), origjinale ose në mungesë të saj fotokopje të legalizuara nga organet doganore, bazuar në ligjin mbi TVSH-ne, neni 33, kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e paguar në blerjet që i shërbejnë eksporteve. Në këto raste, organet tatimore njohin si të zbritshme TVSH-Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata

ne e paguar në blerjet e bëra në funksion të eksporteve të kryera ose për t'u kryer (fatura tatimore origjinale të kontrolluara nga organet tatimore).

18.5 Kreditimi në rastet e importeve

Moment i regjistrimit të importit në librin e blerjeve të personit të tatueshëm importues (kur importi quhet i kryer) është "Data e Çlirimit", datë kur mallrat clirohen nga dogana. Ajo paraqitet në "Urdhërin e Lëshimit", dokument i lëshuar nga organi doganor dhe i bashkëngjitet deklaratës doganore të importit.

Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përcaktohet mbi bazën e dispozitave të legjislacionit doganor pavaresisht nese mallrat e importuara janë apo jo të taksueshme me taksa doganore.

Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përfshin, gjithashtu:

- shpenzimet e transportit e te sigurimit dhe shpenzimet e tjera, te perfshira ne importimin e mallrave dhe lëvrimin e tyre, deri ne momentin e çastin e hyrjes ne territorin e Republikes se Shqiperise;
- tarifate, taksat dhe detyrime të pagueshme, si pasojë e eksportimit të këtyre mallrave nga shtete prej të cilave ato eksportohen apo të pagueshme si rezultat i importimit të tyre, përveç TVSH të pagueshëm që nuk përfshihet në bazë të këtij ligji.

Pas zhdoganimit, organet doganore mund të bëjnë rivlerësime të vlerës doganore të mallrave të importuara. Dallohen rastet :

a) *Rivleresim ne rritje i vlerës doganore te importit:* personi i tatueshëm eshte debitor ndaj doganes. Vetem pasi ai shlyen detyrimin ndaj doganes i njihet vlera e rritur e TVSH së zbritshme nga importi ne FDP e muajit në të cilin është bërë pagesa. Rivleresimet ne rritje të vlerës doganore raportohen per DPT nga organet doganore, vetem ne rastin kur ato jane paguar.

Shembull :

Ne 12 Janar 2006 tatimpaguesi ka bërë një import me vlerë të tatueshme prej 100 000 lekë. Ne FDP e periudhes tatimore 200601 tatimpaguesi raporton vlerën 100 000 leke ne kutine 14 dhe TVSH përkatëse prej 20 000 lekë në kutinë 15. Në 25 Shkurt 2006 dogana e rivlereson në rritje vlerën e tatueshme në shumën 200 000 leke. Tatimpaguesi do te pasqyroje ne librin e blerjeve diferencën ndermjet vleres se fundit dhe vlerës së mëparshme të deklaratës pra, 200 000 – 100 000=100 000 lekë. TVSH që paguan tatimpaguesi për diferencë është 20 000 lekë. Pagesa bëhet në 5 mars 2006, që është edhe data e regjistrimit ne librin e blerjeve. Njëkohësisht në FDP e periudhës tatimore 200603, do të rriten respektivisht kutia (14) Importet me 100 000 lekë dhe kutia (15) e TVSH së zbritshme me 20 000 lekë.

b) *Import rivleresim ne ulje i vlerës doganore:* personi i tatueshëm ka paguar TVSH ne dogane më shumë nga sa i takonte dhe nga ana tjetër në organin tatimor ka deklaruar TVSH te zbritshme me shume nga sa i takonte. Në këtë rast organi doganor nuk e rimbursen personin e tatueshëm,

Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata www.tatime.gov.al

dhe ai nuk e ndryshon deklarimin e TVSH te zbritshme nga importi ne FDP e muajit në të cilin ishte bërë deklarim

19. KREDITIMI I PJESSHËM I TATIMIT

Në mbështetje të nenit 33 pika 4, nëqoftëse një furnizim malli apo shërbimi përdoret pjesërisht për qëllime të furnizimeve të tatueshme të bëra ose për t'u bërë dhe pjesërisht për furnizime të përjashtuara, lejohet vetëm një pjesë e kreditimit të tatimit. Llogaritja e kreditimit të pjesshëm bëhet në bazë të përqindjes të kreditimit sic percaktohet në pikën 19.1. më poshtë.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,dt.12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 dt. 29 maj 2009).

19.1.1 Përqindja e kreditimit te tatimit mbi vlerën e shtuar.

Përqindja e kreditimit do të llogaritet si raport i shumës pa përfshirë TVSH të furnizimeve të tatueshme dhe eksporteve në numërues me qarkullimin gjithsej pa përfshirë TVSH në emërues

Përqindja e kreditimit është raporti: qarkullimi i tatueshem + eksporte/qarkullimi i tatueshem + eksporte + furnizime të përjashtuara

Llogariten dy përqindje kreditimi:

- përqindja fillestare dhe,
- përqindja përfundimtare.

19.1.2 Periudha që merret për llogaritjen e përqindjes të kreditimit

Periudha që merret parasysh për llogaritjen e përqindjes fillestare të kreditimit të tatimit është viti i mëparshëm kalendarik. Nëqoftëse personi është në vitin e parë të regjistrimit, ai duhet të bëjë një vlerësim të përqindjes me gjykimin e tij. Periudha që merret për bazë në llogaritjen e përqindjes përfundimtare të kreditimit është viti kalendarik në të cilin është bërë blerja (furnizimi i mallit apo shërbimit). Veprimet për llogaritjen e përqindjes të kreditimit dhe saktësimi i TVSH për t'u kredituar duhet të pasqyrohen në librin e blerjeve në periudhën kur bëhen llogaritjet.

19.1.3 Rregullimi përfundimtar

Jo më vonë se data 31 janar e vitit pasardhës kalendarik, personi i tatueshëm duhet të rillogarisë përqindjen përfundimtare të kreditimit të TVSH që i takon furnizimeve të tatueshme, sipas qarkullimit të realizuar në fakt. Rregullimi përfundimtar bëhet kur përqindja përfundimtare e kreditimit ndryshon nga përqindja fillestare e kreditimit të zbatuar gjatë vitit me më shumë se 20%.

Nëqoftëse ndryshimi nuk kalon 20%, kreditimi fillestar nuk ndryshon.

P.sh. në vitin 2003 qarkullimi gjithsej pa TVSH është 5 milionë lekë, nga i cili:

- furnizime të tatueshme 2,5 milionë lekë dhe,
- furnizime të përjashtuara 2,5 milionë lekë.

Përqindja e kreditimit të tatimit është:

$$2,5 \text{ milionë} / 5 \text{ milionë} = 50\%$$

Adresa: Rruga Gjin Bue Shpata

www.tatime.gov.al

Në vitin 2004, qarkullimi gjithsej pa TVSH është 7.000.000 lekë nga te cilat:

- furnizime të tatueshme 2 milionë lekë;
- furnizime të përjashtuara 5 milionë lekë.

Përqindja e kreditimit të tatimit është:

$$2 \text{ milionë} / 7 \text{ milione} = 28.5\%$$

Në mars të vitit 2004 blihet një banak me një vlerë 10 mijë leke. TVSH i paguar është 1250 lekë.

Në këtë kohe personi i tatueshëm mund të llogaritë vetëm përqindjen fillestare të kreditimit atë të vitit 2003. Prandaj kreditimi i pjesshëm i tatimit do të llogaritet me përqindjen fillestare të kreditimit:

$$1250 \times 50\% = 625 \text{ leke}$$

Në janar 2005 do të bëhet rregullimi përfundimtar i kreditimit të pjesshëm të kërkuar sepse përqindja fillestare me të cilën është llogaritur kreditimi i pjesshëm i tatimit ndryshon nga përqindja përfundimtare e vitit 2004, me më shumë se 20%.

- Kreditimi përfundimtar i TVSH $1250 \times 28.5\% = 356$ lekë;
- Kreditimi fillestar i TVSH 625 lekë;
- Rregullimi në minus $625 - 356 = 269$ lekë.

Veprimet për rregullimin përfundimtar të kreditimit pasqyrohen në librin e blerjeve në janar të vitit pasardhës kalendarik dhe raportohen në deklaratën e këtij muaji. Në deklaratën e muajit janar 2005 kreditimi i TVSH pakësohet me 269 lekë.

Aktivitet e qëndrueshme

Për aktivitet e qëndrueshme rregullimi i kreditimit të pjesshëm do të bëhet me 2 mënyrat e mëposhtme :

Mënyra e parë është ajo e përshkruar në paragrafin e mësipërm për furnizimet e zakonshme të mallrave dhe shërbimeve.

Mënyra e dytë do të përdoret vetëm në rastet kur cmimi i aktivitet të qëndrueshëm është më i madh se 1.000.000 lekë (pa TVSH) dhe ndryshimi i përqindjes fillestare të kreditimit me përqindjen përfundimtare është me i madh se 20 %. Kjo mënyre mban parasysh afatin e amortizimit të aktiveve të qëndrueshme. Në këto raste, vetëm për qëllime të TVSH-se periudha e amortizimit të aktivitet të qëndrueshëm do të merret 5 vjet.

P.sh., përqindja e kreditimit të tatimit për vitin 1999 është 60%. Në mars të vitit 2000 blihet një aktiv qëndrueshëm me një vlerë pa TVSH prej 2 milionë lekë. TVSH e paguar për aktivin e qëndrueshëm është 250 mijë lekë, me një kreditim të pjesshëm prej 150.000 leke, i llogaritur me përqindjen fillestare 60%:

$$250.000 \times 60\% = 150.000 \text{ lekë.}$$

Përqindja e kreditimit të TVSH për vitin 2000 është 30%.

Kreditimi përfundimtar i TVSH është $250.000 \times 30\% = 75.000$ lekë.
Kreditimi fillestar i TVSH është 150 mijë lekë.
Rregullimi i kreditimit në minus është $150.000 - 75.000 = 75.000$ leke.
Ky rregullim do të bëhet në deklaratën e janarit 2001.

Përqindja e kreditimit për vitin 2001 është 55%.

Ndryshimi i përqindjes të kreditimit të vitit 2001 me përqindjen e kreditimit të vitit 2000 është më i madh se 20%.

Ndryshimi është:
 $55\% - 30\% = 25\%$

Rregullimi i kreditimit në plus llogaritet: (kreditimi përfundimtar x koeficientin e amortizimit vjetor) x ndryshimi i përqindjes të kreditimit të vitit 2001 nga përqindja e kreditimit të vitit 2000:

$(75.000 \times 1/5) \times 25\% = 3.750$ lekë

Ky rregullim do të bëhet në deklaratën e janarit 2002.

Përqindja e kreditimit për vitin 2002, është 40%. Ndryshimi i saj me përqindjen e vitit 2001, nuk i kalon 20% ($40\% - 25\%$) = 15%.

Rregullimi i kreditimit është 0

Përqindja e kreditimit për vitin 2003 është 42%.

Rregullimi i kreditimit është 0.

Përqindja e kreditimit për vitin 2004 është 60%.

Rregullimi i kreditimit është 0.

Pra, rregullimi i fundit i kreditimit është 3.750 lekë.

19.2. Ndryshimet e përdorimit të aktiveve qëndrueshme.

Nëqoftëse aktivet e qëndrueshme të përdorura për veprimtari të tatueshme ose për eksporte :

- përdoren më vonë për veprimtari private,
- i transferohen një veprimtarie të përjashtuar
- shiten dhe shitja nuk është e tatueshme,
- dalin jashtë përdorimit përpara afatit të amortizimit,

atëherë rregullimi i kreditimit fillestar do të bëhet vetëm nëqoftëse aktivi kapital ndryshon përdorimin brenda 5 vjetëve nga data e blerjes ose e përfitimit dhe nëqoftëse çmimi i aktivit i tejkalon 1 milion lekë pa TVSH. Rregullimi bëhet duke përdorur koeficientin e amortizimit vjetor që

merret 1/5. Viti kalendarik i papërfunduar do të merret si vit i plotë. Veprimet e saktësimit të kreditimit fillestar duhet të pasqyrohen në librin e blerjeve.

Shembull. Një shoqëri blen brenda vendit në muajin gusht të vitit 2000 një aktiv të qëndrueshëm me një vlerë 2 milionë lekë. Kreditimi fillestar, pra TVSH e zbritshme, është 400 mijë lekë (2 milionë x 20% shkalla tatimore) dhe paraqitet në librin e blerjeve të muajit gusht 2000 nga shoqëria. Njëkohësisht kjo shumë paraqitet në kutinë 17 në FDP e muajit gusht 2000.

Në muajin maj të vitit 2002, kjo shoqëri e ndalon veprimtarinë e saj ekonomike dhe e mban aktivin e qëndrueshëm për përdorim privat. Megjithatë më parë shoqëria kishte deklaruar të plotë TVSH e zbritshme të aktivit asaj i lind detyrimi të bëjë rregullimin e kreditimit.

Rregullimi i kreditimit do të bëhet duke mbajtur parasysh nga të pesë vitet e amortizimit total të tij, 2 vjetët e mbetur në të cilat ky aktiv i qëndrueshëm nuk do të përdoret për veprimtari ekonomike: Shuma e TVSH së zbritshme që duhet të kthejë shoqëria është $400.000 \times 2/5 = 160$ mijë leke.

Rregullimi bëhet në librin e blerjeve të shoqërisë në periudhën tatimore në të cilën ka ndodhur ngjarja që bën të detyrueshëm rregullimin e kreditimit.

Në rastin konkret, në librin e blerjeve të muajit maj 2002, në rreshtin e fundit do të paraqitet me storno shuma e TVSH së zbritshme prej 160 mijë lekë që do të kthehet nga shoqëria duke pakësuar totalin e TVSH së zbritshme të atij muaji.

Në rastet kur shpenzimet e rinovimit apo rikonstruksionit të aktiveve të qëndrueshme janë objekt i amortizimit sipas rregullave të percaktuara në ligjin "Për Tatimin mbi të ardhurat", rregullimi i kreditimit të TVSH që i perket ketyre shpenzimeve bëhet në përputhje me afatin 5 vjeçar që fillon nga data kur këto shpenzime janë kryer.

19.3 Furnizimet të cilat përdoren edhe në veprimtarinë ekonomike edhe në veprimtari jo ekonomike (për qëllime private).

Në këto raste do të lejohet kreditimi i një pjese të tatimit të paguar në blerje, nëse personi ka dokumenta ku pasqyrohet saktë pjesa e shpenzimeve që është e lidhur me veprimtarinë ekonomike.

19.4 Llojet e furnizimeve të tatueshme dhe importimeve për të cilat nuk lejohet kreditimi.

Në mbështetje të nenit 33 pika 5 kreditimi i tatimit nuk lejohet për:

1) Shpenzimet e karburantit, përveçse kur qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë.

Për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, kreditimi i TVSH-së së gazoilit të blerë për këtë qëllim, është i lejueshëm deri në normativat e listuara më poshtë, mbi bazën e treguesit të percaktuar sipas peshës specifike që blerjet për gazoil zënë në raport me qarkullimin e kryer për qëllime të veprimtarisë ekonomike.

Normativat e kreditimit të TVSH-së së gazoilit

I. Ndërtim

Adresa: Rruga Gjini Bue Shpata

www.tatime.gov.al

- a) Prodhim materiale inerte deri më 33%;
- b) Ndërtim shtrim rrugësh deri më 32%;
- c) Ndërtim banesash dhe objektësh të ndryshme deri më 8%;
- ç) Prodhim betoni deri më 14%;
- d) Gërmime/shpime deri më 25%;
- dh) Prodhim tullash dhe tjegullash 33%.

II. Transport

- a) Transport udhëtarësh deri më 43%;
- b) Transport mallrash deri më 38%;
- c) Transport mallrash me mjete teknologjike 78%.

III. Shërbime

- a) Autoshkolla deri më 25%;
- b) Shërbime pastrimi qyteti deri më 30%;
- c) Peshkimi deri më 10%.

III. Tregti deri më 3%

IV. Të tjera (të palistuara më lart) deri më 2%

Barra e provës për të provuar qëllimin e përdorimit të gazoilit për qëllime të veprimtarisë ekonomike të tatueshme, bie mbi personin e tatueshëm.

Nëse nga kontrolli i thelluar konstatohet që personi i tatueshëm me pa të drejtë ka kredituar TVSH-në lidhur me blerjen e gazoilit, duke mos e justifikuar atë, Drejtoria Rajonale Tatimore aplikon të gjitha sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor në fuqi.

(Ndryshuar me Udhëzim nr. 6/3, dt. 8.4. 2014. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 47, dt. 9 prill 2014.).

2) Shpenzimet për udhetime e dieta, strehimin në hotele dhe veprimtari çlodhëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

- 3) Shpenzimet për autovetura, përveç rasteve kur:
 - Qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për ti shitur ato.
 - Përdorimi i veturave është i vetmi qëllim i veprimtarisë ekonomike (psh dhënia me qira, shërbimi i taksive, ambulancave).
- 4) Shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i përdorur për autoveturat.
- 5) Shpenzimet për artikuj publicitare, promociionale.
- 6) Të gjitha shërbimet në lidhje me shpenzimet e përmendura në paragrafët nga (1) në (5).

19.5 SHFUQIZOHET. (Me Udhëzim nr. 6/3, datë 9 prill 2014).

20. Rimbursimi i TVSH-së

Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 7928, date 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, rimbursimi i TVSH-së kryhet nga sistemi i Thesarit. Afatet e përcaktuara për rimbursimin e TVSH-së sipas kategorive të personave të tatueshëm fillojnë nga data e protokollimit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së, në Drejtorinë Rajonale Tatimore, datë e cila është e njëjtë me datën e mbërritjes ose paraqitjes së kërkesës për rimbursim nëpërmjet shërbimit postar rekomandë (me nënshkrim të marrësit).

20.1 Rimbursimi i personave të tatueshëm

20.1.1 Çdo person i tatueshëm, i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 50 të ligjit, ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e TVSH-së. Për të kërkuar rimbursimin e TVSH-së, personi i tatueshëm, pasi të ketë plotësuar rubrikën përkatëse “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së”, të formularit të deklarimit të TVSH-së të periudhës së fundit tatimore, dërgon në Drejtorinë Rajonale Tatimore:

a) Një kërkesë me shkrim me objekt “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së”, në të cilën specifikohen të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm, emri i administratorit/ët, adresën/at e saktë të veprimtarisë, degën e bankës dhe numrin e llogarisë bankare të personit të tatueshëm, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë dhe arsyet e krijimit të TVSH-së kreditore, periudhën përgjatë së cilës është krijuar TVSH-ja kreditore, si edhe nëse kërkesa për rimbursim është për herë të parë apo jo. Nëse personi i tatueshëm që kërkon rimbursimin e TVSH-së është eksportues, kjo shprehet në kërkesën e paraqitur;

b) Formularin “Kërkesë për rimbursim” sipas modelit bashkëngjitur udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, i ndryshuar.

Drejtoria Rajonale Tatimore, me marrjen e kërkesës për rimbursim, protokollon kërkesën në regjistrin e protokollit dhe brenda ditës së nesërme e regjistron atë në një regjister të veçantë për rimbursimet e TVSH-së, sipas rendit kronologjik të datës së paraqitjes së kërkesës.

Ky regjister mbahet nga një punonjës i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i caktuar si person përgjegjës për të mbajtur dhe administruar regjistrin e rimbursimeve nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore.

20.1.2 Punonjësi i ngarkuar me mbajtjen dhe administrimin e regjistrit të rimbursimeve, brenda 3 (tri) ditëve punë, nga data e regjistrimit në regjistrin e rimbursimeve, kryen dhe përfundon procesin e verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim në lidhje me:

a) Të dhënat identifikuese të personit të tatueshëm (emri tregtar, NIPT-i, ortaku/ortakët, administratori/ administratorët, llojin e veprimtarisë, numrin e llogarisë bankare ku kërkohet të bëhet rimbursimi, adresën(-at) e vendndodhjes së veprimtarisë, evidentimin nëse kërkesa për rimbursim është për herë të parë apo kërkesë e përsëritur, si dhe të dhëna të tjera të dosjes së personit të tatueshëm;

b) Verifikimin e shumës së paraqitur në formularin “Kërkesë për rimbursim”, nëse ajo është e barabartë me shumën e paraqitur në rubrikën përkatëse të FDP-së të muajit korrespondues, si dhe periudhën për të cilën është kërkuar rimbursimi;

c) Plotësimin e kërkesave ligjore mbi kërkesën për rimbursim, të cilat konsistojnë në:

i) Për personat e tatueshëm të përcaktuar eksportues sipas VKM-së për këtë qëllim, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse teprica kreditore e kërkuar për rimbursim është e barabartë ose më e madhe se 400.000 lekë;

ii) Për personat e tatueshëm të tjerë joeksportues, verifikimin e plotësimit të kriterit ligjor, nëse personi i tatueshëm ka mbartur tepricë kreditore të TVSH-së për të paktën 3 periudha tatimore radhazi dhe kjo tepricë është e barabartë ose më e madhe se 400.000 lekë;

iii) Në rastet e parashikuara në pikën 3 të nenit 50 të ligjit, nëse kërkesa për rimbursim është bërë në kuadër të marrëveshjeve financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në kuadër të marrëveshjeve të granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në të cilat parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar.

Në përfundim të këtij procesi, personi përgjegjës mban një akt për evidentimin e plotësimit ose jo të kriterëve të mësipërme.

20.1.3 Kërkesa për rimbursim konsiderohet e papranuar nëse nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim, nuk janë plotësuar kriteret e përgjithshme si në pikën 20.1.2, ose e pranuar nëse këto kriterë janë plotësuar.

a) Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton se kriteret nuk janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e parregullt dhe nuk pranohet. Në këtë rast, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe me administrimin e kërkesave për rimbursim, brenda 2 (dy) ditëve punë nga përfundimi i procesit të verifikimit, nis nëpërmjet shërbimit postar për personin e tatueshëm një njoftim me shkrim sipas formatit nr. 1, bashkëngjitur këtij udhëzimi “Njoftimi për mospranim të kërkesës për rimbursim të TVSH-së”, ku i bëhet e ditur se kërkesa e tij nuk është pranuar, duke dhënë njëkohësisht edhe shkaqet e mospranimit. Ky person i tatueshëm, mund të paraqesë një kërkesë të dytë të re për rimbursim sipas rregullave të mësipërme, vetëm pasi të ketë rregulluar situatën dhe të ketë eliminuar shkaqet për të cilat nuk iu pranua kërkesa e mëparshme.

Në këtë rast, personi përgjegjës për mbajtjen e regjistrit, në bashkëpunim me inspektorin e dosjes, bën rivlerësimin e rubrikës përkatëse “Kërkesë për rimbursim të TVSH-së” të deklaratës së periudhës kur kërkesa është bërë, duke hequr vlerën nga rubrika përkatëse dhe automatikisht kjo vlerë kalon si TVSH e mbartur.

b) Në rastin kur nga procesi i verifikimit paraprak të kërkesës për rimbursim rezulton se kriteret janë plotësuar, kërkesa konsiderohet e pranuar. Në këtë rast, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe me administrimin e kërkesave për rimbursim, brenda 2 (dy) ditëve punë nga përfundimi i procesit të verifikimit, nis njoftimin për degën përkatëse të Thesarit nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore). Një kopje e këtij njoftimi i dërgohet edhe personit të tatueshëm. Njoftimi sipas formatit nr. 2 “Njoftim për pranimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së”, bashkëlidhur këtij udhëzimi, informon degën e Thesarit

se kërkesa e personit të tatueshëm për rimbursim të TVSH-së është pranuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe ky njoftim përmban: i) emrin dhe NIPT-in e personit të tatueshëm; ii) cilësimin nëse subjekti është eksportues ose jo; iii) shumën e kërkuar për rimbursim; dhe iv) datën kur është protokolluar kërkesa në Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas paragrafit 20.1.1. Ky njoftim nënshkruhet nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Për rastin “b”, në ditën në të cilën kërkesa konsiderohet e pranuar, ajo adresohet për kontroll në vend, të personit të tatueshëm. Radha e kontrollit ndjek, në çdo rast dhe pa asnjë përjashtim, radhën kronologjike të paraqitjes së kërkesave për rimbursim të TVSH-së. Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, në përputhje me procedurën e kontrollit, lëshon njoftimin për kontroll tatimor në vend të personit të tatueshëm, ku jepet data e fillimit dhe e përfundimit të kontrollit, inspektori/ët e ngarkuar për kontroll dhe qëllimi i kontrollit, periudhat tatimore për të cilat do të shtrihet kontrolli etj. Procedura e kontrollit në vend kryhet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, date 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

20.1.4 Struktura përgjegjëse e degës së Thesarit, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e njoftimit të Drejtorisë Rajonale Tatimore, sipas pikës 20.1.3/b, e regjistron atë sipas rastit në një regjistër të veçantë të saj, ku regjistron datën e kërkesës për rimbursim të personit të tatueshëm sipas datës së protokollit të kërkesës për rimbursim në Drejtorinë Rajonale Tatimore, si dhe të dhënat e tjera sipas kësaj shkrese. Struktura përgjegjëse e Thesarit në qendër merr masa për të siguruar likuiditetin e nevojshëm për pagesën e shumës së rimbursimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore brenda 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim kur personi i tatueshëm është eksportues i klasifikuar sipas pikës 20.2 të këtij udhëzimi, ose për rastin e marrëveshjeve sipas nenit 50, pika 3 të ligjit, dhe brenda 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim për tastet e tjera të personit të tatueshëm.

Brenda 3 ditëve të para të punës së çdo tremujori, dega e Thesarit rakordon me drejtorinë rajonale tatimore respektive mbi të dhënat e regjistruara nga të dyja institucionet për kërkesat e personave të tatueshëm për rimbursim të TVSH-së.

20.1.5 Punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, paralelisht dhe pavarësisht nga procedura e kontrollit në vend të personit të tatueshëm, në bashkëpunim me punonjësin e dosjes së personit të tatueshëm, kryen verifikimin e situatës financiare të tatimpaguesit në sistemin informatik, por pa u kufizuar vetëm në të, dhe evidenton detyrimet tatimore të papaguara.

Pas përfundimit të kontrollit dhe nxjerrjes së rezultateve përfundimtare, ku saktësohet shuma e TVSH-së për t’u rimbursuar, raporti përfundimtar i kontrollit i përcillet drejtorisë përgjegjëse për përpunimin, vlerësimin e të ardhurave dhe rimbursimin, e cila procedon me kompensimin e detyrimeve tatimore të papaguara, përveç kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Pas saktësimit të shumës së TVSH-së të mbetur pas kompensimit të detyrimeve të papaguara, nëse ka të tilla, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, përgatit njoftimin zyrtar sipas formatit nr. 3 “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Njoftimi i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së. Ky njoftim përmban, përveç të dhënave identifikuese të personit të tatueshëm, dhe datën e protokollimit të kërkesës për rimbursim, shumën e TVSH-së së kërkuar për rimbursim sipas kërkesës së personit të tatueshëm, shumën e miratuar si të rimbursueshme sipas raportit përfundimtar të kontrollit, shumën e nevojshme të përdorur apo për t’u përdorur (nëse procesi i kompensimit nuk ka përfunduar i plotë brenda afateve) për likuidimin e të gjitha detyrimeve

tatimore të papaguara të personit të tatueshëm ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore, si dhe shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimburohet në llogarinë e personit të tatueshëm.

20.1.6 Punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, plotëson urdhër-pagesën për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimburohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit nr. 4 të urdhërpagesës bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe së bashku me njoftimin zyrtar në përputhje me formatin nr.3, sipas pikës 20.1.5, pasi nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i dërgohen me postë rekomande degës përkatëse të Thesarit në dy kopje.

Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vulolet nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore. Dega përkatëse e Thesarit, regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë brenda ditës së paraqitjes nga Drejtoria Rajonale Tatimore, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoritë rajonale të tatimeve rakordojnë me degët e Thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të Thesarit) njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

20.1.7 Kur nga raporti përfundimtar i kontrollit tatimor mbi kërkesën për rimbursim rezulton se shuma e TVSH-së së kërkuar për rimbursim nga personi i tatueshëm nuk plotëson kushtet për rimbursim dhe, për rrjedhojë, nuk rimburohet, Drejtoria Rajonale Tatimore refuzon kërkesën për rimbursim dhe njofton zyrtarisht degën përkatëse të Thesarit në formatin nr. 5 “Njoftim për refuzimin e kërkesës për rimbursim të TVSH-së” bashkëlidhur këtij udhëzimi nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore) në dy kopje, njëra prej të cilave, pasi kundërfirmoset dhe vulolet, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore, duke vërtetuar se është bërë çregjistrimi i kërkesës për rimbursim të personit të tatueshëm nga Regjistri i Sistemit të Thesarit.

Ndërkohë mbi refuzimin e kërkesës për rimbursim, personi i tatueshëm njoftohet me një akt zyrtar, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

20.1.8 Në raste të refuzimit ose të mosmiratimit të një kërkesë për rimbursim, plotësisht ose pjesërisht, nga Drejtoria Rajonale Tatimore për arsye që kanë të bëjnë me rezultatet e kontrollit ose me shkelje të tjera ligjore, personi i tatueshëm ndaj çdo refuzimi ose mosmiratimi për rimbursim, ka të drejtë të apelojë në përputhje me dispozitat e ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

20.1.9 Të gjitha procedurat e mësipërme, për kryerjen e të cilave ngarkohet Drejtoria Rajonale Tatimore, duhet të kryhen brenda afateve të përcaktuara, përkatësisht 30 ditë për eksportuesit dhe 60 ditë për personat e tjerë të tatueshëm, duke filluar nga data e protokollit të kërkesës për rimbursim në Drejtorinë Rajonale Tatimore. Në rast se organi tatimor përfundon procedurat e kontrollit përpara afatit 30 ditë për eksportuesit dhe 60 ditë për personat e tjerë të tatueshëm, procedura e rimbursimit vazhdon sipas përcaktimeve të bëra në pikën 20.1.6 të këtij udhëzimi.

20.1.10 Procedura e përcaktuar në këtë udhëzim do të zbatohet për të gjitha kërkesat për rimbursim të TVSH-së të protokolluara në drejtoritë rajonale tatimore pas datës 1.1.2014.

20.1.11 Për çdo kërkesë të konsideruar të pranuar, protokolluar pas datës 1.1.2014 deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, drejtoritë rajonale tatimore, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, njoftojnë degën përkatëse të Thesarit me anë të njoftimit sipas formatit nr. 2 “Njoftim për pranim të kërkesës për rimbursim”, dhe vijnë procedurat e

përcaktuara në këtë udhëzim.

20.2 Rimbursimi i personave të tatueshëm eksportues Në zbatim të nenit 50, paragrafi 4 dhe 5 të ligjit për TVSH-në, rimbursimi i TVSH-së të personave të tatueshëm eksportues kryhet nëpërmjet sistemit të Thesarit sipas procedurës së përcaktuar në këtë udhëzim. Klasifikohen “eksportues” ata persona të tatueshëm që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me vendi të Këshillit të Ministrave. Klasifikimi i personave të tatueshëm eksportues me risk zero, bëhet nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve në të cilën ato janë regjistruar, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

20.2.1 Për personat e tatueshëm të klasifikuar si eksportues me risk zero, kontrolli tatimor në vend nuk është i detyrueshëm përpara miratimit të rimbursimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore. Për këtë kategori të eksportuesve, kontrolli tatimor mund të kryhet në çdo moment sipas planifikimit për kontroll.

Në rastin kur personi i tatueshëm eksportues ka plotësuar kriteret e përgjithshme për rimbursim sipas pikës 20.1.1 dhe 20.1.2, kërkesa konsiderohet e pranuar. Në këtë rast, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe me administrimin e kërkesave për rimbursim, brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e përfundimit të procesit të verifikimit, nis njoftimin për degën përkatëse të Thesarit nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe në formë shkresore). Ky njoftim sipas formatit nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi, “Njoftim për pranim të kërkesës për rimbursim”, informon degën e Thesarit se personi i tatueshëm ka paraqitur një kërkesë të rregullt për rimbursim të TVSH-së. Në të njëjtën kohë, njoftimi zyrtar i përgatitur sipas formatit nr. 2 (i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm, eksportues me risk zero që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së).

Në vijim të procedurës brenda, afatit 30-ditor, i cili fillon me datën e protokollit të kërkesës për rimbursim, Drejtoria Rajonale Tatimore, pasi verifikon dhe kompenson detyrimet tatimore të papaguara (nëse ka të tilla), përveç kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përgatit njoftimin sipas formatit nr. 3 “Njoftim për miratimin e rimbursimit të TVSH-së”. Këtë njoftim, së bashku me urdhër-pagesën për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm dhe të dhëna të tjera sipas formatit nr. 4 të urdhërpagesës, pasi nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, i dërgohen me postë rekomande degës përkatëse të Thesarit në dy kopje.

Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloset nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore. Dega përkatëse e Thesarit, regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë brenda ditës së paraqitjes nga Drejtoria Rajonale Tatimore, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoritë rajonale të tatimeve rakordojnë me degët e Thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare për detyrimin tatimor lidhur me TVSH-në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të Thesarit) njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

20.2.2 Për kategoritë e tjera të eksportuesve sipas VKM-së, rimbursimi kryhet sipas procedurave të zakonshme të përshkruara në pikën 20.1 të këtij udhëzimi, pasi shuma e kërkuar për rimbursim i është nënshtruar një kontrolli tatimor në vend.

Rimbursimi i TVSH-së së miratuar kryhet nga dega e Thesarit nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë. Në përfundim të procedurave me miratimin e TVSH-së së rimbursueshme, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, punonjësi i caktuar me mbajtjen e regjistrit dhe administrimin e kërkesave për rimbursim, plotëson urdhër-pagesën për rimbursim (UPR) me shumën e TVSH-së, e cila duhet të rimbursohet për personin e tatueshëm eksportues dhe të dhëna të tjera sipas formatit të urdhërpagesës

bashkëngjitur këtij udhëzimi dhe së bashku me njoftimin zyrtar të përgatitur sipas 20.1.5, pasi nënshkruhen nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore i dërgohen dorazi degës përkatëse të Thesarit në dy kopje. Në të njëjtën kohë, njoftimi zyrtar i përgatitur sipas pikës 20.1.5, i dërgohet me postë rekomande edhe personit të tatueshëm që ka bërë kërkesën për rimbursim të TVSH-së.

Njëra nga kopjet e UPR-së, pasi kundërfirmoset dhe vuloet nga dega e Thesarit, i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore. Dega përkatëse e Thesarit regjistron UPR-në në sistemin informatik financiar të qeverisë brenda ditës së paraqitjes nga Drejtoria Rajonale Tatimore, duke debituar llogarinë ekonomike të së ardhurës nga TVSH-ja për shumën e rimbursueshme. Drejtoritë rajonale të tatimeve rakordojnë me degët e Thesarit në bazë të arkëtimeve të mjeteve monetare për detyrimin tatimor lidhur me TVSH- në. Struktura përgjegjëse e degës përkatëse të Thesarit pas rakordimit të postës bankare (nxjerrjes së llogarisë së unifikuar të Thesarit) njofton zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore, e cila reflekton ndryshimet në dosjen e tatimpaguesit dhe në kontabilitet.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 6, dt. 27.2.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, dt. 10 mars 2014).

20.3 Rimbursimi për marrëveshjet financiare

Në zbatim të pikës 3 të nenit 50 të ligjit “Për TVSH- në”, për rastet kur në marrëveshjet financiare të ratifikuara nga Kuvendi ose në marrëveshjet e granteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave parashikohet mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë ose jo tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi vlerën e shtuar i paguar, u rimbursohet financuesve të huaj brenda 30 ditëve nga strukturat përgjegjëse të Thesarit (sipas rregullave në pikën 20.1 të këtij udhëzimi) nëpërmjet sistemit informatik financiar të qeverisë), sipas rregullave të përcaktuara më poshtë në këtë udhëzim. Për rimbursimin e kryer sipas kësaj procedure, kontrolli tatimor në vend nuk është i detyrueshëm përpara rimbursimit.

Çdo procedurë për rimbursimin apo financimin e TVSH-së për rastet e mëposhtme pavarësisht nëse kryhen nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve apo financohen sipas procedurave të VKM-së nr. 509, date 12.8.1996, nga përfituesi vendas, do të përfundojë brenda 30 ditëve përfshirë edhe rimbursimin e shumave nga strukturat përgjegjëse të Thesarit.

20.3.1 Kur pavarësisht përjashtimit, TVSH-ja përballohet (paguhet) direkt nga donatori.

a) Kur projekti realizohet (zbatohet) nga vetë njësia zbatuese.

Njësia zbatuese e projektit për qëllime të rimbursimit të TVSH-së sipas nenit 50 pika 3 të ligjit, duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me këtë ligj. Njësia zbatuese e projektit çregjistrohet në përfundim të afatit të projektit. TVSH-ja mbulohet (përballohet) direkt nga njësia zbatuese e donatorit apo e projektit në Shqipëri si për blerjet brenda vendit ashtu dhe për importet, njësia paraqet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku ka qendrën njësia zbatuese e projektit, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

- Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për

secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

- Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH- së që kërkohet të rimbursohet.

- Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat drejtorinë rajonale tatimore përkatëse dhe të dorëzojë deklaratën e TVSH-së në përputhje me këtë ligj. Njësia zbatuese e projektit regjistrohet në përfundim të afatit të projektit. Njësia zbatuese e projektit paraqet në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku është e regjistruar, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesën për rimbursim, ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim etj.

- Kopjen në shqip të noterizuar të marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të marrëveshjes së miratuar nga qeveria. Kontrata e projektit, e hartuar në kuadër të marrëveshjes, duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e kontratës shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtarë të çdo projekti.

- Deklaratat e TVSH-së, teprica kreditore e mbartur e të cilave duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH- së që kërkohet të rimbursohet.

- Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat, ashtu dhe deklaratat doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin “Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr. __, datë __/doganore të importit, duhet të përmbajnë në mënyrë __/ 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë shumë të dukshme shënimin “Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Këshilli i Ministrave me nr. __, datë __/__/ 20__ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje”. Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

b) Kur projekti realizohet nga sipërmarrës të kontraktuar nga njësia zbatuese.

Në këtë rast, në kuadër të zbatimit të projektit, është shoqëria sipërmarrëse e punimeve, e cila për zbatimin e projektit sipas kontratës aplikon TVSH-në mbi vlerën e punimeve, shërbimeve apo furnizimit të mallrave të kryer. Shoqëria sipërmarrëse nga TVSH-ja e faturuar zbret TVSH-në e paguar në blerjet që ka bërë për këtë qëllim, të përballuar nga vetë ajo dhe diferenca përfaqëson TVSH-në e pagueshme nga kjo shoqëri, TVSH-ja, e cila deklarohet dhe paguhet sipas këtij ligji. Faturën origjinale të shitjes, së bashku me situacionin e punimeve, shoqëria sipërmarrëse e punimeve ia paraqet njësisë zbatuese të projektit.

Njësia zbatuese e projektit, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së sipas nenit 50, pika 3 të ligjit, duhet të pajiset me NIPT (certifikatë regjistrimi) në marrëveshje”. Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit, i njohur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në bazë të listës së mësipërme, i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

20.3.2 TVSH-ja përballohet nga përfituesi vendas i projektit si kosto lokale.

Kryerja e punimeve, furnizimi i mallrave apo i shërbimeve për zbatimin e projekteve do të ngarkohet kurdoherë me TVSH, e cila në çdo rast do të paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e kontraktuar për zbatimin e projektit. Por kjo TVSH do t'i jepet atij përkundrejt paraqitjes së fatures (situacionit) me TVSH nga burime të brendshme të financuara nga kosto lokale

sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, date 12.8.1996. Kështu, kur donatori nuk merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së, do të veprohet në përputhje me VKM-në nr. 509, datë 12.8.1996. Në bazë të këtij vendimi, TVSH-ja financohet nga përfituesi apo investitori vendas i projektit dhe paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.

Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.

(Ndryshuar me Udhëzim Nr. 6, dt. 27.2.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, dt. 10 mars 2014).

20.4. Në rastin e zbatimit të Marrëveshjeve kuadër “Mbi bashkëpunim dhe zhvillim”, midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, financimet në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë të përjashtuara nga TVSH-ja. TVSH-ja do të financohet nga përfituesi vendas në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe faturohet e paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e furnizimeve për zbatimin e projektit. Skema e aplikimit të TVSH-së do të bëhet në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.509, datë 12.8.1996 “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë. Përjashtimi nga TVSH-ja për entet zbatuese të marrëveshjes kuadër të bashkëpunimit dhe zhvillimit, bëhet vetëm në rastet e përjashtimeve të parashikuara në nenet 20-26/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për TVSH-në”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

20.5. Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)” kontratorët (organizatat jofitimprurëse) e projekteve të financuara nga IPA rimbursohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore për TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve në kuadër të të tilla projekteve, pas dorëzimit të kërkesës për rimbursim TVSH dhe dokumenteve të tjera të nevojshme sipas këtij udhëzimi.

Me lidhjen e kontratës me delegacionin e KE-së në Tiranë, OJF-të duhet të bëjnë një kërkesë pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar si OJF, për regjistrim për efekt rimbursimi TVSH-je në kuadër të zbatimit të projektit IPA, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

a) Një kopje të kontratës së noterizuar midis OJF-ve dhe delegacionit të KE-së në Tiranë, në gjuhën shqipe dhe angleze;

b) Emrin e projektit në gjuhën shqipe dhe angleze;

c) Shumën e grantit për projektin përkatës dhe periudha e kohëzgjatjes;

d) Emrin e organizatës jofitimprurëse përgjegjëse për projektin;

e) Dokumentacion që provon statusin jofitimprurës të organizatës.

Drejtoria Rajonale Tatimore regjistron në një regjistër të veçantë të tilla OJF për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të këtyre projekteve dhe lëshon për OJF-të një certifikatë të regjistrimit të projektit për efekt të rimbursimit të TVSH-së. Një kopje e kësaj certifikate i përcillet delegacionit të KE-së në Tiranë.

Organizata jofitimprurëse i paraqet drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar për zbatimin e kësaj kontrate, duke i bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatën e regjistrimit për efekt të rimbursimit të TVSH-së;
2. Kopje të faturave origjinale të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve në kuadër të zbatimit të projektit;
3. Vërtetimin e lëshuar nga Komisioni Europian së bashku me listën e konfirmuar të të gjitha faturave të detajuara për shpenzimet e kryera nga OJF-të në kuadër të projektit të financuar nga IPA.

Brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës dhe verifikimit të shumës së pretenduar, drejtoria rajonale tatimore procedon me rimbursimin e TVSH-së.

20.5. Në rastet e zbatimit të marrëveshjeve kuadër për bashkëpunim dhe zhvillim, në bazë të të cilave përfitues janë institucionet buxhetore, të cilave në momentin e importimit nuk iu janë lëvruar nga Drejtoria e Thesarit fondet buxhetore për pagimin e TVSH-së për importimin e mallrave të përfituara në kuadër të këtyre projekteve, administrata doganore procedon me shtyrje të pagesës së TVSH-së në momentin e importit, për një periudhë deri në tre muaj, me kusht që institucioni buxhetor përfitues të paraqesë:

a) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave - kopje të kontratës së lidhur midis institucionit buxhetor përfitues dhe donatorit;

b) pranë degës doganore që do të akordojë shtyrjen e TVSH-së, - urdhrin e pagesës të vulosur nga dega e thesarit përkatës.

Në qoftë se nuk kryhet pagesa brenda periudhës 3-mujore, njoftohet Ministria e Financave.

21. PËRFAQËSUESIT TATIMORË

Në zbatim të nenit 55 të ligjit, kur personi i tatueshëm për qëllime të këtij ligji, nuk ka vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri, ai duhet të emërojë një person tjetër si përfaqësuesin e tij tatimor për përmbushjen e detyrimeve për TVSH. Marrësi i furnizimit detyrohet të njoftojë me shkrim organet tatimore menjëherë me lidhjen e kontratës. Personi i emëruar si përfaqësues tatimor i TVSH-së ka të drejtë të veprojë në emër të kryesorit të tij (personit të tatueshëm të cilin ai përfaqëson) për të gjitha qëllimet që lidhen me TVSH dhe njëkohësisht është përgjegjës për të përmbushur të gjitha detyrimet, përfshirë çdo gjobë a dënim, për të cilat kryesori detyrohet.

Përfaqësuesi tatimor duhet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga dita e emërimit të tij. Kërkesës për regjistrim i bashkangjitet prokura e përpiluar në formën e përcaktuar në ligjin "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë". Në rast se përfaqësuesi tatimor vepron për disa kryesore në të njëjtën kohë (për disa persona të tatueshëm të cilët ai i përfaqëson), ai duhet të regjistrohet vecant për secilin prej tyre. Këto regjistrime janë krejtësisht të ndara nga regjistrimi që mund të ketë bërë ose mund të bëjë përfaqësuesi tatimor për aktivitetin e tij. Përfaqësuesi tatimor është i detyruar të njoftojë me shkrim degën e tatimeve, ku është i regjistruar si i tillë, për çdo ndryshim të mundshëm që prek informacionin fillestar të dhënë brenda 15 ditëve nga momenti kur këto ndryshime ndodhin. Përfaqësuesi tatimor për TVSH duhet të mbajë regjistrime të veçanta për çdo kryesor që përfaqëson si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon saktësinë e

mbajtjes së këtyre regjistrimeve. Regjistrimet mbahen ashtu siç është përcaktuar në pikën 13 të këtij Udhëzimi.

Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, të gjitha detyrimet dhe penaltetet për to paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit, në përputhje me ligjin 10 003, datë 6.10.2008. (Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

22. DËNIMET

Per cdo shkelje qe ka te beje me TVSH, pasi mbahet akti i kontrollit apo proces verbali perkates, percaktohet masa e denimit dhe plotesohet formulari tip i denimeve, forma dhe permbajtja e te cilit eshte sipas modelit bashkengjitur ketij udhezimi. Ky formular eshte i kodifikuar dhe hidhet ne sistemin e integruar kompjuterik per deget e informatizuara dhe ne regjistrin perkates per deget e painformatizuara. Per cdo denim, bazuar ne Ligjin e Procedurave Tatimore, personi i tatueshem mund te apeloje ne shkallet perkatese te apelimit.

22.1 Dënimet për mosregjistrim Shfuqizohet

22.2 Denimet në lidhje me faturën tatimore Shfuqizohet

22.3 TVSH e zbatuar nga një person i cili nuk është i regjistruar Shfuqizohet

22.4 Denimet per mosdeklarim Shfuqizohet

22.5 Denimet për pagesë të vonuar Shfuqizohet

22.6 Denimet per deklarimet fallco Shfuqizohet

22.7 Dënime të tjera Shfuqizohet

22.8 Dënime për shkelje të skemës së kompensimit të fermerëve

Nëqoftëse fatura e lëshuar nga blerësi , person i tatueshëm, nuk përmban të gjitha të dhënat që janë të përcaktuara në nenin 58.4 të ligjit, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin e paraqitur në të dhe, detyrohet të paguajë një dënim të barabartë me vlerën e kompensimit,por jo më të vogël se 10.000 lekë.

23. KAMATËVONESA

Kur një person i tatueshëm nuk paguan shumën e plotë të TVSH-së së detyrueshme brenda datës së përcaktuar në ligj, detyrohet të paguajë kamatëvonesa, sipas përcaktimeve të nenit 76 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Kamatëvonesat për mosrimbursimin në kohë janë të zbatueshme, kur :

- Organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së për një person, në bazë të nenit 50 të ligjit “Për TVSH-në” brenda 30 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së kërkesës, si dhe në një nga format e përcaktuara në nenin 75 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. Në këtë rast ato detyrohen të paguajnë interesa siç përcaktohet në nenin 76 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

24. VEPRIMET PËR MBLEDHJEN E TATIMIT

TVSH e pagueshme duhet paguar brenda 30 diteve nga data e Njoftim Vleresimit Tatimor. Interesat dhe dënimet janë të detyrueshme për t'u paguar dhe mbledhen si TVSH-ja. Nëse detyrimet nuk janë paguar deri në datën, në të cilën janë të detyrueshme, organet tatimore kanë të drejtë të ndërmarrin veprime për të nxjerrë me forcë TVSH-në e detyruar, së bashku me interesat e dënimet e vëna, sipas kreut XI të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në RSH".
(Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009).

25. APELIMI

Çdo person ka të drejtë të apelojë rezultatet e Vlerësimit Tatimor të bërë nga organet tatimore. Mënyra e apelimit është ajo e përcaktuar në ligjin "Për Procedurat Tatimore" dhe në udhëzimin në zbatim të tij.

26. ZBATIMI I UDHEZIMIT

Ngarkohen me zbatimin e këtij udhezimi Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe deget e saj si dhe Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe deget e saj.

27. SHFUQIZIME

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi, Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.3, datë 30.01.2006 "Për TVSH-në", shfuqizohet.

28. HYRJA NE FUQI

Ky Udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, ndërsa skema e parashikuar në paragrafin 9.5.1. "Faturimi e pagimi total i komisionit" hyn në fuqi me 1 shtator 2008.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

RIDVAN BODE

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 64 datë 16 maj 2008.

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 18, datë 18.06.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 104 datë 01.07.2008

Ndryshuar me Udhezim, Nr.17/1, datë 5.8.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 130 datë 08.08.2008;

Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/3 datë 13.11.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.176 datë 26.11.2008

Ndryshuar me Udhëzim nr. 17/4 datë 26.12.2008, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203 datë 15.01.2009.

Ndryshuar me Udhëzim nr.30,date12.5.2009,botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 78 datë 29 maj 2009

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 44, datë 17.11.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 161, dt. 26.11.2009.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 2, dt. 28.01.2010, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 10, datë 17.02.2010.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 5, datë. 31.01.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6, datë 31 janar 2011.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 15, datë 7.7.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.94, datë 15.7. 2011.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, datë 8.11.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 151, datë 14.11.2011.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 26, dt. 2.12.2011, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 165, datë 23.12.2011.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 11, datë 14.5.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 59, datë 29.05.2012.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 22.01.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 5, datë 31 janar 2013.

Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 7, date 6.02.2013. Botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 9, date 14 shkurt 2013.

Ndryshuar me Udhëzim Nr. 6, datë 27.2.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 27, datë 10 mars 2014.

Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/1, date 17.3.2014. Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 32, date 17.03.2014.

Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/2, datë 3.4.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 44, datë 7 prill 2014.

Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/3, datë 8.4.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 47, datë 9 prill 2014.

Ndryshuar me Udhëzimin nr. 6/4, datë 16.5.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.70, datë 20.5.2014.

Libri i Shitjeve

Shoqeria Emri i Shoqerise
 Nipti Nipti i Shoqerise
 Viti Viti per te cilin plotesohet libri (yyyy)
 Muaji Muaji per te cilin plotesohet libri - muaji nga 01 deri 12

Pa
veprimtar
i

☐

Ploteso **PO** nese gjate muajit nuk eshte bere asnje transaksion.

Fatura			Bleresi			Totali Shitjeve	Shitjet e perjashtuara	Eksporte /Furnizime me 0%	Shitje me shkalle 20%		Shitje me shkalle 10%	
Nr Fatures	Numri Serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar /personi	Rrethi	NIPT				Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh
a	b	C	d	e	f	g= (h+i+j+k+l+m)	h	i	j	k	l	m

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2014

Udhezim Nr. 17, date 13.05.2008

Shuma totale												
Kutia sipas Formularit te Deklarimit dhe Pageses se TVSH-se						kutia (9)	kutia (10)	kutia (11)	kutia (12)	kutia (13)	kutia (14)	

Emri
Mbiemri

Shpjegim

:

Ne rastin kur ky liber do te printohet, per qellime te ruajtjes/ mbajtjes se dokumentacionit, cdo faqe e printuar duhet te kete ne krye permbajtjen / rreshtat nga 1 ne 12.

Nr i rreshtave mund te shtohet ne perputhje me nr e transaksioneve

**Libri i
Blerjeve**

Shoqeria

Emri i
Shoqerise
Nipti i

Nipti

Shoqerise
Viti per te cilin
plotesohet libri

Viti

(yyyy)
Muaji per te cilin plotesohet libri
- muaji nga 01 deri 12

Muaji

Pa
veprimtari

☐

Ploteso **PO** nese gjate muajit
nuk eshte bere asnje
transaksion.

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2014

Udhezim Nr. 17, date 13.05.2008

Fatura			Shitesi			Totali Blerjeve (perfshire TVSH)	Blerje										
Nr Fatures	Numri Seria l	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar / personi	Rrrethi	NIPT /Kodi Ferm erit		Te perjashtuara, me Tvsh jo te zbritshme dhe pa TVSH	Importe me shkalle 20%		Importe me shkalle 10%		Nga Furnitore Vendas me shkalle 20%		Nga Furnitore Vendas me shkalle 10%		Nga Fermeret vendas	
								Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh
a	b	C	D	e	f	g=(h+i+j+k+l+m+n+o+p+q+r)	h	i	j	k	l	m	n	o	p	q	r
Shuma totale																	
Kutia sipas Formularit te Deklarimit dhe Pageses se TVSH-se							kutia (15)	kutia (16)	kutia (17)	kutia (18)	kutia (19)	kutia (20)	kutia (21)	kutia (22)	kutia (23)	kutia (24)	kutia (25)

Emri
Mbiemri

Shpjegi

m:

Ne rastin kur ky liber do te printohet, per qellime te ruajtjes/ mbajtjes se dokumentacionit, cdo faqe e printuar duhet te kete ne krye permbajtjen / rreshtat nga 1 ne 12.

Nr i rreshtave mund te shtohet ne perputhje me nr e transaksioneve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr _____ Prot _____
...../...../.....
(Formati Nr. 1)

Datë _____

NJOFTIM PËR MOSPRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH

Drejtuar: Subjektit " _____ "
Z _____

Nipt: _____
Adresa: _____

Në përgjigje të kërkesës suaj, protokolluar me tonën me nr. _____, datë _____, me anë të së cilës keni kërkuar rimbursimin e TVSH-se për shumën _____ lekë _____ (shuma në fjale), për periudhën _____,

bazuar në:

Ligjin Nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar, neni 50; Udhezimin Nr.17, datë 13.05.2008 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" i ndryshuar pika 20;

Ju njoftojmë se për mosplotësim të _____ (arsyet e mospranimit) _____,

kërkesa juaj për rimbursim të TVSH-së nuk është pranuar nga administrata tatimore. Pasi të keni rregulluar situatën dhe të keni plotësuar kërkesat e përcaktuara në dispozitat e sipërpërmendura, ju mund të paraqisni një kërkesë të re për rimbursim.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Ky njoftim i dërgohet personit të tatueshëm nepermjet shërbimit postar, brenda 5 ditëve pune nga data e protokollit të kërkesës për rimbursim të TVSH-së.

Ky njoftim, formati nr.1, është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 6, datë 27.02.2014, botuar ne FLZ 27, date 10.03.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr _____ Prot _____

Datë _____

...../...../.....

(Formati Nr.2)

NJOFTIM PËR PRANIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TË TVSH

Drejtuar: DEGËS SË THESARIT _____

Per dijeni: Subjekti: “ _____ ”

Z _____

Adresa: _____

Në zbatim të nenit 50 të Ligjit Nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", i ndryshuar, udhëzimit nr. 17, date 13.05.2008 "Për TVSH-në" i ndryshuar, pika 20, ju informojmë se është pranuar kërkesa për rimbursim e personit të tatueshëm me të dhënat:

Emri i Personit te Tatueshëm:

Numri i Identifikimit Personit

Tatueshem NIPT/NUIS:

Emri Mbiemri

(Administratori/Drejtori)

Adresa:

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Nr. Telefonit, E-mail:

Kërkesa për rimbursim Nr. Prot

Datë:

Eksportues: ¹⁾

Marrveshje Financiare:

Shuma e kërkuar ne numer dhe fjale

:

Periudha:

Dega e Bankes/Nr. Llogarise

bankare:

DREJTORI

Shënime:

1.Kjo rubrikë plotësohet nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM Nr _____, datë _____ “ Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të tvsh-së”. Psh (eksportues me risk zero/ eksportues te tjere).

Ky njoftim i dërgohet Degës së Thesarit nëpërmjet shërbimit postar (elektronik dhe ne forme shkresore), brenda 5 diteve pune nga data e protokollit të kërkesës për rimbursim të TVSH-se. Ky njoftim është i vlefshëm vetëm për njoftimin e fillimit të procedurës së rimbursimit dhe jo për ekzekutimin e rimbursimit. Në rast miratimi ky njoftim do të pasohet me formatin Nr. 3 ku përcaktohet shuma për tu rimbursuar.

Ky njoftim, formati nr.2, është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 6, datë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr _____ Prot

Datë

...../...../.....

(Formati Nr.5)

NJOFTIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RIMBURSIM TE TVSH

Drejtuar: DEGËS SË THESARIT

Në zbatim të Ligjit Nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për TVSH-ne" i ndryshuar, neni 50, Udhëzimit Nr. 17, date 13.05.2008 "Për TVSH-në" i ndryshuar, pika 20, ju njoftojmë se është refuzuar kërkesa për rimbursim e personit të tatueshëm me të dhënat:

Emri i Personit të Tatueshëm:

Numri i Identifikimit Personit

Tatueshëm NIPT/NUIS:

Emri Mbiemri

(Administratori/Drejtori)

Adresa:

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Nr. Telefonit, E-mail:

Kërkesa për rimbursim Nr. Prot

Datë:

Eksportues: ¹⁾

Marrveshje Financiare:

Shuma e kërkuar në numer dhe fjale

:

Periudha:
Dega e Bankes/Nr. Llogarise
bankare:

DREJTORI RAJONAL I TATIMEVE
THESARIT

DREJTORI I DEGËS SË

Shënime: 1) Kjo rubrikë plotësohet nëse subjekti është eksportues, duke përcaktuar kategorinë e eksportuesit sipas VKM Nr _____, date _____ “Për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për kategoritë e eksportuesve përfitues të rimbursimit të tvsh-së”. Psh (eksportues me risk zero/ eksportues të tjerë)

- Ky njoftim sipas pikes 20.1.7 informon Degen e Thesarit për refuzimin e kërkesës për rimbursim dhe dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave kundërfirmohet, vuloset dhe i kthehet Drejtorisë Rajonale Tatimore, duke vërtetuar se është bërë regjistrimi i kërkesës për rimbursim të personit të tatueshem nga regjistri i sistemit të thesarit.

- Ky njoftim, formati nr.5, është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 6, datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE

Nr _____ Prot
_____/_____/_____
Formati nr. 6

Datë

**ÇERTIFIKATË E REGJISTRIMIT TË PROJEKTIT
PËR RIMBURSIMIN E TVSH-së**

Drejtuar: Organizatës jofitimprurëse _____

NIPT: _____

Adresa: _____

Për dijeni: DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI

Adresa: _____
TIRANË

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr. 9840, datë 10.12.2007 “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të parazgjerimit (IPA)”, si dhe të pikës 20.5 të udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, të ndryshuar.

Kjo certifikatë i jepet organizatës jofitimprurëse..... (emër, NIPT)
....., sipas aplikimit të saj me kërkesën nr. prot., datë....., për
regjistrimin për efekt të rimbursimit të TVSH-së së paguar në kuadër të
projektit.....(emri i projektit)....., sipas kontratës së paraqitur (të
noterizuar), lidhur midis kësaj organizate dhe delegacionit të KE-së, me afat
(afati i realizimit të kontratës).....
Kjo certifikatë me nr. regjistri është e vlefshme deri në përfundim të afatit të përcaktuar
në kontratë.

DREJTORI

Shënime

- Kjo certifikatë lëshohet për aplikimin e OJF-ve për rimbursim të TVSH-së për projektin IPA, në zbatim të pikës 20.5 të udhëzimit nr. 17, datë 13.5.2008 “Për TVSH-në”, i ndryshuar.
- Nr. i regjistrit është numri i regjistrit të veçantë ku DRT-ja regjistron OJF-të për efekt të rimbursimit të TVSH-së.
- Modeli i kësaj certifikate është miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 6, datë 27.02.2014, botuar ne FLZ 27, date 10.03.2014